




# Të dhënat kryesore financiare

Vlerat monetare janë në milionë euro	2025	2024	Change
<b>Pasqyra e të ardhurave</b>	<b>1/1-31/12</b>	<b>1/1-31/12</b>	
Të ardhurat neto nga interesi	69.5	69.0	0.6%
Të ardhurat neto nga tarifat bankare	16.4	14.6	12.7%
Fitimi ose humbja nga pasuritë dhe detyrimet financiare	0.2	1.0	78.1%
Të ardhurat tjera operative	5.4	8.9	-39.4%
Shpenzimet e përgjithshme administrative	(48.8)	(47.3)	3.3%
Fitimi para tatimit	34.8	44.3	-21.5%
Fitimi pas tatimit	31.3	39.2	-20.0%
<b>Bilanci i gjendjes</b>			
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	49.2	9.5	418.4%
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	1,242.8	1,072.4	15.9%
investimet në letra me vlerë	322.4	245.6	31.3%
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	135.1	11.9	1038.0%
Depozitat nga klientët	1,552.0	1,329.1	16.8%
Ekuiteti (përfshi interesat jo-kontrolluse)	180.9	170.7	5.9%
Gjithsej bilanci i gjendjes	1,921.2	1,565.6	22.7%
<b>Informatat vendore rregullative</b>			
Pasuritë e ponderuara sipas riskut B1	1,201.0	1,158.0	3.7%
Gjithsej fondet vetanake	207.4	196.1	5.8%
Gjithsej kërkesa për fonde vetanake	177.1	139.0	27.5%
Raporti i mbulimit tepricë	17.1%	41.1%	-24 PP
Raporti i kapitalit kryesor (klasi i parë)	15.6%	15.1%	0.6 PP
Gjithsej raporti i fondeve vetanake	17.3%	16.9%	0.4 PP
<b>Performanca</b>			
Kthimi në ekuitet (KE) para tatimit	21.5%	30.7%	-9.2 PP
Kthimi në ekuitet (KE) pas tatimit	19.3%	27.1%	-7.8 PP
Koeficienti kosto/të ardhura	49.2%	48.0%	1.2 PP
Kthimi në pasuri (KP) para tatimit	2.1%	3.1%	-1 PP
Kreditë joperformuse	3.7%	3.2%	0.5 PP
Mbulimi i kredive joperformuse	76.9%	74.8%	2.1 PP
Raporti neto i provizionimit	0.7%	0.2%	0.5 PP
Koeficienti rrezik / fitim	15.3%	13.4%	1.8 PP
<b>Burimet</b>			
Numri i punëtorëve	899	927	-3.0%
Zyrat e biznesit	35	36	-2.8%



# Përmbajtja

Raporti i Bordit Mbikëqyrës	6
Raporti i Bordit Menaxhues	7
Bordi Menaxhues i Kosovës	8
Struktura Organizative e Raiffeisen Bank në Kosovë	9
Vizioni dhe Misioni	10
Përmbledhje e shkurtër për Raiffeisen Bank International	11
Zhvillimet në ekonominë e Kosovës	12
Spektori Bankar në Kosovë	14
Performanca dhe financat e Raiffeisen Bank në Kosovë	17
Menaxhimi i thesarit, asetëve dhe detyrimeve	21
Segmentet e biznesit	23
Produktet dhe shërbimet bankare	24
Përvoja e klientëve	25
Menaxhimi i riskut	26
Njerëzit, kultura dhe mësimi	30
Qëndrueshmëria dhe Menaxhimi i MSQ	32
Pasqyrat Financiar	34
Raporti i qëndrueshmërisë	112
Adresat dhe kontaktet	116

# Raporti i Bordit Mbikëqyrës

Në vitin 2025, Raiffeisen Bank Kosova realizoi një performancë të fortë financiare, duke ruajtur pozitën e saj si lider i tregut për nga asetet totale, ndërkohë që shënoi rritje të qëndrueshme në segmentet kryesore të biznesit dhe zgjeroi më tej bazën e klientëve. Viti u karakterizua gjithashtu nga një fokus i theksuar dhe progres i vazhdueshëm në digjitalizim dhe inovacion, duke mbështetur përmirësime të mëtejshme në shërbime dhe përvojën e klientit. Në të njëjtën kohë, banka mbeti e përkushtuar ndaj parimeve ESG, duke forcuar rolin e saj si një partner i përgjegjshëm në mbështetje të rritjes së qëndrueshme për bizneset dhe komunitetin më të gjerë.

Gjatë vitit financiar 2025, anëtarët e Bordit Mbikëqyrës zhvilluan 4 mbledhje të rregullta. Shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes në mbledhjet e Bordit Mbikëqyrës ishte rreth 100 për qind.

Bordi Mbikëqyrës monitoroi në mënyrë të rregullt dhe gjithëpërfshirëse performancën e biznesit dhe zhvillimet e rrezikut në Raiffeisen Bank Kosova. Diskutime të rregullta u zhvilluan me Bordin Menaxhues mbi përshtatshmërinë e kapitalit dhe likuiditetit, si dhe mbi drejtimin e strategjive të biznesit dhe të riskut. Bordi Mbikëqyrës trajtoi gjithashtu në mënyrë të detajuar zhvillimet e mëtejshme në kuadër të qeverisjes korporative dhe monitoroi zbatimin e politikave përkatëse. Në kuadër të aktiviteteve të tij mbikëqyrëse dhe këshilluese, Bordi Mbikëqyrës mbajti kontakte të drejtpërdrejta me anëtarët përgjegjës të Bordit Menaxhues, auditorin dhe drejtuesit e funksioneve të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, ai mbajti një shkëmbim të vazhdueshëm informacioni dhe pikëpamjesh me përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse mbi çështje aktuale.

Për më tepër, Bordi Menaxhues i siguroi Bordit Mbikëqyrës raporte të rregullta dhe të detajuara mbi çështje relevante që lidhen me performancën në fushat përkatëse të biznesit. Ndërmjet mbledhjeve, Bordi Mbikëqyrës mbajti kontakte të afërta me Kryesuesen dhe anëtarët e Bordit Menaxhues. Bordi Menaxhues ishte në dispozicion, sipas nevojës, për diskutime bilaterale apo multilaterale me anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, kur ishte e aplikueshme edhe me përfshirjen e ekspertëve për çështjet në trajtim.

Puna e realizuar së bashku me Bordin Menaxhues u bazua në një marrëdhënie besimi të ndërsjellë dhe u zhvillua në frymën e një bashkëpunimi efikas dhe konstruktiv. Diskutimet ishin të hapura dhe kritike, ndërsa Bordi Mbikëqyrës miratoi vendime pasi shqyrtoi plotësisht të gjitha aspektet. Kur kërkoheshin informacione shtesë për të trajtuar çështje të veçanta në mënyrë më të thelluar, ato u ofroheshin anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës pa vonesë dhe në përputhje me kërkesat e tyre.

Dua të shfrytëzoj këtë mundësi për të falënderuar singërisht Bordin Menaxhues dhe të gjithë punonjësit e Raiffeisen Bank Kosova për përkushtimin e tyre të palëkundur, si dhe klientët tanë për besimin e vazhdueshëm.

Në emër të Bordit Mbikëqyrës



**Andrii Stepanenko**  
Kryesues i Këshillit Mbikëqyrës



# Raporti i Bordit Menaxhues

Viti 2025 u karakterizua nga arritje në disa fusha kyçe. Para së gjithash, banka ruajti pozicionin e saj si lider i tregut për nga asetet totale, duke vazhduar njëkohësisht të realizojë rritje të qëndrueshme në segmentet kryesore të biznesit dhe të zgjerojë bazën e klientëve. Më 31 dhjetor 2025, asetet totale arritën në 1,921 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 22.7% krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu, kreditë për klientë u rritën në mënyrë të qëndrueshme, duke arritur në 1,243 milionë euro, që përfaqëson një rritje prej 15.9% krahasuar me vitin paraprak. Depozitat totale të klientëve gjithashtu shënuan rritje të konsiderueshme, duke arritur në 1,552 milionë euro, ose 16.8% më shumë krahasuar me vitin 2024, duke reflektuar besimin dhe angazhimin e fortë të klientëve. Banka gjithashtu demonstroi performancë të lartë të profitabilitetit, me fitimin neto pas tatimit që arriti në 31.3 milionë euro në vitin 2025.

Paralelisht me këtë, viti u karakterizua edhe nga përparim në prioritetet e tjera strategjike, veçanërisht në digjitalizim dhe inovacion. Këto përpjekje mundësuan përmirësime të mëtejshme në shërbimet tona dhe në mënyrën se si ndërveprojmë me klientët. Një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit ishte avancimi i vazhdueshëm i aplikacionit tonë mobil, përmes prezantimit të funksionaliteteve të reja që e pozicionojnë atë edhe më tej si një zgjidhje gjithëpërfshirëse për nevojat bankare dhe të pagesave të klientëve tanë. Arritje të tjera të rëndësishme gjatë vitit 2025 përfshijnë prezantimin e RAI-A-s, asistentes virtuale të parë të mbështetur nga inteligjenca artificiale në tregun bankar të Kosovës, duke transformuar mënyrën se si klientët tanë marrin informata dhe mbështetje. Gjithashtu, integruam Apple Pay, duke mundësuar pagesa të shpejta dhe të sigurta pa kontakt, si dhe avancuam më tej ofertën tonë të kreditimit digjital përmes platformës RaiKesh, përfshirë rritjen e limiteve për kreditë personale. Në vitin 2025, banka u shpall Banka më e Mirë Digjitale në Kosovë në kuadër të çmimeve Euromoney Awards for Excellence.

Banka u shpall gjithashtu Banka më e Mirë për ESG në Kosovë në kuadër të çmimeve Euromoney Awards for Excellence 2025, duke reflektuar fokusin e saj të vazhdueshëm në praktikën e qëndrueshme. Përkushtimi ynë ndaj parimeve ESG (Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes) siguron që ne të vazhdojmë të vepojmë si një bankë e përgjegjshme, si përmes përmirësimit të praktikave tona të brendshme, ashtu edhe përmes mbështetjes së komunitetit dhe bizneseve në nxitjen e rritjes së qëndrueshme. Në këtë kontekst, është inkurajuese të shihet një rritje e qëndrueshme e investimeve në zgjidhje të qëndrueshme, duke reflektuar një vetëdijësim dhe pjekuri në rritje të bizneseve në Kosovë sa i përket qëndrueshmërisë; portofoli ynë ESG tani përfaqëson 14.2% në nivel bankë (16% në segmentin e korporatave dhe 11.6% në segmentin retail). Përpjekjet tona për investime në komunitet, të cilat përbëjnë një pjesë integrale të qasjes sonë ESG, vazhduan edhe gjatë vitit 2025, me mbështetjen e një numri të konsiderueshëm projektesh, kryesisht në fushat e kulturës, sportit dhe arsimit.

Raporti i plotë ofron një pasqyrë më të detajuar të performancës së bankës dhe zhvillimeve kryesore të arritura gjatë vitit. Këto rezultate u mundësuan nga përkushtimi i vazhdueshëm i punonjësve tanë, të cilët mbeten aset i më i vlefshëm i bankës. Po ashtu, jemi mirënjohës ndaj numrit në rritje të klientëve për besimin dhe besnikërinë e tyre, të cilat vazhdojnë të na inspirojnë për punën tonë. Duke u mbështetur në këtë bazë të fortë, jam e bindur se viti 2026 do të jetë një tjetër vit i suksesshëm për bankën tonë.

Në emër të Bordit Menaxhues,

**Anita Kovacic**

Drejtoreshë Ekzekutive, Kryesuese e Bordit Menaxhues



# Raiffeisen Bank në Kosovë

## Bordi Menaxhues



**Anita Kovacic**

Kryesuese e Bordit  
Menaxhues  
Drejtoreshë Ekzekutive



**Iliriana Toçi**

Anëtare e Bordit  
Menaxhues  
Bankimi Retail



**David Heitzinger**

Anëtar i Bordit  
Menaxhues  
COO/CIO




**Deyan Ivanov**

Anëtar i Bordit  
Menaxhues  
Menaxhimi i riskut

# Struktura Organizative e Raiffeisen Bank në Kosovë

Që nga 31 dhjetor 2025



\* Auditimi i Brendshëm i raporton drejtpërdrejt Komitetit të Auditimit të Bordit Mbikëqyrës

\*\* Pajtueshmëria raporton drejtpërdrejt te Bordi Mbikëqyrës dhe te MB

\*\*\* LPP raporton drejtpërdrejt te Bordi Mbikëqyrës dhe te MB

# Raiffeisen Bank në Kosovë

## Vizioni dhe Misioni

### Vizioni

Ne jemi banka më e rekomanduar në Kosovë.

### Misioni

Ne transformojnë inovacionin e vazhdueshëm në përvojë superiore të klientit.

# Përmbledhje e shkurtër për Raiffeisen Bank International

RBI e konsideron Austrinë, ku është bankë lidere korporative dhe investuese, si dhe Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL) si tregun e saj kryesor. Bankat e varura mbulojnë 11 tregje në rajon. Përmë tepër, Grupi përfshin shumë ofrues të tjerë të shërbimeve financiare aktive në fusha të tilla si lizingu, menaxhimi i aseteve, faktorimi dhe M&A. Në total, rreth 42,000 punonjës të RBI u shërbejnë 18.6 milionë klientëve në rreth 1,300 pika biznesi, shumica dërrmuese e të cilave janë në EQL.

Bankat Raiffeisen në rajon zotërojnë 61.17 për qind të aksioneve të RBI. Aksionet e mbetura mbahen në qarkullim të lirë.

# Zhvillimet në ekonominë e Kosovës

Në vitin 2025, ekonomia e Kosovës tregoi qëndrueshmëri, duke arritur një rritje reale të BPV-së prej afërsisht 3.6%, nga 4.6% në vitin 2024. Ky zgjerim u nxit kryesisht nga kërkesa e madhe e brendshme: konsumi privat kontribuoi me 2.0 pikë përqindjeje, i mbështetur nga rritja e pagave, remitencat e qëndrueshme dhe zgjerimi i kredisë për familjet, ndërsa konsumi publik shtoi 1.1 pikë. Investimet ishin një shtyllë kyçe e rritjes, duke kontribuar me 2.4 pikë, të nxitura nga projektet e infrastrukturës dhe zgjerimi i sektorit të korporatave. Megjithatë, eksportet neto zbritën 1.9 pikë për shkak të një deficiti të vazhdueshëm tregtar, duke reflektuar varësinë e madhe të Kosovës nga importet dhe diversifikimin e kufizuar të eksporteve.

Sektorët kryesorë ekonomikë treguan rritje të qëndrueshme me disa luhatje sezonale. Bujqësia u rrit mesatarisht me mbi 3%, industrinë minerare dhe prodhuese, pas një rënijeje të përkohshme në tremujorin e dytë, u rikuperuan për të përfunduar me rritje mbi 4.5%, ndërsa ndërtimi përjetoi rritje të fuqishme gjatë gjithë vitit, duke arritur kulmin në tremujorin e parë dhe të tretë. Tregtia me shumicë dhe pakicë, informacioni dhe komunikimi, si dhe aktivitetet financiare dhe profesionale, treguan performancë pozitive dhe të qëndrueshme, duke kontribuar në rritjen e përgjithshme ekonomike. Në anën tjetër, sektori publik dhe shërbimet sociale shënuan rritje më modeste për shkak të kufizimeve buxhetore dhe sfidave politike. Në përgjithësi, ekonomia u karakterizua nga rimëkëmbja graduale dhe diversifikimi i aktivitetit ekonomik gjatë vitit.

Inflacioni u përshpejtua ndjeshëm në vitin 2025, duke e mbyllur vitin në 5.3% me një normë mesatare vjetore prej 3.9%, nga 1.6% në vitin 2024. Kjo rritje u nxit kryesisht nga çmimet më të larta të ushqimit, banesave dhe energjisë, të ndikuara nga rritjet globale të çmimeve të mallrave. Inflacioni bazë mbeti i lartë, por nën inflacionin total, duke treguar presione të vazhdueshme por të përmbajtura inflacioniste të brendshme. Kufizimet e brendshme - duke përfshirë mbështetjen në termocentralet e vjetra me qymyr, importet e mëdha të naftës, një ekonomi e bazuar në euro që kufizon mjetet e politikës monetare dhe pasigurinë e vazhdueshme politike - kanë përkeqësuar ndjeshmërinë ndaj goditjeve të jashtme. Të dhënat e hershme të vitit 2026 tregojnë se inflacioni vazhdon trendin e tij në rritje, duke arritur në 5.8% në janar dhe 6.0% në shkurt. Duke parë përpara, inflacioni pritet të rritet më tej në vitin 2026, i nxitur nga presionet e qëndrueshme të çmimeve të energjisë dhe rreziqet gjeopolitike, duke paraqitur sfida për fuqinë blerëse dhe stabilitetin ekonomik.

Remitencat mbetën një shtyllë jetësore ekonomike, duke arritur në total 1.4 miliardë euro me një rritje të qëndrueshme prej 4.3% nga viti në vit, duke mbështetur konsumin familjar dhe financimin e jashtëm. Investimet e Huaja Direkte u rritën për 38% në 1.1 miliardë euro në vitin 2025, ku dominuan pasuritë e paluajtshme (70.4%), të pasuara nga shërbimet financiare (11.4%), furnizimi me energji (4.3%), tregtia (3.9%) dhe prodhimi (2.9%). Gjermania (26%), Zvicra (23%), Shqipëria (9%) dhe SHBA-ja (9%) ishin vendet kryesore investuese, duke reflektuar rëndësinë e diasporës dhe partneriteteve strategjike.

Sektori i jashtëm u përball me presione ndërsa deficiti tregtar u zgjerua, pjesërisht për shkak të rritjes së importeve të energjisë dhe mallrave. Deficiti i llogarisë rrjedhëse të Kosovës u rrit në 908 milionë euro në vitin 2025, 4.1% më shumë se në vitin 2024, i nxitur nga deficitet e larta në mallra (-5.6 miliardë euro, 13.2%), të kompensuara pjesërisht nga rritja e eksporteve të shërbimeve (+32.3%) dhe hyrjet e të ardhurave parësore dhe dytësore nga remitencat dhe investimet (së bashku mbi 4.4 miliardë euro). Këto hyrje mbeten kritike për balancimin e dobësive të jashtme. Sa i përket BPV-së, deficiti i llogarisë rrjedhëse u zgjerua nga 8.4% në vitin 2024 në 9.5%, duke e nxjerrë në pah sektorin e jashtëm si një dobësi strukturore.

Performanca fiskale e Kosovës shënoi një rritje të qëndrueshme të të hyrave buxhetore në vitin 2025, duke arritur rreth 3.3 miliardë euro, ose 8.1% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Shpenzimet qeveritare gjithashtu u rritën, duke arritur në rreth 3.4 miliardë euro, që përfaqëson një rritje prej 9.8%, e nxitur nga rritja e shpenzimeve për paga, subvencione, transfere dhe shpenzime kapitale. Balanca fiskale tregon një deficit të lehtë prej rreth 33 milionë euro, duke sugjeruar se megjithëse të hyrat u rritën ndjeshëm, shpenzimet u rritën me një ritëm më të shpejtë. Pavarësisht kësaj, Kosova mbajti një pozicion relativisht të qëndrueshëm fiscal.

Sipas Ministrisë së Financave, borxhi total publik u rrit në mënyrë modeste në 1.8 miliardë euro në vitin 2025 nga 1.7 miliardë euro në vitin 2024, i nxitur kryesisht nga borxhi më i lartë i jashtëm qeveritar që arriti në 812 milionë euro, ndërsa borxhi i brendshëm mbeti i qëndrueshëm në rreth 961 milionë euro. Pavarësisht kësaj rritjeje nominale, raporti i borxhit ndaj BPV-së vazhdoi trendin e tij në rënie nga 16.8% në vitin 2024 në 16.4% në vitin 2025, duke reflektuar rritje të fuqishme ekonomike dhe disiplinë fiskale efektive. Kjo forcë fiskale ka mbështetur programet sociale dhe zhvillimin e infrastrukturës, duke siguruar hapësirë fiskale për investime publike. Ngërçi politik kufizoi vullmin e reformave në vitin 2025, duke ndikuar në zbatimin e Planit të Rritjes së BE-së dhe qasjen në financim të jashtëm. Megjithatë, me formimin e qeverisë së re në shkurt 2026, Kosova miratoi një buxhet prej 4 miliardë eurosh dhe ratifikoi marrëveshjet e bllokua ndërkombëtare të kredisë me Bashkimin Evropian dhe Bankën Botërore, duke sinjalizuar një fokus të ripërtërirë në qeverisjen ekonomike.

Sfidat strukturore vazhdojnë, duke përfshirë pjesëmarrjen e ulët të fuqisë punëtore - veçanërisht nga gjinia femërore - papunësinë e lartë (~10%) dhe mospërputhjet e aftësive që kufizojnë produktivitetin. Reformat në sektorin e energjisë duhet të përshpejtohen për të zgjeruar kapacitetin e ripërtëritshme, për të përmirësuar eficiencën dhe për të liberalizuar tregjet për të zvogëluar varësinë nga qymyri dhe lëndët djegëse të importuara, duke frenuar kështu rreziqet e inflacionit dhe duke nxitur konkurrueshmërinë.

Duke parë përpara drejt vitit 2026, rritja reale e BPV-së parashikohet të ngadalësohet në rreth 3.0% nëse vazhdojnë fërkimet aktuale gjeopolitike në Lindjen e Mesme, të mbështetura nga konsumi i qëndrueshëm i ekonomive familjare, remitencat dhe investimet publike. Presionet inflacioniste pritet të intensifikohen, duke arritur potencialisht një mesatare prej 8.1% nëse vazhdojnë konfliktet gjeopolitike, veçanërisht lufta në Iran, e cila mund të përkeqësojë rritjen e çmimeve të energjisë.

*Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Financave, Raiffeisen Research*



# Sektori bankar në Kosovë

## Ndikimet nga jashtë

Ekonomia e BE-së mbetet e qëndrueshme në një mjedis sfidues global. Papunësia e ulët, bilancet e forta të sektorit privat, shtrirja graduale e shpenzimeve publike në mbrojtje dhe infrastrukturë, si dhe efektet mbështetëse të uljeve të mëparshme të normave të interesit po mbështesin rritjen. Në të njëjtën kohë, perspektiva është ende e pasigurt, veçanërisht për shkak të pasigurisë së vazhdueshme të politikave tregtare globale dhe tensioneve gjeopolitike. Ekonomia u rrit për 0.3% në tremujorin e katërt të vitit 2025, sipas vlerësimit paraprak të Eurostat. Rritja është nxitur kryesisht nga shërbimet, veçanërisht në sektorin e informacionit dhe komunikimit. Prodhimi ka qenë i qëndrueshëm pavarësisht vështirësive nga tregtia globale dhe pasiguria gjeopolitike. Ngritja në shkallën e ndërtimit po rritet, i mbështetur edhe nga investimet publike.

Normat e interesit pa rrezik për afatet e ardhshme të eurozonës ranë ndjeshëm në maturimet afatshkurtra dhe u stabilizuan në nivele pak më të ulëta në maturimet më të gjata. Norma referuese afatshkurtër e euros (€STR) mbeti në 1.93% në fund të periudhës së shqyrtimit, pas vendimit të Këshillit Drejtues në mbledhjen e saj më 18 dhjetor 2025 për të mbajtur të pandryshuara tre normat kryesore të interesit të BQE-së. Likuiditeti i tepërt u ul me rreth 36 miliardë euro në 2,434 miliardë euro. Kjo reflektoi kryesisht rënien në portofolet e letrave me vlerë të mbajtura për qëllime të politikës monetare, pasi Eurosistemi nuk i rinveston më pagesat kryesore nga letrat me vlerë që maturohen në programet e tij të blerjes së asetëve.

Normat e interesit të kredive bankare për firmat dhe familjet kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme që nga vera, në sfondin e normave të pandryshuara të politikës së BQE-së. Në dhjetor 2025, normat mesatare të interesit për kreditë e reja për firmat u rritën në 3.6%, ndërsa normat për hipotekat e reja mbetën të pandryshuara në 3.3%. Rritja e kredive për familjet vazhdoi trendin e saj në rritje, ndërsa rritja e kredive për firmat mbeti përgjithësisht e pandryshuar.


Masat mbikëqyrëse dhe rregullatore kontribuuan në një rritje të kapitalit të kërkuar dhe të zotërimeve të aktiveve likuide të bankave. Kjo nga ana tjetër kontriboi në një shtrëngim të standardeve të kredisë në të gjitha kategoritë e kredisë, me shtrëngim të mëtejshëm neto që pritet për vitin 2026. Bankat raportuan gjithashtu se raportet e kredive me probleme dhe treguesit e tjerë të cilësisë së kredisë patën një ndikim të vogël neto shtrëngues në standardet e tyre të kredisë për të gjitha kategoritë e kredisë në tremujorin e katërt të vitit 2025.

## Sektori bankar

Asetet e sektorit bankar arritën në 9.71 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 13.5 përqind, në të njëjtin nivel me vitin 2024 (shih grafikun më poshtë)


Ky përshpejtim u nxit kryesisht nga zgjerimi i kreditimit, si aktiviteti kryesor i sektorit, që përbën 68.7 përqind të totalit të asetëve. Një kontribut pozitiv dhanë edhe investimet në letra me vlerë, të cilat u rritën me 21.2 përqind krahasuar me 10.8 përqind një vit më parë. Kjo u pasua nga bilancet me bankat tregtare, të cilat gjithashtu u rritën në vitin aktual me 9.1 përqind krahasuar me një tkurrje prej 18 përqind një vit më parë.

### Sektori bankar – Totali i asetëve



Totali i kredive dhe paradhëniesve arriti një vlerë prej 6.7 miliardë eurosh (2024: 5.8 miliardë euro), që përbën një rritje vjetore prej 14.7 përqind (2024: 18.3 përqind). Përqendrimi i sektorit ekonomik i kredive dhe paradhëniesve për bizneset vazhdoi të dominohet nga sektori i tregtisë me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 44.2 përqind (2024: 43 përqind), i pasuar nga prodhimi me 18.8 përqind, shërbimet e tjera me 15.7 përqind dhe ndërtimi me 13.1 përqind. Në vitin 2025 rritja më e madhe në terma absolutë ishte në sektorin e tregtisë me 182.8 milionë euro, e pasuar nga prodhimi që u rrit me 103.3 milionë euro. (Burimi: baq-kos.org | Seria Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës).

Investimet e sektorit bankar në letra me vlerë, duke përfshirë obligacionet dhe bonot e thesarit, ishin 1,201 milionë euro më 31 dhjetor 2025 (2024: 991.8 milionë euro), një rritje prej 21.2 përqind. Kjo rritje pasqyron rritjen e depozitave në bankat e Kosovës. Financimi i aktivitetëve të sektorit bankar mbeti i varur nga depozitat e klientëve dhe fitimet e mbajtura nga periudhat e mëparshme. Prandaj, rritja e sektorit bankar drejtohet kryesisht nga performanca e depozitave, të cilat përcaktojnë drejtimin e lëvizjes së sektorit.




faktorë të tjerë, një ashpërsim të ofertës së kredisë si për familjet ashtu edhe për korporatat jofinanciare. Më konkretisht, oferta e kredisë u ashpërsuan deri diku për familjet, në përgjithësi, si për kreditë e banimit ashtu edhe për kreditë personale/konsumit. Për ndërmarrjet, ashpërsimi ishte disi më i theksuar lidhur me firmat e mëdha.

Lidhur me kushtet dhe afatet, u raportua ashpërsim në normat e interesit dhe në madhësinë mesatare të kredisë për të dy segmentet, ndërsa për familjet, ashpërsim shtesë u vu re në maturimet e kredisë. Faktorët kryesorë që nxitën ashpërsimin e ofertës së kredisë përfshinin tolerancë më të ulët ndaj rrezikut në mes të bankave, kufizime në aksesin e përgjithshëm në financim, kufizime në kapacitetin e bankave dhe perceptime në lidhje me perspektivën ekonomike të brendshme.

Normat mesatare për institucionet jofinanciare ishin 7.06 përqind, nga 5.95 përqind një vit më parë. Ndërsa normat mesatare për ekonominë familjare ishin 6.37 përqind, nga 5.68 përqind një vit më parë.

Normat e interesit për kreditë e reja hipotekare treguan gjithashtu një rritje në vitin aktual prej 5.86 përqind në dhjetor 2025 nga 4.88 përqind në dhjetor 2024.

### Normat efektive të interesit në treg



Sektori bankar në fund të vitit 2025 realizoi një fitim neto prej 184.6 milionë eurosh, një rritje prej 1.3% krahasuar me vitin 2024. Të ardhurat tregojnë të njëjtën rritje nga viti në vit si për të ardhurat nga interesi ashtu edhe për të ardhurat që nuk gjenerohen nga interesi. Të ardhurat totale arritën vlerën prej 552.8 milionë eurosh, që përfaqëson një rritje vjetore prej 10 përqind. Kontributi kryesor në rritjen e të ardhurave ishte nga të ardhurat nga interesi, të cilat përfaqësojnë 76 përqind të të ardhurave totale. Të ardhurat nga interesi nga kreditë dhe paradhëniet për klientët u rritën me 14 përqind në periudhën aktuale të raportimit.

Për më tepër, të ardhurat nga deponimet në banka dhe të ardhurat nga interesat nga investimet në letra me vlerë treguan një rënie prej përkatësisht 26% dhe 14%. Kjo u nxit kryesisht nga normat në rënie në të dy tregjet. Kategoria e të ardhurave që nuk

gjenerohen nga interesi, kryesisht nga tarifatat dhe komisionet, shënoi rritje prej 10 përqind, duke arritur vlerën prej 116.4 milionë eurosh nga 105.5 milionë euro në fund të vitit 2024.

Shpenzimet totale të sektorit bankar u rritën në vitin aktual me 15 përqind dhe arritën në 368.3 milionë euro deri në dhjetor 2025. Kontributi më i lartë në këtë rritje të shpenzimeve ishte rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative të cilat u rritën për 12.8 milionë euro ose 7 përqind, e pasuar nga shpenzimet e interesit të cilat u rritën për 21.7 milionë euro ose 37 përqind në vitin aktual.

Gjatë viteve, sektori bankar ka arritur një nivel të lartë kapitalizimi, me fondet totale të veta ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik në 17.3 përqind. Përveç kësaj, sektori ka ruajtur një raport të qëndrueshëm të kredive me probleme. Që nga qershori i vitit 2025, u zbatuan rezervat e reja makroprudenciale të kapitalit të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës, dhe sektori përmbushi kërkesat dhe ende qëndron i kapitalizuar mirë për të absorbuar humbjet e mundshme gjatë rënive të mundshme ose rezervave shtesë të kapitalit.


Mbulimi me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë u ul në 111.2 përqind, nga 123.9 përqind në dhjetor 2024, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive me probleme sesa vlerës së provizioneve të caktuara për mbulimin e kredive.

# Performanca dhe financat e Raiffeisen Bank në Kosovë


Raiffeisen Bank në Kosovë pati një vit të fortë me performancë të konsiderueshme financiare, në përputhje me zhvillimet pozitive në sektorin bankar.

Totali i asetëve të Raiffeisen Bank në Kosovë më 31 dhjetor 2025 ishte 1,921.2 milionë euro. Kjo është një rritje prej 22.7 përqind në krahasim me vitin e kaluar (2024: 1,565.6 milionë euro). Përqindja e pjesës së tregut të totalit të asetëve të Raiffeisen Bank në Kosovë ishte 19.8 përqind. (2024: 18.3 përqind).

## Totali i asetëve




## Pjesa e tregut – Asetet totale



Struktura e asetëve të Raiffeisen Bank në Kosovë vazhdoi të dominohet nga kreditë dhe paradhëniet për klientët. Që nga 31 dhjetori 2025, 64.7 përqind e totalit të asetëve ishin të përqendruara në kredi dhe paradhënie për klientët. Kjo u pasua nga 16.8 përqind në letra me vlerë investimi. Letrat me vlerë investimi përfshijnë investime në obligacione qeveritare dhe të korporatave të vendeve të BE-së dhe SHBA-së, si dhe bono thesari të emetuara nga Qeveria e Kosovës.


## Struktura e asetëve në bilancin e gjendjes




Investimet në letra me vlerë që nga 31 dhjetori 2025 ishin 322.4 milionë euro (2024: €245.6milion), ndërsa investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës ishin 43.2 milionë euro (2024:32.3 milionë euro).

Totali i kredive dhe paradhënieve të Raiffeisen Bank në Kosovë që nga 31 dhjetori 2025 ishte 1,242.8 milionë euro (2024: 1,072.4 milionë euro). Pjesa e tregut në kredi dhe paradhënie që nga 31 dhjetori 2025 ishte 19.3 përqind (2024: 19.1 përqind).

## Kreditë dhe paradhëniet për klientët



## Pjesa e Tregut – Kredit e klientëve dhe paradhëniet




Banka është anëtare e Fondit Kosovor për Garanci Kreditore dhe përfiton nga skema e garantuar e mikrondërmarrjeve që synon të sigurojë qasje në fonde për mikrondërmarrjet dhe të inkurajojë punësimin në sektor duke hyrë në programin e garancisë për ndarjen e riskut. Portofoli i titullizuar i bankës ka një vlerë prej mbi 58.9 milionë eurosh dhe është pjesë e dritareve të ndryshme të sigurimit me marrëveshje të ndryshme për ndarjen e rrezikut.

Raiffeisen Bank Kosova ka llogaritur rezervat për humbjet nga kreditë bazuar në politikat e rrezikut kreditor. Këto zbritje për humbjet nga kreditë arrijnë në 46.4 milionë euro (2024: 38.2 milionë euro). Këto zbritje llogariten bazuar në modelin e humbjeve të pritura nga kreditë sipas SRNF 9 dhe pasqyrojnë vlerësimin e rrezikut në portofolin e kredisë nga Raiffeisen Bank në Kosovë më 31 dhjetor 2025.


Totali i zbritjes për humbje për kreditë me probleme ishte 96.7 përqind (2024: 108.1 përqind).

Depozitat totale të klientëve të Raiffeisen Bank në Kosovë arritën në 1,552.0 milionë euro më 31 dhjetor 2025, nga 1,329.1 milionë euro më 31 dhjetor 2024. Kjo është një rritje prej 17 përqind. Raiffeisen Bank në Kosovë kishte një pjesë tregu prej 17.0 përqind në depozitat nga klientët. Gjenerimi vendas i financave gjithashtu kontribuoi në një stabilitet më të madh në sektorin bankar dhe uli ndikimin e çdo paqëndrueshmërie nga tregjet ndërkombëtare.

## Depozita nga klientët




## Pjesa e tregut – depozitat nga klientët




Kontribuuesi më i madh në depozitat nga klientët ishin llogaritë rrjedhëse me një pjesëmarrje prej 81 përqind. Llogaritë e kursimit kanë një pjesëmarrje prej 8 përqind të totalit të depozitave të klientëve bankarë. Depozitat me afat nga klientët dhe llogaritë e tjera përbëjnë 11 përqind të bazës totale të depozitave. Struktura aktuale e bazës së klientëve dominohet nga llogaritë rrjedhëse për shkak të një mjedisi ekonomik të dominuar nga norma shumë të ulëta interesi. Struktura e detyrimeve të Raiffeisen Bank në Kosovë dominohej nga depozitat e klientëve, dhe kjo ishte edhe rasti për tregun e Kosovës.

### Struktura e detyrimeve në bilancin e gjendjes



### Struktura e kapitalit




Në vitin 2025, kapitali aksionar i Raiffeisen Bank në Kosovë mbeti i pandryshuar në 63 milionë euro. Totali i kapitalit aksionar më 31 dhjetor 2025 ishte 180.8 milionë euro (2024: 171 milionë euro), duke përfshirë 106.4 milionë euro në formën e fitimeve të mbajtura.

Raiffeisen Bank Kosova mbeti mirë e kapitalizuar, siç dëshmohet nga raportet e kapitalit rregullator që tejkalojnë kërkesat ligjore si për kapitalin e nivelit të parë (Tier 1) ndaj aktiveve të peshuara me rrezik, ashtu edhe për kapitalin total (përfshirë Tier 2) ndaj aktiveve të peshuara me rrezik.

Të ardhurat neto pas tatimeve në vitin 2025 ishin 31.3 milionë euro (2024: 39.2 milionë euro). Ky rezultat është llogaritur bazuar në Pasqyrat Financiare sipas SRFF-së të përfshira në këtë raport.

Pasqyrat e SRNF-së i raportohen Bankës Qendrore të Kosovës në baza të rregullta mujore dhe gjithashtu publikohen çdo tremujor në faqen e internetit të Raiffeisen Bank në Kosovë dhe në portalet lokale të lajmeve elektronike.

### Zhvillimi dhe struktura e të ardhurave bruto




Të ardhurat e Raiffeisen Bank në Kosovë u dominuan fuqishëm nga të ardhurat e gjeneruara nga kreditë dhe paradhëniet për klientët vendas.

Rritja u ndikua nga rritja e të ardhurave nga interesat nga kreditë dhe paradhëniet, si dhe nga të ardhurat nga interesat nga letrat me vlerë të investimit. Nga ana tjetër, shpenzimet e interesit u rritën gjithashtu si rezultat i rritjes së bilanceve të depozitave afatgjate të klientëve dhe huamarrjeve nga institucionet financiare.

Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet u rritën me më shumë se 9 përqind në vitin 2025. Rritja e të ardhurave nga tarifat dhe komisionet vjen kryesisht nga biznesi i pagesave bankare, të cilat patën rritje të aktivitetit në periudhën aktuale të raportimit si rezultat i numrit të madh të transaksioneve me diasporën gjatë gjithë vitit dhe më ndjeshëm gjatë verës.

Të ardhurat e tjera u ulën për shkak se departamenti i qendrës së kompetencës bankare, i cili ofronte shërbime të TI-së për kompanitë ndërgrupore, ishte shitur tek Raiffeisen Tech Kosovo (100% degë e Raiffeisen Tech GmbH) që nga korriku 2024, dhe u regjistrua si entitet i veçantë juridik dhe rifilloi shërbimet e tij në mënyrë të pavarur.

### Zhvillimi i shpenzimeve të përgjithshme administrative



Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative për periudhën që përfundoi më 31 dhjetor 2025 ishin 48.8 milionë euro (2024: 47.3 milionë euro). Rritja më e madhe e shpenzimeve operative të bankës ishte në kostot e tjera administrative, të ndjekura nga shpenzimet e personelit dhe ato të lidhura me to, të cilat përfshijnë kosto, të tilla si pagat e punonjësve, trajnimet dhe zhvillimet e tjera profesionale. Këto kosto vazhduan të përfaqësonin një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve operative të bankës.

Raporti i koston dhe të ardhurave ishte 49.2 përqind (2024: 48.2 përqind).

# Menaxhimi i thesarit, asetëve dhe detyrimeve

Funksioni i Thesarit mbikëqyr si menaxhimin e likuiditetit brenda ditës ashtu edhe menaxhimin strategjik të asetëve dhe detyrimeve të Bankës. Objektivi i tij është të sigurojë të ardhura neto të qëndrueshme nga interesi, duke ruajtur njëkohësisht një likuiditet dhe pozicion kapitali të qëndrueshëm afatmesëm dhe afatgjatë. Menaxhimi i financimit është pjesërisht i përfshirë në këtë funksion.

## Menaxhimi i likuiditetit brenda ditës & tregu i parasë

Funksioni lokal i Thesarit është përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit brenda ditës, duke siguruar zbatimin e standardeve minimale në vijim në nivel lokal: rolet dhe proceset e punës të përcaktuara qartë për menaxhimin e likuiditetit brenda ditës; monitorimin ditor të likuiditetit të disponueshëm brenda ditës; aplikimin e një modeli të parashikimit të likuiditetit brenda ditës dhe kufijtë përkatës; si dhe procedurat e përcaktuara të eskalimit dhe masat kontingjente në rast të tejkalimit të kufijve. Në përputhje me kërkesat rregullative, likuiditeti i disponueshëm brenda ditës llogaritet në baza ditore. Menaxhimi i likuiditetit brenda ditës përfshin monitorimin e hyrjeve dhe daljeve ditore, projeksionet e rrjedhave të parasë dhe përbushjen e kërkesave për rezervë në përputhje me rregulloret vendore në fuqi.

## Menaxhimi i asetëve dhe detyrimeve (MAD)

Është përgjegjës për menaxhimin dinamik të bilancit përmes një procesi të vazhdueshëm të formulimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjive për bilancin e Bankës të miratuara nga Komiteti për Menaxhimin e Asetëve dhe Detyrimeve. Njësia menaxhon pozicionin strategjik të normës së interesit, me objektivin kryesor për të maksimizuar vlerën ekonomike të portofolit bankar dhe për të gjeneruar të ardhura neto adekuate dhe të qëndrueshme nga interesi brenda kufijve të miratuar të gatishmërisë për risk. Raiffeisen Bank në Kosovë ka të implementuar Kontabilitetin Mbrojtës të Rrjedhës së Parasë si një mjet për menaxhimin e pozicioneve të normave të interesit. Instrumentet mbrojtëse (derivatet) mbahen për qëllime të menaxhimit të riskut dhe, nëse transakcionet përkatëse plotësojnë kriteret specifike, RBKO i klasifikon ato në marrëdhënie të kontabilitetit mbrojtës.

Menaxhimi i bilancit merr parasysh si likuiditetin ashtu edhe ekspozimin ndaj normës së interesit. Një nga mjetet që RBKO përdor për menaxhimin e këtyre pozicioneve është çmimi i brendshëm i transferimit të fondeve, i cili bazohet në normat e tregut dhe është i dizajnuar për të shpërndarë kostot dhe përfitimet në segmentet e biznesit në mënyrë që të inkurajojë përdorimin efikas të likuiditetit. Si pjesë e kornizës së përgjithshme të menaxhimit të rrezikut, asetet dhe detyrimet e Bankës modelohen dhe analizohen për të pasqyruar në mënyrë adekuate profilin e saj të likuiditetit dhe rrezikut të normës së interesit. Pozicioni i likuiditetit menaxhohet përmes një strategjie konservatore që synon ruajtjen e financimit adekuat afatgjatë, brenda një baze të qëndrueshme depozitash, për të mbështetur programet kreditore të Bankës. Profili i likuiditetit mbahet në një nivel të mjaftueshëm që i mundëson Bankës t'u përgjigjet nevojave të klientëve dhe të përbushë detyrimet e pagesave si në kushte normale ekonomike ashtu edhe në kushte stresi.

Për të siguruar një nivel të përshtatshëm likuiditeti në kushte stresi, Banka mban një rezervë likuiditeti të përbërë nga aktive likuide me cilësi të lartë (HQLA), duke përfshirë paratë e gatshme të mbajtura në Bankën Qendrore dhe obligacionet e pranueshme si kolateral për lehtësirat e likuiditetit të bankës qendrore. Kjo rezervë siguron përputhshmëri si me kërkesat e brendshme ashtu edhe me standardet rregullatore për riskun e likuiditetit në kushte stresi. Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (LCR), një tregues kyç rregullator, është i dizajnuar për të siguruar që të ketë aktive të mjaftueshme likuide për të mbuluar daljet neto të likuiditetit gjatë një periudhe stresi prej 30 ditësh. Në përputhje me kërkesat rregullatore, Banka duhet të mbajë një nivel të LCR-së mbi pragun minimal prej 100%.

Në fund të vitit 2025, Raiffeisen Bank në Kosovë raportoi një LCR prej 273%, duke tejkaluar ndjeshëm minimumin rregullator.

## Menaxhimi i financimit

Funksioni i Thesarit është gjithashtu përgjegjës për Menaxhimin e Financimit dhe për përditësimin e rregullt të planit të financimit të Bankës. Plani i financimit pasqyron rritjen e parashikuar të biznesit, zhvillimin e bilancit dhe pagesat e planifikuara për periudhën përkatëse, si dhe nevojat e pritshme për financim. Ai gjithashtu përfshin ndikimin e zhvillimeve të tregut dhe kërkesave rregullatore, të gjitha brenda kornizës së menaxhimit të strukturës së kapitalit të Bankës.


Gjatë vitit 2025, Raiffeisen Bank në Kosovë ka krijuar marrëdhënie të reja me Finance in Motion dhe OPEC, si dhe ka vazhduar partneritetin e saj të suksesshëm me BERZH-in në vitin 2025 duke nënshkruar marrëveshje të ndryshme, përmes të cilave Banka do të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) në forcimin e qëndrueshmërisë së tyre, rritjen e konkurrueshmërisë dhe kontributin në kalimin drejt ekonomisë së gjelbër. Këto marrëveshje do të mbështesin kreditimin e NVM-ve gjatë viteve në vijim në kushte më të favorshme financimi (si stimuj, kërkesa të reduktuara për kolateral dhe kushte të tjera tërheqëse).

## Thesari dhe bankimi investues / të ardhurat fikse

Në vitin 2025, normat e interesit të obligacioneve qeveritare në eurozonë evoluan ndryshe nga trendi rënës i vërejtur në fund të vitit 2024. Ndërsa normat afatshkurtra mbetën kryesisht të qëndrueshme, normat afatgjata u rritën, duke rezultuar në një pjerrësi më të theksuar të kurbës së normave të interesit. Ky zhvillim u nxit nga rritja e qëndrueshme ekonomike, presionet e vazhdueshme inflacioniste dhe pritjet e reduktuara për lehtësim të shpejtë të politikës monetare.

Gjithashtu gjatë vitit 2025, Raiffeisen Bank në Kosovë mbeti një nga pjesëmarrësit kryesorë në tregun lokal të obligacioneve, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të tregut sekondar për obligacionet e Qeverisë së Kosovës përmes rritjes së vëllimit të tregtimit. Përveç aktiviteteve të saj kryesore kreditore, Banka investoi likuiditetin e saj si në obligacione qeveritare vendore ashtu edhe në ato të huaja gjatë gjithë vitit, duke i shfrytëzuar ato si një alternativë tërheqëse investimi që ofron kthime konkurruese.

### Pjesa e tregut, letrat me vlerë neto



Banka absorboi likuiditetin e tepërt kryesisht përmes investimeve financiare, duke e përmbyllur vitin me një portofol total prej 322 milionë €, pjesa më e madhe e të cilit kualifikohet si aktive likuide me cilësi të lartë (HQLA). Pjesa e HQLA-ve u rrit më tej për të siguruar përputhshmëri të plotë me kërkesat e detyrueshme rregullatore për likuiditetin. Portofoli i përgjithshëm përbëhet kryesisht nga letra me vlerë qeveritare. Në vitin 2025, Raiffeisen Bank në Kosovë ruajti pozicionin e saj si lider i tregut në portofolin e letrave me vlerë, duke rritur pjesën e saj të tregut në 27%.

## Tregu i parasë

Gjatë vitit 2025, portofoli i tregut të parasë mbeti i qëndrueshëm dhe u menaxhua në mënyrë efektive. Zgjatjet e maturitetit u realizuan në përputhje me të gjitha kufizimet e aplikueshme, duke siguruar që nevojat për likuiditet të Bankës dhe klientëve të saj të përmbusheshin në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha valutat.

Kjo njësi mbështeti menaxhimin afatshkurtër të likuiditetit duke rritur vëllimin e transaksioneve ndërbankare si në tregun vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar, duke forcuar dhe zhvilluar më tej aktivitetin ndërbankar.

# Segmentet e biznesit

Deri në dhjetor 2025, Raiffeisen Bank në Kosovë u shërbente 362,000 klientëve aktivë, që përfaqëson një rritje prej 9% në baza vjetore dhe reflekton besimin e qëndrueshëm të klientëve si dhe fokusin e vazhdueshëm të Bankës në ofrimin e përvojave me cilësi të lartë në segmentet individuale dhe të biznesit.

Raiffeisen Bank në Kosovë ruan një prani të gjerë në të gjithë vendin, duke siguruar ofrim të qashtëm dhe të qëndrueshëm të shërbimeve. Banka operon me 35 degë në të gjitha rajonet e Kosovës, të plotësuara nga platformat e bankimit digjital 24/7 që ofrojnë qasje të vazhdueshme në shërbimet bazë. Gjatë vitit, rrjeti i bankomatëve u zgjerua nga 156 në 168 njësi, duke përmirësuar më tej lehtësinë dhe qasshmërinë për klientët. Përveç kësaj, një infrastrukturë e gjerë e POS-ve vazhdoi të mbështesë rritjen e pagesave elektronike të sigurta dhe efikase në të gjithë vendin.

Në vitin 2025, Banka vazhdoi të forcojë modelin e saj të biznesit të orientuar nga klienti përmes inovacionit digjital, zgjerimit të zgjidhjeve kreditore dhe integrimin më të thellë të parimeve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (MSQ) në segmentet për individë, NVM dhe korporata.

Një fushë kyçe e fokusit ishte zgjerimi i mëtejshëm i kapaciteteve të kreditimit digjital. Platforma RaiKesh u përmirësua me funksionalitete të reja, duke përfshirë një veçori aplikimi të dyfishtë që u mundëson klientëve të aplikojnë njëkohësisht për kredi personale dhe karta krediti brenda një procesi të vetëm digjital. Përveç kësaj, prezantimi i kredive për tregtarët zgjeroi zgjidhjet financiare si për klientët individualë ashtu edhe për ata të biznesit. Këto zhvillime u mbështetën nga përmirësime të matshme të performancës, duke përfshirë një rritje prej 48% të vëllimit të shitjeve digjitale dhe faktin që 54% e të gjitha aplikimeve për kredi personale u realizuan përmes kanaleve digjitale. Shuma maksimale e kredisë personale u rrit në 35,000 €, duke përmirësuar më tej qasjen në financim.

Segmenti i NVM-ve shfaqti rritje të fortë të nxitur nga përdorimi i shtuar i kanaleve digjitale dhe aktiviteti afarist. Numri total i transaksioneve të NVM-ve u rrit nga 2.3 milionë në vitin 2024 në 3.5 milionë në vitin 2025, duke përfaqësuar një rritje prej 52% në baza vjetore, ndërsa vëllimi i transaksioneve u rrit për 40%. Banka vazhdoi të përmirësojë ofertën e saj për NVM-të përmes mjeteve digjitale, zgjidhjeve të përshtatura financiare dhe zgjerimit të rrjetit të POS-ve, duke përshpejtuar më tej kalimin drejt pagesave pa para të gatshme.

Paralelisht, Banka vazhdoi të zgjerojë aktivitetet e saj të financimit MSQ. Deri në fund të vitit 2025, portofoli total i MSQ arriti në 141 milionë €, duke përfshirë 25.6 milionë € kredi të gjelbra dhe 115.4 milionë € financim social. Kjo rritje pasqyron angazhimin e Bankës ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, përgjegjësisë mjedisore dhe përfshirjes sociale, veçanërisht në segmentet e NVM-ve dhe korporatave.

Segmenti korporativ mbeti një kontribues kyç në performancën e Bankës, i nxitur nga aktiviteti i fuqishëm në shërbimet e këmbimit valutor, produktet investuese dhe financimin e qëndrueshëm. Prezantimi i zgjidhjeve FX Forward u mundësoi klientëve të menaxhojnë më mirë rrezikun valutor, ndërsa platformat digjitale siguruan që mbi 85% e transaksioneve FX të realizoheshin në mënyrë digjitale. Banka gjithashtu vazhdoi të mbështesë investimet e qëndrueshme, duke përfshirë financimin e projekteve të energjisë solare dhe avancimin e mundësive të tjera të financimit të gjelbër.

Për më tepër, segmenti korporativ përmirësoi kapacitetet e tij digjitale përmes zhvillimit të zgjidhjeve të avancuara të menaxhimit të parasë, duke u mundësuar klientëve ndërkombëtarë të menaxhojnë llogaritë në tregje të shumta dhe të thjeshtojnë operacionet e likuiditetit dhe thesarit brenda një platforme të unifikuar.

Në përgjithësi, këto zhvillime forcojnë pozitën e fuqishme të Bankës në treg, përkushtimin e saj ndaj inovacionit dhe rolin e saj si një institucion financiar lider që mbështet rritjen ekonomike në Kosovë.

# Produktet dhe shërbimet bankare

Në vitin 2025, Raiffeisen Bank në Kosovë vazhdoi të avancojë strategjinë e saj të transformimit digjital, me një fokus të fortë në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve inovative, të orientuara drejt klientit, në të gjitha segmentet.

Angazhimi digjital arriti nivele të reja, duke konfirmuar një zhvendosje të konsiderueshme drejt bankimit me fokus digjital. Banka regjistroi 200,000 klientë aktivë digjitalë, ndërsa vëllimi i transaksioneve përmes telefonit mobil u rrit me 85% në baza vjetore. Kanalet digjitale përbënin 98% të totalit të transaksioneve, duke theksuar përdorimin e gjerë të zgjidhjeve të vetëshërbimit bankar. Kënaqëshmëria e klientëve gjithashtu mbeti në nivel të lartë, me një rezultat të kënaqshmërisë në tregtinë digjitale prej 10.4, ndërsa pagesat ndërmjet individëve u trefishuan krahasuar me vitin paraprak.

Kapacitetet e pranimit dhe integritit të klientëve digjital u përmirësuan më tej, duke kontribuar në rritje të fortë të përvetësimit të klientëve të rinj. Numri i klientëve të rinj individualë që u pranuan dhe u integruan në mënyrë digjitale u rrit për 15%, ku 76% u bashkuan përmes kanaleve digjitale dhe 20% e përfunduan procesin plotësisht online nga fillimi deri në fund. Në segmentin e NVM-ve, pranimi dhe integrimi digjital u përshpejtua ndjeshëm, me një rritje prej 130% të klientëve të pranuar në mënyrë digjitale dhe 11% të proceseve të pranimit dhe integritit të përfunduara plotësisht online.

Banka vazhdoi të prezantojë funksionalitete digjitale inovative për të përmirësuar përvojën e klientit dhe për të zgjeruar ofertën e shërbimeve. Një moment i rëndësishëm ishte lansimi i RAIA, asistenti i parë virtual i fuqizuar nga inteligjenca artificiale në tregun bankar vendor. RAIA trajtoi rreth 60,000 ndërveprime me klientë dhe gjeneroi mbi 420,000 përgjigje të automatizuara, duke zgjidhur me sukses 82% të kërkesave pa ndërhyrje njerëzore. Kjo përmirësoi ndjeshëm efikasitetin e shërbimit, kohën e përgjigjes dhe shkallëzueshmërinë.

Duke përmirësuar më tej ndërveprimin digjital, Banka integroi platformën e saj të sigurt të komunikimit, RConnect, në aplikacionin e bankimit mobil. Kjo zgjidhje u mundëson klientëve të komunikojnë drejtpërdrejt me këshilltarët financiarë përmes mesazheve, thirrjeve me zë dhe video, shkëmbimit të dokumenteve dhe ndarjes së ekranit, duke ofruar një përvojë mbështetëse të pandërprerë dhe efikase.

Në vitin 2025, Banka gjithashtu prezantoi Apple Pay, duke mundësuar pagesa të shpejta, të sigurta dhe pa kontakt përmes pajisjeve mobile. Ky zhvillim përmirësoi lehtësinë për klientët dhe kontribuoi në rritjen e përdorimit të pagesave digjitale, veçanërisht në segmentet më të reja dhe të orientuara drejt teknologjisë.

Për të promovuar mirëqenien financiare dhe sjelljen e përgjegjshme të kursimit, u lansuan funksionalitetet e reja digjitale të kursimit. "Save the Change" u mundëson klientëve të kursejnë automatikisht shuma të vogla përmes transaksioneve të përditshme, ndërsa "Save the Goal" u lejon përdoruesve të vendosin dhe të arrijnë objektiva të personalizuar kursimi përmes kontributeve të automatizuara.

Banka gjithashtu prezantoi produkte të synuara për të mbështetur segmente specifike të klientëve. Paketa Pako VIBE, e dizajnuar për klientët e moshës 16-27 vjeçare, arriti një depërtim të fuqishëm në treg me mbi 22,000 përdorues në vitin e parë, prej të cilëve 95% përdornin në mënyrë aktive shërbimet e bankimit mobil. Kjo paketë mbështet përfshirjen financiare dhe inkurajon adoptimin e hershëm të bankimit digjital.

Përveç kësaj, u lansua Paketa për Startup-e për të mbështetur bizneset e sapokrijuara, duke pranuar dhe integruar më shumë se 2,200 klientë brenda gjashtë muajve të parë. Kjo paketë ofron zgjidhje të përshtatura financiare, duke përfshirë llogari biznesi, shërbime pagesash dhe mjete digjitale, duke mbështetur ndërmarrësinë dhe duke kontribuar në zhvillimin e ekosistemit lokal të biznesit.

Përmes inovacionit të vazhdueshëm, digjitalizimit dhe zgjidhjeve të orientuara drejt klientit, Raiffeisen Bank në Kosovë forcoi më tej pozitën e saj si lider në shërbimet moderne bankare, duke ofruar vlerë të shtuar, lehtësi dhe qashtëri për klientët e saj.

# Përvoja e klientëve

Përvoja e klientëve vazhdoi të jetë një nga shtyllat kryesore strategjike të bankës gjatë vitit 2025, duke reflektuar përkushtimin tonë për ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata të bazuara në besim, lehtësi dhe vlerë reale për klientët tanë. Përmes investimeve të vazhdueshme në teknologji, dizajn të shërbimeve, hulumtim dhe infrastrukturë fizike, banka ka ofruar përvoja gjithnjë e më intuitive, të personalizuara dhe të qasshme, duke vendosur klientin në qendër të çdo vendimi.

Zhvillimi i këtyre produkteve dhe shërbimeve është udhëhequr nga dëgjimi aktiv i klientëve. Gjatë vitit 2025, Banka e forcoi më tej qasjen e saj "Zëri i Klientit" përmes hulumtimeve sasiore dhe cilësore, duke siguruar që vendimmarrja strategjike dhe inovacioni të bazohen fuqishëm në nevojat reale të klientëve. Kjo përfshin matjen e rregullt të Rezultatit Neto të Promovuesve (NPS), si dhe vizitat e Mystery Shopper, grupet e fokusit dhe intervistat e thelluara me klientë, të gjitha të dizajnuara për të ofruar njohuri të vazhdueshme mbi përvojën e klientit.

Përveç kësaj, Banka realizoi hulumtime gjithëpërfshirëse për të kuptuar më mirë prioritetet e klientëve lidhur me funksionalitetet e bankimit mobil. Hulumtimi, i cili përfshiu 600 përdorues aktivë të bankimit digjital dhe vlerësoi 28 funksionalitete të aplikacionit, gjeneroi njohuri të vlefshme mbi preferencat, zakonet e përdorimit dhe pritjet e klientëve. Banka gjithashtu realizoi hulumtime të tjera të synuara, duke përfshirë studimet me Gjeneratën Z, klientë premium dhe segmente të tjera specifike të klientëve, duke i përkthyer këto njohuri në përmirësime konkrete të produkteve, oferta të ridizajnuara dhe zgjidhje bankare të përshtatura.

Përtej hulumtimit, banka vazhdoi të forcojë angazhimin proaktiv me klientët përmes komunikimit të personalizuar digjital. Klientët marrin udhëzime të rregullta për sigurinë, përditësime mbi veçoritë e reja të bankimit mobil dhe përmbajtje edukative që mbështet planifikimin më të mirë financiar.

Për të forcuar më tej qasshmërinë, Banka operon një Qendër Kontaktuese 24/7, duke ofruar mbështetje dhe udhëzim të vazhdueshëm për klientët në çdo kohë. Përvoja e klientëve me Qendrën Kontaktuese matet rregullisht përmes anketave pas ndërveprimit, me mbi 2,000 përgjigje ndaj komenteve dhe vlerësimeve të mbledhura gjatë vitit 2025.

# Menaxhimi i rrezikut

Banka Raiffeisen në Kosovë është e përkushtuar ndaj një qasjeje proaktive dhe dinamike për menaxhimin e rrezikut, duke siguruar që aktivitetet e bankës të mbeten të shëndetshme, të qëndrueshme dhe reziliente në një mjedis financiar në zhvillim. Banka e njej rëndësinë e një kulture të fortë, e cila i referohet qëndrimeve, vlerave dhe standardeve të përbashkëta që formësojnë sjelljet lidhur me ndërgjegjësimin për rrezikun, marrjen e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut.

Kultura e rrezikut përfshin vlerat korporative, normat, qëndrimet, kompetencat dhe sjelljet që lidhen me ndërgjegjësimin për rrezikun (perceptimin e rrezikut) dhe marrjen e rrezikut. Banka ka një kulturë të qëndrueshme të rrezikut dhe mbështet vazhdimisht ndërgjegjësimin e duhur për rrezikun, sjelljet dhe gjykimet lidhur me marrjen e rrezikut brenda një kornize të fortë të qeverisjes së rrezikut. Një kulturë e zhvilluar mirë e rrezikut forcon menaxhimin e rrezikut, inkurajon marrjen e kujdeshme të rrezikut dhe siguron që kërcënimet potenciale përtej orensit për rrezik të bankës të identifikohen, vlerësohen dhe zbuten me kohë.

Si institucion financiar, banka është e ekspozuar ndaj shumë llojeve të rrezikut si pjesë e aktiviteve bankare. Për të identifikuar, matur dhe menaxhuar në mënyrë aktive dhe efektive rreziqet, banka vazhdon të zhvillojë dhe avancojë kornizën dhe sistemin e saj gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut. Menaxhimi i rrezikut është pjesë integrale e menaxhimit të përgjithshëm të bankës. Banka ka të vendosur një sistem parimesh dhe procedurash për matjen dhe monitorimin e rrezikut, i cili synon menaxhimin e rreziqeve materiale. Rreziqet kreditore, të tregut, të likuiditetit dhe operacionale maten, kufizohen, zbuten, agregohen dhe krahasohen me kapitalin në dispozicion për mbulimin e rrezikut. Banka gjithashtu shfrytëzon analiza të avancuara të të dhënave dhe modelim parashikues për të përmirësuar identifikimin dhe parandalimin e rrezikut, duke mundësuar një qasje të orientuar drejt së ardhmes në vlerësimin e rrezikut. Përveç respektimit të kërkesave ligjore dhe rregullatore, banka merr parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteve të saj afariste për të siguruar që rreziqet të kuptohen mirë dhe të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme.

Rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (MSQ) njihen si faktorë ndërdimensionale që ndikojnë në të gjitha fushat e menaxhimit të rrezikut. Në përgjigje të sfidave globale në rritje lidhur me qëndrueshmërinë, banka integron në mënyrë aktive konsiderata MSQ në kornizën e saj të rrezikut për të siguruar rezistencë afatgjatë dhe përputhshmëri me praktikat më të mira ndërkombëtare. Këta faktorë, të vlerësuar përmes një kornize të materialitetit të zhvilluar brenda bankës, janë të integruar në menaxhimin e llojeve të ndryshme të rrezikut, duke përfshirë rrezikun kreditor, të tregut, operativ dhe të likuiditetit. Duke i dhënë përparësi qëndrueshmërisë, banka synon jo vetëm të ruajë stabilitetin e saj financiar, por edhe të kontribuojë pozitivisht në mbrojtjen e mjedisit, mirëqenien sociale dhe qeverisjen etike. Të gjitha aspektet relevante të menaxhimit dhe monitorimit të rrezikut, aty ku është e aplikueshme, përfshijnë vlerësimin dhe monitorimin e rreziqeve MSQ. Rreziqet klimatike dhe mjedisore (rreziqet e tranzicionit dhe rreziqet fizike) trajtohen, ndër të tjera, përmes vlerësimit gjithëpërfshirës të materialitetit dhe analizës së skenarëve klimatikë.

## Rreziku kreditor

Rreziku kreditor i referohet humbjes potenciale financiare që lind kur një klient apo palë tjetër nuk arrin të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale. Ndër rreziqet e ndryshme me të cilat përballet banka, rreziku kreditor është më i rëndësishmi, duke buruar kryesisht nga kreditimi direkt, financimi i tregtisë dhe aktivitetet tjera të lidhura me kreditin me klientët. Menaxhimi efektiv i këtij rreziku është thelbësor për ruajtjen e stabilitetit financiar të bankës dhe sigurimin e rritjes së qëndrueshme të biznesit. Për këtë qëllim, banka ka zbatuar një kornizë gjithëpërfshirëse për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor, e cila është e detajuar në politikat, procedurat dhe standardet përkatëse. Këto dokumente janë plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore të Kosovës dhe janë gjithashtu të harmonizuara me politikat e menaxhimit të rrezikut të Raiffeisen Bank International AG. Korniza përcakton parimet themelore të qeverisjes së rrezikut kreditor, duke theksuar kujdesin, ndërgjegjësimin për rrezikun dhe strategjitë proaktive të zbutjes së rrezikut.

Objektivi kryesor i Menaxhimit të Rrezikut Kreditor është të ruajë një portofol kreditor me cilësi të lartë, të minimizojë përqendrimin e rrezikut dhe të sigurojë provizionim adekuat për humbjet e mundshme kreditore. Përqendrimi i rrezikut kreditor menaxhohet me kujdes përmes kufijve të përcaktuar dhe pragjeve të ekspozimit, të aplikuar në dimensione të ndryshme siç janë palët individuale kontraktuese, sektorët ekonomikë dhe rajonet gjeografike. Për shembull, kufijtë për ekspozim ndaj një klienti të vetëm ndihmojnë në parandalimin e ekspozimit të tepër ndaj një huamarrësi apo grupi të klientëve të lidhur (GCC), ndërsa kufijtë specifikë për industri zbusin rreziqet sektoriale. Përkushtimi i bankës për një portofol kreditor të diversifikuar dhe rezistent përforcohet përmes vlerësimeve të vazhdueshme të rrezikut dhe përshtatjeve strategjike.

Si pjesë e kësaj kornize, proceset e analizës dhe vlerësimit të rrezikut kreditor kryhen para disbursimit të kredisë. Një qasje e strukturuar dhe e bazuar në të dhëna i mundëson bankës të vlerësojë kreditueshmërinë e klientëve, të analizojë rreziqet potenciale dhe të strukturojë kreditë në përputhje me këtë. Për më tepër, për të ruajtur një portofol kreditor të shëndetshëm dhe të balancuar, realizohet monitorim i rregullt i gjendjes financiare të klientëve pas disbursimit. Mbikëqyrja e vazhdueshme dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm i mundësojnë bankës të identifikojë përkeqësimin e mundshëm të gjendjes financiare të huamarrësit, duke mundësuar ndërhyrje në kohë për zbutjen e rreziqeve. Duke përdorur analiza të avancuara, mjete të automatizuara për monitorimin e rrezikut dhe metodologji të testimit të stresit, banka forcon aftësinë e saj për të parashikuar dhe reaguar ndaj rreziqeve të reja kreditore.

Departamenti për Menaxhimin e Portofolit Kreditor dhe Kontrollin e Riskut monitoron nga afër dhe analizon zhvillimet makroekonomike dhe rreziqet në shfaqje në treg dhe në sektorët ekonomikë, si dhe ndërmerr analiza të skenarëve. Kjo i

mundëson Bankës të parashikojë dhe të ndërmarrë veprime kur është e nevojshme, duke përfshirë monitorimin e shtuar, ndryshimin e gatishmërisë për rrezik të bankës dhe/ose përshtatjen e kufijve dhe ekspozimeve, me qëllim të ribalancimit të ekspozimeve dhe menaxhimit të gatishmërisë për rrezik aty ku është e nevojshme. Bazuar në këtë, Banka ndërmerr rishikime të rregullta të treguesve kryesorë të portofolit për të siguruar që rreziqet individuale të klientëve ose të portofolit të kuptohen në mënyrë adekuate dhe që Banka të menaxhojë në mënyrë të përshtatshme nivelin e ekspozimeve të ofruara gjatë çdo periudhe rënieje ekonomike.

Për të ruajtur cilësinë e portofolit të kredive dhe për të parandaluar çdo përkeqësim, gjatë vitit Banka vazhdoi të mbajë kontakte të rregullta me klientët për të siguruar informacionin më të fundit mbi ndikimet e mundshme që mund të prekin operacionet dhe financat e tyre. Bazuar në informacionin e marrë nga klientët, u krye analiza e rrezikut, e fokusuar kryesisht në bizneset dhe individët që u vlerësuan si më të prekur nga situata ekonomike.

Raiffeisen Bank në Kosovë qëndron në një pozicion shumë të mirë duke ruajtur ekspozimin ndaj rrezikut kreditor në nivele të shëndetshme brenda parametrevë të pranueshëm. Ky menaxhim efektiv i rrezikut kreditor është një komponent kyç i një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj menaxhimit të rrezikut dhe thelbësor për suksesin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të bankës.

### *Menaxhimi i ekspozimeve joperformuese*

Në përputhje me kërkesat e BE-së dhe të autoriteteve vendore, Raiffeisen Bank në Kosovë ka zbatuar plotësisht kërkesat rregullatore dhe ka zhvilluar procedura dhe procese të brendshme për menaxhimin e kredive joperformuese. Raiffeisen Bank në Kosovë gjithashtu ka qenë aktive në parandalimin e rasteve të reja të mospërbushjes së detyrimeve dhe në rikuperimin efektiv gjatë vitit 2025. Në përfundim, Banka ka vazhduar të ruajë një strukturë të shëndetshme të portofolit cilësor dhe raporti i mbulimit qëndron në një nivel të kënaqshëm, në përputhje me kufijtë e përcaktuar në Strategjinë e brendshme për Ekspozimet Joperformuese dhe Koston e Rrezikut.

### **Rreziku i likuiditetit**

Mjaftueshmëria e likuiditetit është një komponent kritik për sigurimin e stabilitetit financiar dhe qëndrueshmërisë operationale të Raiffeisen Bank. Ajo vlerësohet si nga perspektiva ekonomike ashtu edhe nga ajo rregullatore. Nga këndvështrimi ekonomik, Banka ka krijuar një kornizë qeverisëse që përfshin kufij të brendshëm dhe masa drejtuese që ndihmojnë në sigurimin që likuiditeti të mbetet në nivele optimale për përmbushjen e detyrimeve financiare. Kjo qasje bazohet në një strukturë të fortë të menaxhimit të rrezikut, e dizajnuar për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet në kushte dinamike të tregut. Raiffeisen Bank menaxhon rrezikun e likuiditetit përmes një kornize gjithëpërfshirëse të politikave dhe procedurave që janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti rregullator. Këto praktika monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga Njësia e Kontrollit të Rrezikut brenda Divizionit të Riskut. Pozicioni i likuiditetit të Bankës analizohet dhe rishikohet rregullisht në disa nivele qeverisëse, duke përfshirë Komitetin për Menaxhimin e Aseteve dhe Detyrimeve (KMAD), Bordin Menaxhues dhe Komitetin e Menaxhimit të Riskut të Bordit Mbikëqyrës. Kjo mbikëqyrje shumë-shtresore siguron që pozicionet e likuiditetit të vlerësohen nga këndvështrime të ndryshme dhe që vendimet të mbështeten nga analiza gjithëpërfshirëse dhe të informuara mirë.

Dimensionin rregullator trajtohet përmes përputhshmërisë me kërkesat e raportimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, veçanërisht në lidhje me treguesit kryesorë të likuiditetit si Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (LCR) dhe Raporti Neto i Financimit të Qëndrueshëm (NSFR). Këta tregues mbështesin aftësinë e Bankës për të ruajtur qëndrueshmërinë e likuiditetit në kushte stresi dhe për të siguruar disponueshmërinë e likuiditetit të mjaftueshëm për të përballuar ndërprerje të mundshme të tregut.

Rreziku afatshkurtër i likuiditetit monitorohet dhe vlerësohet përmes disa mjeteve analitike, duke përfshirë analizën e hendekut të likuiditetit dhe një sërë treguesish të brendshëm. Gjatë vitit 2025, Banka i mbajti të gjithë treguesit e likuiditetit mbi pragjet minimale të përcaktuara si nga kërkesat rregullatore ashtu edhe nga politikat e brendshme, duke tejkaluar nivelin minimal të kërkuar prej 100%. Si rrjedhojë, Banka mbeti në një pozicion të mirë për të përmbushur detyrimet e saj financiare në kohë, edhe në kushte potencialisht të pafavorshme.

Likuiditeti menaxhohet në mënyrë aktive në baza ditore nga Njësia e Thesarit/MAD dhe monitorohet nga afër nga Njësia e Kontrollit të Riskut. Informacioni dhe zhvillimet që lidhen me likuiditetin prezantohen rregullisht në Komitetin për Menaxhimin e Aseteve dhe Detyrimeve (KMAD) për rishikim dhe diskutim. Banka e konsideron rrezikun e saj të likuiditetit si të qëndrueshëm, kryesisht për shkak të diversifikimit të fortë të bazës së depozitave të klientëve dhe strukturës së portofolit të kredive, i cili përbëhet nga një përzierje e balancuar e ekspozimeve kreditore afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Rreziku i financimit zbutet kryesisht përmes mbështetjes në depozitat e klientëve dhe gjatë vitit 2025 banka rriti gjithashtu financimin nga institucionet tejkombëtare. Përveç kësaj, banka monitoron treguesit e përqendrimit të depozitave për të menaxhuar rrezikun e financimit dhe për të siguruar që asnjë burim i vetëm financimi të mos bëhet tepër dominues. Pozicionet e likuiditetit analizohen rregullisht si në kushte të pritshme ashtu edhe në kushte stresi për të siguruar që banka të ruajë qasje në burime të diversifikuara financimi. Planet kontingjente, të mbështetura nga procedura të paracaktuara, janë në fuqi për menaxhimin e ngjarjeve të mundshme të stresit të likuiditetit. Këto plane i mundësojnë bankës të reagojë në mënyrë efektive ndaj krizave të mundshme, duke siguruar vazhdimësinë operationale dhe duke mbrojtur stabilitetin financiar. Korniza ekonomike e rrezikut të likuiditetit bazohet kryesisht në skenarët Going Concern (GC) dhe Time-to-Wall (TTW). Analiza Going Concern vlerëson pozicionin strukturor të likuiditetit të bankës në kushte normale operimi dhe identifikon faktorët kryesorë të rrezikut që mund të ndikojnë negativisht në stabilitetin financiar të saj. Analiza Time-to-Wall vlerëson horizontin e

mbijetesës së bankës në kushte të pafavorshme - duke përfshirë skenarë stresi në nivel tregu, reputacioni dhe të kombinuar - dhe përcakton nivelin minimal të tamponit të likuiditetit ose kapacitetit kundërbalancues të nevojshëm për t'i përballuar këto kushte.

Skenarët e likuiditetit modelohen duke përdorur një kornizë në nivel grupi, duke përfshirë specifika vendore aty ku është e nevojshme për të reflektuar faktorët si mjedisi lokal i tregut dhe karakteristikat specifike të biznesit në Kosovë. Kufijtë e likuiditetit përcaktohen si për kushtet normale të operimit ashtu edhe për skenarët e stresit. Në përputhje me apetitin e përcaktuar për rrezik, Raiffeisen Bank në Kosovë ka demonstruar një horizont mbijetese prej disa muajsh në skenarë të rëndë stresi të kombinuar, duke reflektuar një kapacitet të fortë për të përballuar stresin financiar. Kjo qëndrueshmëri mbështetet ose nga një profil strukturor pozitiv i likuiditetit ose nga mbajtja e një tamponi të mjaftueshëm të likuiditetit.

Në kushte normale të operimit, transformimi i maturitetit duhet të mbulohet plotësisht nga tamponi i disponueshëm i likuiditetit në afat të mesëm. Kjo nënkupton që pozicioni kumulativ i likuiditetit për një periudhë deri në 90 ditë të mbetet pozitiv. Në afat më të gjatë (përtej një viti), transformimi i maturitetit lejohet brenda kufijve të paracaktuar për të siguruar një menaxhim të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit.

## Rreziqet e tregut

Banka e përcakton rrezikun e tregut si rrezikun e humbjeve të mundshme që mund të lindin nga luhatjet e çmimeve të tregut në lidhje me pozicionet tregtare dhe investuese. Ky lloj rreziku ndodh kur lëvizjet në faktorët e tregut, si kursi i këmbimit valutor, normat e interesit, diferencat e kredisë, çmimet e kapitalit dhe çmimet e mallrave, ndikojnë negativisht në të ardhurat e bankës ose në vlerën e portofolit të saj. Rreziku i tregut mund të ndikojë si në aktivitetet afatshkurtra të tregtimit ashtu edhe në strategjitë e investimeve afatgjata, duke kërkuar një menaxhim efektiv për të siguruar stabilitetin e pozicionit financiar të bankës. Rreziku i tregut gjithashtu mund të ndikojë në pikëpamjet kontabël, ekonomike dhe rregullatore të ekspozimit.

Për të menaxhuar në mënyrë efektive rrezikun e tregut, Njësia e Kontrollit të Riskut është përgjegjëse për matjen, monitorimin dhe zbutjen e të gjitha rreziqeve që lidhen me to. Njësia përdor mjete dhe metodologji të avancuara për të vlerësuar ekspozimin e bankës ndaj faktorëve të ndryshëm të tregut. Rezultatet e pozicioneve të rrezikut të tregut dhe analizat shoqëruese u paraqiten rregullisht organeve kryesore të qeverisjes, duke përfshirë Komitetin e Aseteve dhe Detyrimeve (ALCO), Bordin Menaxhues dhe Bordin Mbikëqyrës. Kjo siguron që rreziku i tregut të monitorohet vazhdimisht në nivele të shumfështa të vendimmarrjes dhe që strategjitë të përshtaten në kohë reale me kushtet në zhvillim të tregut. Objektivi kryesor i Menaxhimit të Riskut të Tregut është që ekspozimi i njësive të biznesit ndaj riskut të mbahet brenda gatishmërisë së miratuar të riskut, në përputhje me strategjinë e tyre. Për ta bërë këtë, Menaxhimi i Riskut të Tregut bashkëpunon ngushtë me njësitë e biznesit dhe ekipet e tjera të kontrollit dhe mbështetjes.

Vlerat e mëposhtme maten dhe kufizohen çdo ditë në sistemin e menaxhimit të rrezikut të tregut:

- *Vlera në rrezik (besimi niveli 99 për qind, horizonti rrezikut një ditë)*  
Vlera në rrezik (VaR) është instrumenti kryesor drejtues në tregjet likuide dhe situatat normale të tregut. VaR është kalibruar në një nivel besimi 99% dhe një periudhë mbajtjeje njëditore. Kjo do të thotë që ne vlerësojmë se ka një shans 1 në 100 që një humbje nga raporti i vlerës së tregut nga pozicionet tona tregtare të jetë të paktën aq e madhe sa VaR i raportuar. Sistemi i rrezikut të tregut llogarit shpërndarjen e fitimit dhe humbjes së çdo marrëveshjeje. Rezultatet e një marrëveshjeje të vetme më pas grumbullohen për të marrë vlerësime të VaR-së në nivelin e portofolit. Rezultatet e vlerës në rrezik nuk përdoren vetëm për kufizimin e rrezikut, por edhe në shpërndarjen e kapitalit ekonomik.
- *Ndjeshmëri (ndaj ndryshimeve në kurset e këmbimit dhe normat e interesit)*  
Kufijtë e ndjeshmërisë duhet të sigurojnë që të shmangen përqendrimet në situata normale tregu dhe të jenë instrumenti kryesor drejtues në situata ekstreme të tregut dhe në tregje jollikuide ose në tregje që janë strukturalisht të vështira për t'u matur.
- *Ndalimi i humbjes*  
Ky kufi forcon disiplinën e tregtarëve në mënyrë që ata të mos lejojnë që humbjet të grumbullohen në pozicionet e tyre pronësore, por në vend të kësaj i kufizojnë strikt ato.

Një koncept gjithëpërfshirës i testimit të stresit plotëson këtë sistem limitesh me shumë nivele. Ai simulon ndryshimet e mundshme të vlerës aktuale të skenarëve të përcaktuar për të gjithë portofolin.

## Rreziku operacional

Rreziku operacional përkufizohet si rreziku i humbjeve që rrjedhin nga procese të brendshme të pamjaftueshme ose të dështuara, nga njerëzit apo sistemet, ose nga ngjarje të jashtme, duke përfshirë nënkontraktimin, rrezikun reputacional dhe rrezikun ligjor. Në këtë kategori të rrezikut menaxhohen faktorët e brendshëm të rrezikut, si aktivitetet e paautorizuara, mashtrimet ose vjedhjet, humbjet që lidhen me sjelljen, gabimet në modelim, gabimet në ekzekutim dhe procese, si dhe ndërprerjet e biznesit dhe dështimet e sistemeve. Faktorët e jashtëm, si dëmtimi i aseteve fizike ose mashtrimi, gjithashtu menaxhohen dhe kontrollohen.

Njësia e Kontrollit të Riskut është përgjegjëse për raportimin, zbatimin e kornizës, zhvillimin e masave të kontrollit dhe monitorimin e përputhshmërisë me kërkesat. Në kuadër të ciklit vjetor të menaxhimit të rrezikut, ajo gjithashtu koordinon pjesëmarrjen e departamenteve përkatëse të linjës së dytë të mbrojtjes dhe të gjithë partnerëve të linjës së parë të mbrojtjes (Menaxherët e Rreziut skut Operacional).

Në vitin 2025, Raiffeisen Bank në Kosovë (RBKO) vazhdoi të përmirësojë Kornizën e saj të Menaxhimit të Rrezikut Operacional (KMRRO) për të mbështetur rritjen e qëndrueshme dhe përputhshmërinë rregullatore. Kjo kornizë është e dizajnuar për të siguruar që rreziqet operationale - të përkufizuara si humbje të mundshme që rrjedhin nga proceset e brendshme të papërshtatshme ose të dështuara, njerëzit, sistemet ose ngjarjet e jashtme - të identifikohen, maten, menaxhohen dhe monitorohen në mënyrë efektive në të gjitha njësitë e biznesit. KMRRO është në përputhje me kërkesat e përditësuara rregullatore, duke përfshirë ndryshimet në Rregulloren (BE) Nr. 575/2013, dhe përfshin praktikën më të mira të Grupit RBI. Korniza thekson një kulturë të ndërgjegjshme ndaj rrezikut, përgjegjësi të qarta dhe përmirësim të vazhdueshëm për të zbutur ekspozimet ndaj rrezikut operacional dhe për të mbështetur objektivat strategjike të Bankës.

RBKO operon një strukturë të fuqishme qeverisëse për menaxhimin e rrezikut operacional, e bazuar në modelin e Tri Linjave të Mbrojtjes. Menaxherët e linjave të biznesit shërbejnë si Menaxherët të Rrezikut Operacional (MRRO) dhe mbështeten nga Specialistët të Dedikuar të Rrezikut Operacional (SDRRO), duke siguruar pronësi dhe kontroll të përditshëm të rrezikut. Njësia e Kontrollit të Riskut mbikëqyr zbatimin e KMRRO-së, duke raportuar rregullisht te Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut Operacional, i cili përfshin mbikëqyrje nga menaxhmenti i lartë. Pajtueshmëria, menaxhimi i krimit financiar dhe funksionet tjera të linjës së dytë ofrojnë sfidim të pavarur dhe mbështetje. Bordi Mbikëqyrës dhe komitetet në nivel grupi sigurojnë mbikëqyrje strategjike, duke garantuar që politikën dhe procedurat e rrezikut operacional të jenë të integruara dhe të zbatohen në mënyrë efektive në të gjithë Bankën.

Rreziku operacional menaxhohet përmes një cikli gjithëpërfshirës që përfshin identifikimin, vlerësimin, zbutjen dhe monitorimin e rrezikut. RBKO përdor një sërë mjetesh, duke përfshirë vlerësimet e rrezikut, analizat e skenarëve, treguesit e hershëm paralajmërues dhe një bazë të dhënash të centralizuar për ngjarjet e humbjeve. Masat parandaluese si kontrollat e proceseve, trajnimi i stafit dhe planifikimi kontingjent zbatohen në mënyrë aktive. Banka gjithashtu i kushton rëndësi të veçantë parandalimit të mashtrimit dhe sigurisë së TIK-ut përmes ekipeve të dedikuara për Krimin Financiar dhe Sigurinë e Informacionit. Strategjitë e zbutjes së rrezikut përfshijnë shmangien, pranimin, transferimin dhe reduktimin e rrezikut, me monitorim të vazhdueshëm për të siguruar efektivitetin. Procedurat për raportimin dhe eskalimin e incidenteve janë të vendosura mirë për të adresuar në kohë rreziqet në zhvillim.

RBKO kategorizon rreziqet operationale në lloje kryesore, duke përfshirë mashtrimet e brendshme dhe të jashtme, dështimet e proceseve, rreziqet e sistemeve dhe teknologjisë, rreziqet ligjore dhe të pajtueshmërisë, si dhe rreziqet që lidhen me nënkontraktimin. Rreziku ligjor përfshin humbjet e mundshme që rrjedhin nga mospërputhshmëria me ligjet ose detyrimet kontraktuale. Rreziku i TIK-ut adreson kërcënimet që lidhen me sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit. Banka përjashton rreziqet strategjike dhe reputacionale nga menaxhimi i rrezikut operacional, por pranon lidhjen e tyre të tërthortë. Përveç kësaj, rreziku i krimit financiar dhe rreziku i cilësisë së të dhënave monitorohen në mënyrë aktive si pjesë e mjedisit të rrezikut operacional. Ky kategorizim mundëson menaxhim të synuar të rrezikut dhe alokim efikas të burimeve.

Banka mat ekspozimin ndaj rrezikut operacional duke përdorur metoda cilësore dhe sasiore. Treguesit kryesor të rrezikut (TKRR) dhe të dhënat mbi humbjet mblidhen në mënyrë sistematike dhe analizohen për të identifikuar trendët dhe rreziqet në zhvillim. Analizat e skenarëve ndihmojnë në vlerësimin e ndikimeve të mundshme të ngjarjeve ekstreme, por të mundshme. RBKO llogarit kërkesën e saj rregullatore për kapital për rrezikun operacional duke përdorur qasjen e standardizuar, siç përcaktohet nga korniza e ndryshuar e CRR-së. Raportimi i rregullt të menaxhmenti dhe organet rregullatore siguron transparencë dhe mbështet vendimmarrjen e informuar. Banka rishikon vazhdimisht mjetet dhe proceset e saj të matjes për të përmirësuar saktësinë dhe reagimin ndaj mjedisit në zhvillim të rrezikut.

## Ndryshimet në mjedisin rregullator

Spektori bankar i Kosovës konsiderohet shumë dinamik me ndryshimet në legjisllacion në përputhje me direktivat e BE-së. Si pjesë e Grupit Raiffeisen Bank International (RBI), banka është subjekt i ndryshimeve në mjedisin rregullator në BE. Kjo mundëson që banka të përshtatet paraprakisht me ndryshimet në rregulloret vendore, të cilat synojnë të harmonizohen me rregulloret e BE-së.

Banka ndoqi nga afër zhvillimet aktuale dhe ato të ardhshme rregullatore në vitin 2025. Gjatë vitit, asnjë rregullore e re apo ndryshim rregullator i nxjerrë nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) nuk hyri në fuqi. Ligji për Bankat u hartua dhe u rishikua në konsultim me sektorin bankar gjatë gjithë vitit 2025. Banka vazhdoi të operojë në përputhje me kërkesat ekzistuese rregullatore dhe të ruajë praktikën e saj të menaxhimit të rrezikut në përputhje me kornizën në fuqi.

# Njerëzit, Kultura dhe Mësimi (NJKM)

Në thelb të vlerave kulturore të bankës dhe pjesë përbërëse e strategjisë për zhvillimin e një fuqie punëtore të fuqishme është ambicia e bankës për të qenë punëdhënësi kryesor në Kosovë. Në vitin 2025, ky objektivi nxit i iniciativa për të kultivuar një mjedis pune ku njerëzit ndihen të vlerësuar, të respektuar dhe të mbështetur, si dhe për të pozicionuar Bankën si një punëdhënësi që ruan dhe tërheq talente të jashtëzakonshme. Banka vazhdoi fokusin e saj në zhvillimin e një mjedisi pune që inkurajon bashkëpunimin, performancën e lartë, gjithëpërfshirjen, mësimin e vazhdueshëm, zhvillimin e karrierës dhe mirëqenien e punonjësve të saj.

Në Anketën vjetore të Angazhimit të Punonjësve për vitin 2025, Banka arriti një rezultat rekord të Angazhimit (Kënaqshmërisë) prej 90% dhe një normë pjesëmarrjeje (përgjigjeje) prej 90.3%. Këto rezultate dëshmojnë se punonjësit janë në qendër të strategjisë organizative të Bankës. Angazhimi dhe përkushtimi i Bankës ndaj njerëzve të saj u shpërblyen me dy çmime: "Punëdhënësi më i mirë në vitin 2025" nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe rikonfirmimi si "Family Friendly Workplace Champion" nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA). Në vitin 2025, Raiffeisen Bank në Kosovë përcaktoi Propozimin e saj të Vlerës për Punonjësit: "Duke nxitur rritjen tuaj. Duke u kujdesur për atë që ka rëndësi."

Duke u mbështetur në progresin e vitit paraprak, viti 2025 ruajti një fokus të fortë në komunitetin teknologjik të Bankës. Në përputhje me trendet e tregut dhe objektivat strategjike të Bankës në teknologji dhe digjitalizim, Banka mbeti e përkushtuar për të ofruar një përvojë të jashtëzakonshme për profesionistët e saj të teknologjisë. Gjatë gjithë vitit, u realizuan një sërë iniciativash për të forcuar brendimin si punëdhënësi, për të përmirësuar tërheqjen dhe mbajtjen e talenteve, si dhe për të mbështetur zhvillimin profesional në sektorin e teknologjisë. Aktivitetet kryesore përfshinë Tech4Tech, Hackathon-e për Të dhëna dhe Inteligjencë Artificiale, sesione për Sigurinë e TI-së, si dhe angazhime të tjera të synuara.

Në dhjetor të vitit 2025, Raiffeisen Bank në Kosovë kishte 899 punonjës.

Duke parë strukturën demografike të fuqisë punëtore, Banka ka një ekip të larmishëm dhe relativisht të ri, me një moshë mesatare prej 38 vjeç. Femrat përbëjnë 59 për qind, ndërsa meshkujt përbëjnë 41 për qind të fuqisë totale punëtore.

## Diversiteti, barazia dhe gjithëpërfshirja

Banka vlerëson diversitetin e perspektivave, aftësive, përvojës dhe nevojave. Parimet e diversitetit janë të mishëruara në kulturën korporative të bankës, e cila përcakton mënyrën se si punonjësit veprojnë, komunikojnë, trajtojnë dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Diversiteti është një komponent kyç i Strategjisë së Bankës për Njerëzit dhe është pjesë e Misionit të saj si punëdhënësi:

"Një punëdhënësi i larmishëm dhe gjithëpërfshirës që nxit mirëqenien e punonjësve, ruan dhe tërheq talentët me një nivel angazhimi prej së paku 70%."

Banka është e përkushtuar për të kuptuar nevojat e ndryshme të punonjësve të saj. Duke kultivuar një fuqi punëtore të larmishme, Banka synon të ofrojë përvoja superiore për palët e interesit, duke siguruar që si punonjësit ashtu edhe klientët të përfitojnë përvoja me cilësi të lartë.

Sa i përket fokusit strategjik në Diversitet, Barazi dhe Gjithëpërfshirje, disa nga objektivat që dëshmojnë përkushtimin e Bankës në vitin 2025 për të qenë një punëdhënësi i larmishëm dhe gjithëpërfshirës ishin:

### 1. Fuqizimi i grave

a. Video "Gratë në Role Eksperte" (Dita Ndërkombëtare e Gruas)

### 2. Avokimi për të drejtat e LGBTI+

a. Java e Krenarisë në Prishtinë (Ngritja e flamurit të LGBTIQ+ para Zyrës Qendrore, pikturimi i shkallëve, materiale promovuese, fushatë e brendshme promovuese)

b. Fushatë e brendshme vetëdijësuese "Diversiteti është ajo që na bashkon të gjithëve"

### 3. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara

a. Punësimi i një personi me aftësi të kufizuara

## Zhvillimi Profesional dhe menaxhimi i talenteve

Gjatë gjithë vitit 2025, pati një përpjekje të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin dhe aftësitë e menaxherëve të njerëzve në lidhje me kapacitetet njerëzore. Raiffeisen Bank në Kosovë (RBKO) zbatoi disa programe për të nxitur talentin, inovacionin dhe përfshirjen në të gjithë fuqinë e saj punëtore. Këto iniciativa janë të dizajnuara për të njohur talentin dhe për të përmirësuar aftësitë e punonjësve dhe menaxherëve më premtues të Bankës. Ato përdorin një kombinim të metodave praktike, jokonvencionale dhe akademike të të mësuarit për të thelluar ekspertizën dhe për të nxitur inovacionin.

- Programi RISE ofroi bursa dhe punë praktike për studentët e TI-së, me një normë të lartë të kalimit në punësim të rregullt.
- Punonjësit kanë qasje në Sistemin e Menaxhimit të Mësimin me mbi 5,000 trajnime, duke përfshirë tema mbi Diversitetin dhe Gjithëpërfshirjen.
- Programi AI Pioneers përgatiti rreth 50 punonjës për transformimin digjital përmes zhvillimit të fokusuar në inteligjencën artificiale, i plotësuar me AI Hackathon-e dhe iniciativa inovative.

## Shëndeti dhe mirëqenia e punonjësve

Raiffeisen pranon se suksesi organizativ është i lidhur ngushtë me mirëqenien e punonjësve. Në vitin 2025, shëndeti dhe mirëqenia e punonjësve u mbështetën përmes dy programeve të strukturuar: HealthyYouMay (i prezantuar për herë të parë) dhe edicioni i tretë i #FeelGoodOctober.

Këto programe ofruan aktivitete të synuara në ambiente të brendshme dhe të jashtme, të fokusuara në aktivitetin fizik, shëndetin mendor dhe ushqimin e shëndetshëm. Iniciativat kryesore përfshijnë E hëna e zakoneve të shëndetshme, E hëna e nisjes energjike, E enjtja e smoothieve dhe E premtja e fokusit, si dhe aktivitete fizike në degë dhe në Zyrën Qendrore, si sesione ecjeje në natyrë, aktivitete në shtigje, shetitje me biçikleta, klasa vallëzimi latino dhe pjesëmarrje në Maratonën e Prishtinës.

Mirëqenia mendore u mbështet përmes sesioneve ndërgjegjësuese, duke përfshirë Shkëputjen nga rrejet sociale, Relaksim përmes frymëmarrjes: Rreziqet shëndetësore të pirjes së duhanit dhe ndikimi i tij psikologjik, si dhe Roli i përdorimit të telefonit në zhvillimin e fëmijëve.

## Punëdhënës miqësor ndaj familjes

Në vitin 2025, RBKO u rikonfirmua si Kompani Kampione në kuadër të Programit për Zgjerimin e Mundësive, i zbatuar nga UNFPA, duke njohur politikat e Bankës për një ambient pune miqësor ndaj familjes. Këto politika mbështesin balancën punë-jetë si për gratë ashtu edhe për burrat, duke kontribuar në fuqizimin ekonomik të grave dhe kujdesin e përbashkët prindëror.

Masat kryesore përfshijnë orar fleksibil të punës dhe një model hibrid të punës, të mbështetur nga objekte në vendin e punës si mensa dhe dhoma sportive. Iniciativat e orientuara drejt familjes përfshijnë Ditën e Familjes në Prishtina Trail, mbështetjen ushqyese për nënat në pritje, udhëzimet për ushqyerjen me gji dhe sesionet lidhëse për nënat. Përveç kësaj, aktivitetet e ndërtimit të ekipit, ekskursionet dhe ngjarjet në natyrë kontribuan në një kulturë pune pozitive dhe gjithëpërfshirëse.

## Transformimi digjital i burimeve njerëzore

Gjatë vitit, banka e përforcoi më tej kornizën për Njerëzit, Kulturën dhe Mësimin përmes një sistemi të avancuar BNJ-ve me përdorim të përbashkët, i cili mundëson menaxhim efikas, të sigurt dhe të shallëzueshëm të fuqisë punëtore. Proceset bazë të BNJ-së janë plotësisht të digjitalizuara, duke përfshirë menaxhimin e të dhënave të punonjësve, aprovimet, nënshkrimin digjital të kontratave dhe pultet interaktive që ofrojnë njohuri në kohë reale mbi të dhënat kyçe të BNJ-së, me qasje përmes një aplikacioni të dedikuar mobil.

Përveç kësaj, u implementua një agjent i BNJ-ssë i mundësuar nga inteligjenca artificiale për të mbështetur punonjësit dhe menaxherët me informacion në kohë dhe udhëzime për proceset. Këto iniciativa theksojnë përkushtimin e Bankës ndaj transformimit digjital, inovacionit dhe një kulture moderne të vendit të punës të orientuar drejt punonjësve.

# Qëndrueshmëria dhe ESG Menaxhimi

Në vitin 2025, Banka vazhdoi të forcojë praktikatat e saj të menaxhimit ESG, duke përfunduar përkushtimin ndaj qëndrueshmërisë, përgjegjësisë sociale dhe qeverisjes. Duke u mbështetur në bazën e fortë të krijuar në vitet e mëparshme, Banka arriti progres të rëndësishëm në dimensionet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes, duke integruar më tej parimet MSQ në operacionet dhe strategjinë e saj të biznesit. Arritjet kryesore përfshijnë:

## Arritjet mjedisore:

Përpjekjet tona të vazhdueshme për të minimizuar gjurmën mjedisore të Bankës përmes menaxhimit proaktiv të burimeve dhe zbatimit të praktikave të qëndrueshme janë fokusuar në arritjen e ndikimit të matshëm mjedisor, duke përfshirë:

- Iniciativat për energji të ripërtëritshme:** U miratuan dhe u disbursuan dy kredi për energji të ripërtëritshme për projekte të paneleve diellore, me një kapacitet prodhimi prej 7.85 GWh, duke furnizuar rreth 970 familje dhe duke reduktuar emetimet e CO<sub>2</sub> me rreth 3,600 tonë.
- Rritja e portofolit MSQ:** Portofoli total MSQ arriti në 141 milionë € deri në fund të vitit 2025, i përbërë nga 25.6 milionë € kredi të gjelbra dhe 115.4 milionë € kredi sociale, duke reflektuar kërkesën e vazhdueshme të lartë për financim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.
- Ekologjia e brendshme dhe menaxhimi mjedisor:** Vazhdim i forcimit të praktikave të brendshme mjedisore të Bankës, duke arritur reduktime të matshme në emetimet operationale dhe mbeturinat:
  - E gjithë flota e automjeteve u konvertua në **100% automjete hibride**, duke reduktuar ndjeshëm konsumin e karburantit dhe emetimet.
  - **Kompensimi i karbonit prej 316.316 tonë CO<sub>2</sub>** u arrit për **143 bileta ajrore për udhëtime afariste**, duke zbutur ndikimin klimatik të udhëtimeve të biznesit.
  - **Sasia totale e mbetjeve të ricikluara arriti në 6,582 kg**, duke dëshmuar përmirësimin e praktikave të ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve.
  - **Riciklimi i letrës rezultoi në kursime prej 39.16 tonë CO<sub>2</sub>**, duke kontribuar drejtpërdrejt në reduktimin e emetimeve dhe objektivat e ekonomisë qarkore.
- Partnitetet dhe fondet:** Fondet EBRD GEFF dhe EBRD SME Go Green u bënë plotësisht operationale dhe pothuajse u shfrytëzuan në tërësi, duke nxitur ndjeshëm investimet e gjelbra tek NVM-të. Përveç kësaj, Banka nënshkroi marrëveshje me BERZH, FEI dhe FKGK për lehtësira të ndarjes së rrezikut, duke përmirësuar qasjen në financim për klientët pa kolateral, veçanërisht në rajonet jashtë Prishtinës.
- Programet e reja të financimit të qëndrueshëm:** Në fund të vitit, Banka nënshkroi marrëveshje të reja strategjike me EBRD PRS, SME Go Digital dhe GEFF III, duke zgjeruar më tej ofertën dhe ndikimin e saj në financimin e qëndrueshëm:
  - **EBRD PRS:** Mekanizëm për ndarjen e rrezikut me ndikim të madh në mbështetjen me kolateral, që synon 40% financim të gjelbër.
  - **SME Go Digital:** Program financimi me stimuj, me fokus kryesor në digjitalizim dhe automatizim, duke mbështetur produktivitetin, efikasitetin dhe inovacionin tek NVM-të.
  - **GEFF III:** Fond stimulues që mbështet investimet në energji të ripërtëritshme (ER) dhe eficiencë të energjisë (EE) për klientët individual dhe NVM-të, duke mundësuar qasje më të gjerë në zgjidhje të qëndrueshme.

## Arritjet sociale:

- Diversiteti dhe gjithëpërfshirja:** Gratë vazhduan të mbajnë 52% të pozitave të menaxhmentit të lartë të bankës, duke ruajtur progres të qëndrueshëm në barazinë gjinore dhe duke tejkaluar objektivin fillestar të bankës për vitin 2024 prej 35%.
- Iniciativat si kompani miqësore ndaj familjes:** U avancua mirëqenia e punonjësve dhe familjeve përmes punës hibride (modeli 80/20), organizimit të Ditës së Familjes në Prishtina Trail, dhuratave për fëmijë më 1 qershor, programeve për ushqimin e nënave dhe përfitimeve të zgjeruara për prindërim, duke nxitur balancë të shëndetshme punë-jetë, angazhim të punonjësve dhe lidhje me komunitetin.
- Shëndeti dhe mirëqenia:** U promovua mirëqenia fizike, mendore dhe sociale e punonjësve përmes 19 aktiviteteve të dedikuara, duke përfshirë programe sportive dhe fitnesi, sesione ndërgjegjësimi dhe shkëputje nga rrjetet sociale, mbështetje psikologjike në vendin e punës, aktivitete ecjeje dhe çiklizmi, si dhe ngjarje në komunitet si Maratona e Prishtinës dhe #FeelGoodOctober. Këto iniciativa kontribuan në një fuqi punëtore më të angazhuar, më të motivuar dhe më të balancuar, gjë që reflektohet në reagimet pozitive të punonjësve dhe treguesit e mirëqenies.
- Përgjegjësia sociale korporative:** Ndikimi në komunitet u forcua përmes mbi 25 sponsorizimeve dhe iniciativave në fushat si sporti, kultura, mjedisi, përfshirja sociale, inovacioni dhe arsimit, duke dëshmuar përkushtimin e vazhdueshëm të Bankës ndaj një CSR të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe me relevancë lokale.

**Arritjet në qeverisje:**

- 1. Partneritetet strategjike dhe instrumentet e ndarjes së rrezikut:** Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare u zgjerua përmes marrëveshjeve me BERZH, FEI dhe FKGK, duke forcuar kornizën e qeverisjes së Bankës, praktikën e menaxhimit të rrezikut dhe mbështetjen për financim gjithëpërfshirës.
- 2.** Në vitin 2025, Banka u vlerësua si Banka më e Mirë për ESG në Kosovë në kuadër të çmimeve Euromoney Awards for Excellence 2025.
- 3. Komunikimi, transparenca dhe raportimi MSQ:** U bënë përmirësime të vazhdueshme në faqen e internetit të Bankës për MSQ për të rritur transparencën dhe angazhimin e palëve të interesit. Paralelisht, Banka organizoi dy vebinare të fokusuar në MSQ për NVM-të, duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke mbështetur klientët në rrugëtimin e tyre drejt qëndrueshmërisë. Për më tepër, duke filluar nga viti 2024, Raporti Jo-Financiar është integruar plotësisht në Raportin Vjetor, duke forcuar transparencën, llogaridhënien dhe përputhshmërinë rregullatore.

Këto arritje dëshmojnë progresin e vazhdueshëm të Bankës në integrimin e parimeve MSQ në strategjinë, operacionet dhe kulturën e saj. Përmes veprimeve të fuqishme mjedisore, iniciativave sociale gjithëpërfshirëse, qeverisjes së fuqishme dhe raportimit transparent, Banka mbetet e përkushtuar fuqishëm për të krijuar vlerë afatgjatë për klientët, punonjësit, komunitetet dhe ekonominë në përgjithësi, duke kontribuar njëkohësisht në një të ardhme më të qëndrueshme.

# Banka Raiffeisen Kosovo J.S.C SH.A

PASQYRAT FINANCIARE TË VEÇANTA TË PËRGATITURA NË PËRPTHJE ME STANDARDET E KONTABILITETIT SNRF  
PËR VITIN E PËRMBYLLUR MË 31 DHJETOR 2025  
ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

## PËRMBAJTJA

Raporti i auditorit të pavarur	35
Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar	37
Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse	38
Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në ekuitet	39
Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë	40
Shënimet për pasqyrat financiare të veçanta	38-111

# Deklarata mbi përgjegjësinë e menaxhmentit

## Për aksionarët dhe Bordin Mbikëqyrës të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a.

Ne kemi përgatitur pasqyrat financiare si më datën 31 dhjetor 2025 dhe për vitin e mbyllur në atë datë, të cilat paraqesin në mënyrë të saktë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a. (në tekstin e mëtejshëm "Banka") si më 31 dhjetor 2025 si dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur. Menaxhmenti është përgjegjës për të siguruar se Banka i mbanë llogaritë në pajtueshmëri me rregulloret bankare të Kosovës dhe të cilat mund të ndryshohen në mënyrë të përshtatshme për të shpallur me saktësi të arsyeshme pozitën financiare të Bankës dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë sipas Standardeve të Kontabilitetit IFRS që përfshijnë edhe Standardet dhe Interpretimet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat janë nxjerrë nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) dhe Komiteti Ndërkombëtar për Interpretime të Raportimit Financiar (IFRIC) i IASB-së, të cilat janë relevante për veprimtarinë e saj dhe të cilat ishin në fuqi për periudhën të cilën e mbulojnë të dhënat. Menaxhmenti ka edhe përgjegjësi të përgjithshme për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm në dispozicionin e vet për të ruajtur asetet e Bankës dhe për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimet dhe parregullsitë tjera.

Menaxhmenti konsideron se, gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, Banka i ka shfrytëzuar politikat adekuate kontabël, të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe janë mbështetur nga gjykime dhe vlerësime të arsyeshme dhe të matura, dhe se gjatë kësaj janë respektuar Standardet përkatëse Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.


Rrjedhimisht, pasqyrat financiare konsiderohen të miratuara nga Bordi Menaxhues

Pristina, Kosovo  
02 Prill 2025

Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



Anita Kovacic  
Bordi Menaxhues i Bankës  
Raiffeisen në Kosovë



Iliriana Toçi  
Bankingu me pakicë  
Anëtare e Bordit Menaxhues



David Heitzinger  
COO/CIO  
Anëtar i Bordit Menaxhues



Deyan Ivanov  
Menaxhimi i riskut  
Anëtar i Bordit Menaxhues

<PLEASE  
CHECK>



# Independent auditor's report

## Për Aksionarin dhe Bordin e Drejtorëve të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C Sh.A.

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të **Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C Sh.A.** ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e veçantë e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, dhe pasqyra e veçantë e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e veçantë e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e veçantë e rrjedhës së parave për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025, si dhe nga shënimet e pasqyrave financiare të veçanta, përfshirë informacionin material për politikat kontabël.

Në opinionin tonë, pasqyrat financiare të veçanta paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën e saj financiare, si dhe rrjedhat e parasë së gatshme për vitin që përfundoi, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF.

### Baza për Opinion

Ne e zhvilluam auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas atyre standardeve përkrahin më tej në seksionin Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët e Kontabilitetit (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA) të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës për Profesionistët e Kontabilitetit. Ne gjithashtu kemi përmbytur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se provat e auditimit të cilat i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### Informacionet e tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë Raportin e Qëndrueshmërisë, të cilin e morëm para datës së këtij raporti të auditorit, dhe Raportin Vjetor të Bankës në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-093, i cili pritet të na vihet në dispozicion pas asaj date.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare të veçanta nuk mbulon informacionin tjetër, dhe ne nuk shprehim dhe as nuk do të shprehim asnjë formë konkluzioni të sigurisë mbi to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të veçanta, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër të identifikuar më sipër dhe, duke vepruar kështu, të shqyrtojmë nëse informacioni tjetër është në pajtueshmëri materiale me pasqyrat financiare të veçanta, apo nëse njohuritë tona të siguruar gjatë auditimit, ose në një mënyrë tjetër paraqiten se janë keq-deklaruar.

Nëse, bazuar në punën të cilën e kemi kryer mbi bazën e informacioneve të tjera që i kemi siguruar para datës së këtij raporti të auditorit, arrijmë në përfundimin se ka një keq-deklarim material të këtyre informacioneve të tjera, nga ne kërkohet që ta raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisje për Pasqyrat Financiare të Veçanta

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të, si dhe për kontrollin e brendshëm të cilin menaxhmenti e përcakton të nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta e të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të veçanta, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar si një biznes në vazhdimësi, duke shpalosur, sipas rastit, çështjet që lidhen me vazhdimësinë e biznesit dhe duke përdorur bazën kontabël të vazhdimësisë së biznesit, përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Bankën ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka alternativë realiste përveçse ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.



## Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Veçanta

Objektivat tona janë që të arrijmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare të veçanta si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditori i cili përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme paraqet një nivel të lartë i sigurisë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithëherë një keq-deklarim material kur ai ekziston. Keq-deklarimet mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo në tërësi, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që ato të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimeve materiale të pasqyrave financiare të veçanta, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje të këtyre rreziqeve dhe sigurojmë prova të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos-zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai i një keq-deklarimi që rezulton nga gabimi, meqenëse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikimin, lëshimet e qëllimshme, keqinterpretimet apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një kuptim të kontrollit të brendshëm që lidhet me auditimin, me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Arrijmë në përfundimin mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga menaxhmenti të bazës kontabël të vazhdimësisë së biznesit dhe, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet të cilat mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar si një biznes i vazhdueshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit lidhur me shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare të veçanta ose, nëse shpalosjet e tilla janë joadekuate, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditorit. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkas që Banka të pushojë së operuari si një biznes me vazhdimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të veçanta, duke përfshirë shpalosjet, dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themeltare në një mënyrë e cila arrin të paraqes një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, në mesin e çështjeve të tjera, në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çfarëdo mangësie të rëndësishme në kontrollin e brendshëm të cilën e identifikojmë gjatë auditimit tonë.


Deloitte Kosova Sh.p.k.

Rr. Ukshin Hoti, Nr.128

Prishtinë, Republika e Kosovës

Prishtinë, Republika e Kosovës

2 prill 2026



Partnere e angazhimit:


Arta Limani

## Pasqyra e veçantë e gjendjes financiare më 31 dhjetor 2025

(shumat janë të shprehura në mijëra euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

	Notes	2025	2024
<b>Pasuritë</b>			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme	8	254,501	183,645
Detyrimet nga bankat	9	49,199	9,491
Letrat me vlerë të investimit	10	322,386	245,584
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	11	1,242,832	1,072,443
Pasuritë e tjera	12	4,570	6,925
Aseti tatimor i shtyrë	29	614	213
Investimet në filiale	13	4,234	4,234
Prona, impiantet dhe pajisjet	14	33,334	34,201
Pasuritë jomateriale	14	9,569	8,845
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,921,239</b>	<b>1,565,581</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrimet ndaj bankave	15	135,082	11,870
Depozitat nga klientët	16	1,551,997	1,329,064
Detyrimet financiare të matura me vlerë të drejtë	17	59	27
Detyrimet e tjera	18	42,855	43,192
Provizionet	18	292	589
Kredi e nënrenditur	19	10,080	10,094
Subordinated loan	19	10,094	-
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,740,365</b>	<b>1,394,836</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar		63,000	63,000
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar		(172)	(579)
Rezervat e tjera		1,955	1,955
Fitimet e mbajtura		116,091	106,369
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>	20	<b>180,874</b>	<b>170,745</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar</b>		<b>1,921,239</b>	<b>1,565,581</b>

Pasqyrat Financiare janë miratuar për publikim në emër të Menaxhmentit të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C Sh.A. dhe janë nënshkruar në emër të tij më datë 2 prill 2026.



**Merita Gjyshinca Peja**  
Zyrtare Kryesore e Financave



**Anita Kovacic**  
Drejtoreshë Ekzekutive  
Kryesuese e Bordit Menaxhues

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 39 deri në 109, e që paraqesin pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

## Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

(shumat janë të shprehura në mijëra euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

		2025	2024
Të ardhurat nga interesi të llogaritura me përdorimin e metodës së interesit efektiv	21	75,183	70,431
Shpenzimet e interesit të llogaritura me përdorimin e metodës së interesit efektiv	21	(5,725)	(1,412)
<b>Të ardhurat neto nga interesi</b>		<b>69,458</b>	<b>69,019</b>
Të ardhurat nga dividendat	22	660	341
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	23	32,782	29,580
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	23	(16,366)	(15,010)
<b>Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet</b>		<b>16,416</b>	<b>14,570</b>
Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare	6	(11,568)	(5,122)
Rikuperimet nga kreditë e shlyera më parë		3,016	2,872
Fitimet ose humbjet nga aktivet dhe detyrimet financiare	24	226	1,033
Të ardhurat e tjera operative	25	5,366	8,860
<b>Të ardhurat neto operative</b>		<b>83,574</b>	<b>91,573</b>
Shpenzimet e personelit	26	(22,293)	(21,965)
Amortizimi i pronës dhe pajisjeve dhe ROU	27	(3,703)	(3,567)
Amortizimi i aktiveve jomateriale	27	(4,266)	(3,218)
Shpenzimet e tjera operative	28	(18,543)	(18,510)
<b>Fitimi para tatimit mbi të ardhurat</b>		<b>34,769</b>	<b>44,313</b>
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat	29	(3,447)	(5,148)
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>31,322</b>	<b>39,165</b>
<b>Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse</b>			
<i>Artikujt që do të riklasifikohen në fitim ose humbje</i>			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		412	52
Ndryshimi neto në mbrojtjet e rrjedhës së parasë		(5)	30
<b>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>31,729</b>	<b>39,247</b>

Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 39 deri në 109, e që paraqesin pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

## Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapital për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

(shumat janë të shprehura në mijëra euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezerva të tjera	Rezerva e vlerës së drejtë	Mbrojtja e rrjedhës së parasë	Totali i kapitalit aksionar
<b>Gjendja më 1 janar 2024</b>	<b>63,000</b>	<b>86,804</b>	<b>1,955</b>	<b>(661)</b>	-	<b>151,098</b>
Fitimi për vitin	-	39,165	-	-	-	39,165
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	52	30	82
Dividenta për aksionarët	-	(19,600)	-	-	-	(19,600)
<b>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse</b>	<b>63,000</b>	<b>106,369</b>	<b>1,955</b>	<b>(609)</b>	30	<b>170,745</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2024</b>	<b>63,000</b>	<b>106,369</b>	<b>1,955</b>	<b>(609)</b>	<b>30</b>	<b>170,745</b>
Fitimi për vitin	-	31,322	-	-	-	31,322
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	412	(5)	407
<b>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse</b>	<b>63,000</b>	<b>137,691</b>	<b>1,955</b>	<b>(197)</b>	<b>25</b>	<b>202,474</b>
<b>Kontributet dhe shpërndarjet</b>	-	-	-	-	-	-
Dividentat për aksionarët	-	(21,600)	-	-	-	(21,600)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2025</b>	<b>63,000</b>	<b>116,091</b>	<b>1,955</b>	<b>(197)</b>	<b>25</b>	<b>180,874</b>

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në ekuitet duhet të lexohet së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 39 deri në 109, e që paraqesin pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

## Pasqyra e veçantë e rrjedhave të parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

(shumat janë të shprehura në mijëra euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

	Shënime	2025	2024
<b>Rrjedhat e parasë së gatshme nga aktiviteti operacional</b>			
Interesi i marrë nga kreditë		67,145	62,478
Interesi i paguar për vendosjet		969	1,261
Interesi i marrë nga letrat me vlerë të investimit		7,256	5,791
Dividentat e marra		660	341
Interesi i paguar për depozitat dhe kredinë e nënrenditur		(2,723)	(2,089)
Tarifat dhe komisionet e marra		32,782	29,580
Tarifat dhe komisionet e paguara		(16,366)	(15,010)
Të ardhurat e tjera nga aktivitetet jo-bankare		8,382	11,732
Kostot e paguara të stafit		(22,594)	(20,782)
Shpenzime të tjera operacionale të paguara		(18,543)	(18,510)
Tatimi i paguar mbi të ardhurat		(5,740)	(3,854)
<b>Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet operacionale para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operacionale</b>		<b>51,228</b>	<b>50,938</b>
<b>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operacionale</b>			
- Rezerva e detyrueshme e likuiditetit		(29,128)	(5,210)
- Detyrimet nga bankat		(1,137)	4,024
- Kreditë dhe paradhëniet për klientët		(181,798)	(162,571)
- Pasuritë e tjera		2,799	(2,996)
- Që duhen paguar klientëve		220,544	111,680
- Depozitat nga bankat		(869)	786
- Detyrimet e tjera		23	307
<b>Rrjedha neto e parave të gatshme nga / (të përdorura në) aktivitetet operacionale</b>		<b>61,662</b>	<b>(3,042)</b>
<b>Rrjedhat e parasë së gatshme nga aktivitetet investuese</b>			
Blerja e pronës, pajisjeve dhe aktiveve jomateriale	14	(7,234)	(8,623)
Të ardhurat nga shitja e pronës dhe pajisjeve		58	181
Investimet në letra me vlerë		(77,901)	12,148
<b>Paratë neto (të përdorura në) / nga aktivitetet investuese</b>		<b>(85,077)</b>	<b>3,706</b>
<b>Rrjedhat e parasë së gatshme nga aktivitetet e financimit</b>			
Shlyerja e huamarrjeve		-	-
Të ardhurat nga huamarrjet		124,065	13,457
Shlyerja e detyrimeve nga qiratë		(730)	(745)
Dividentat e paguara		(19,600)	(23,500)
<b>Rrjedha neto e parave të gatshme (të përdorura në) aktivitetet e financimit</b>		<b>103,735</b>	<b>(10,787)</b>
Efkti i ndryshimeve të kursit të këmbimit		(20)	173
<b>Rritja / (rënia) neto e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj</b>		<b>80,300</b>	<b>(9,950)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	8	65,528	75,478
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2025</b>	<b>8</b>	<b>145,828</b>	<b>65,528</b>

Pasqyra e veçantë e rrjedhave të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 39 deri në 109, e që paraqesin pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

# Shënimet për pasqyrat financiare të veçanta për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

## 1. SUBJEKTI RAPORTUES

Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është aksionari 100 për qind i Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. SH.A. Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është një filial i tërthortë 100 për qind i Raiffeisen Bank International AG, që është kompania mëmë fundore.

Banka operon sipas një licence bankare të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - ("BQK") më datë 8 nëntor 2001. Aktivitetet kryesore të Bankës janë operacionet bankare tregtare dhe me pakicë brenda Kosovës.

Që nga 31 dhjetori 2025, Banka posedon 7 degë dhe 28 nëndegë brenda Kosovës (31 dhjetor 2024: 7 degë dhe 29 nëndegë brenda Kosovës). Zyra e regjistruar e Bankës ndodhet në adresën e mëposhtme: Rruga Robert Doll 99, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

## 2. BAZA E PËRGATITJES

### 2.1 Baza kontabël

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF ("SNRF"). Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur supozimin e parimit të vazhdimësisë.

### 2.2 Ndryshimet e kohës më të fundit të Standardeve të Kontabilitetit SNRF

Banka ka aplikuar disa ndryshime në Standardet e Kontabilitetit SNRF të lëshuara nga BNSK(IASB) të cilat janë në fuqi të detyrueshme për një periudhë kontabël. Miratimi i tyre nuk ka pasur ndonjë ndikim material në shpalosjet apo në shumatat e raportuara në këto pasqyra financiare.

#### ***Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e Rrjedhave të Parasë së Gatshme dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Shpalosjet me titull Marrëveshjet Financiare të Furnizuesit***

Banka ka miratuar ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e Rrjedhave të Parasë së Gatshme dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Shpalosjet me titull Marrëveshjet Financiare me Furnizuesit.

Ndryshimet shtojnë një objektivi të shpalosjes në SNK 7 ku deklarohet se nga një njësi ekonomike kërkohet të shpalosë informacione në lidhje me marrëveshjet e saj financiare me furnizuesit të cilat u mundësojnë përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë efektet e këtyre marrëveshjeve në detyrimet dhe rrjedhat e parasë së gatshme të njësisë ekonomike. Përveç kësaj, SNRF 7 është ndryshuar për të shtuar marrëveshjet financiare me furnizuesit si një shembull brenda kërkesave për shpalosjen e informacionit në lidhje me ekspozimin e një njësie ekonomike ndaj përqendrimit të rrezikut të likuiditetit.

Sipas dispozitave kalimtare, një njësi ekonomike nuk kërkohet të shpalosë:

- informacione krahasuese për çfarëdo periudhë raportimi të paraqitur para fillimit të periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësi ekonomike zbaton për herë të parë këto ndryshime.
- informacione që përndryshe kërkohen nga SNK 7:44H(b)(ii)-(iii) në fillim të periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësi ekonomike zbaton për herë të parë këto ndryshime.

#### ***Ndryshimet e SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare***

Banka ka miratuar ndryshimet në SNK 1, të publikuara në janar të vitit 2020.

Ndryshimet prekin vetëm prezantimin e detyrimeve si afatshkurtra apo jo-afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar dhe jo shumën ose kohën e njohjes së ndonjë aktivi, detyrimi, të ardhure ose shpenzimi, ose informacionin e shpalosur në lidhje me këto zëra. Ndryshimet sqarojnë se klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose jo-afatshkurtra bazohet në të drejtat që ekzistojnë në fund të periudhës raportuese, specifikojnë se klasifikimi nuk ndikohet nga pritjet nëse një njësi ekonomike do të ushtrojë të drejtën e saj për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi, shpjegojnë se të drejtat ekzistojnë nëse marrëveshjet përmbushen në fund të periudhës raportuese, dhe prezantojnë një përkufizim të 'shlyerjes' për të sqaruar se shlyerja i referohet transferimit tek pala tjetër të parave të gatshme, instrumenteve të kapitalit, asetëve apo shërbimeve të tjera.

Banka ka miratuar ndryshimet në SNK 1, të publikuara në nëntor të vitit 2022. Ndryshimet specifikojnë se vetëm marrëveshjet që një njësi ekonomike duhet t'i përmbushë në ose para fundit të periudhës së raportimit ndikojnë në të drejtën e njësisë ekonomike për

të shtyrë shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit (dhe për këtë arsye duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e klasifikimit të detyrimit si afatshkurtër ose jo-afatshkurtër). Marrëveshjet e tilla ndikojnë nëse e drejta ekziston në fund të periudhës së raportimit, madje edhe nëse pajtueshmëria me marrëveshjen vlerësohet vetëm pas datës së raportimit (p.sh., një marrëveshje e bazuar në pozicionin financiar të njësisë ekonomike në datën e raportimit që vlerësohet lidhur me pajtueshmërinë vetëm pas datës së raportimit).

BNSK(IASB) gjithashtu specifikon se e drejta për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit nuk preket nëse një njësi duhet të përmbushë një marrëveshje vetëm pas periudhës së raportimit. Megjithatë, nëse e drejta e njësisë për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi i nënshtrohet përmbushjes së marrëveshjeve nga njësia brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit, një njësi shpallorë informacionin i cili u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë rrezikun që detyrimet të bëhen të pagueshme brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit. Kjo do të përfshinte informacionin në lidhje me marrëveshjet (përfshirë natyrën e marrëveshjeve dhe kohën kur njësia kërkohet që t'i përmbushë ato), vlerën kontabël të detyrimeve përkatëse dhe faktet e rrethanat, nëse ka ndonjë, të cilat tregojnë se njësia ekonomike mund të ketë vështirësi në përmbushjen e marrëveshjeve.

### **Ndryshimet në SNRF 16 Paraqitja e Pasqyrave Financiare**

Banka ka miratuar ndryshimet në SNRF 16. Ndryshimet në SNRF 16 shtojnë kërkesa pasuese për matje për transaksionet e shitjes dhe rimarrjes me qira që përmbushin kërkesat në SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët që duhen kontabilizuar si shitje. Ndryshimet kërkojnë që shitësi-qiramarrësi të përcaktojë 'pagesat e qirasë' ose 'pagesat e rishikuara të qirasë' në mënyrë të tillë që shitësi-qiramarrësi të mos njohë një fitim ose humbje që lidhet me të drejtën e përdorimit të mbajtur nga shitësi-qiramarrësi, pas datës së fillimit.

Ndryshimet nuk ndikojnë në fitimin ose humbjen e njohur nga shitësi-qiramarrësi në lidhje me ndërprerjen e pjeseshme ose të plotë të një kontrate të qirasë. Pa këto kërkesa të reja, një shitës-qiramarrës mund të ketë njohur një fitim mbi të drejtën e përdorimit që e ruan vetëm për shkak të një ri matjeje të detyrimit të qirasë (për shembull, pas një modifikimi të qirasë ose ndryshimi të afatit të qirasë) me zbatimin e kërkesave të përgjithshme në SNRF 16.

Kjo mund të kishte qenë veçanërisht rasti në një rimarrje me qira që përfshin pagesa të ndryshueshme të qirasë të cilat nuk varen nga një indeks apo normë.

Si pjesë e ndryshimeve, BSNK-ja ndryshoi një Shembull Ilustrues në SNRF 16 dhe shtoi një shembull të ri për të ilustruar matjen pasuese të një aktivi me të drejtë përdorimi dhe detyrimi të qirasë në një transaksion shitjeje dhe rimarrjeje me pagesa qiraje të ndryshueshme të cilat nuk varen nga një indeks ose normë. Shembujt ilustrues sqarojnë gjithashtu se detyrimi i cili lind nga një transaksion i shitjes dhe i rimarrjes me qira që kualifikohet si shitje duke zbatuar SNRF 15 është një detyrim qiraje.

Një shitës-qiramarrës zbaton ndryshimet në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 për transaksionet e shitjes dhe rimarrjes me qira të lidhura pas datës së zbatimit fillestar, e cila përcaktohet si fillimi i periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësi ekonomike zbatoi për herë të parë SNRF 16.

## **2.3 Standardet e reja dhe të rishikuara të Kontabilitetit SNRF janë nxjerrë, por nuk janë ende në fuqi**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, grupi nuk i ka zbatuar Standardet e reja dhe të rishikuara në vijim të Kontabilitetit SNRF që janë lëshuar, por që ende nuk janë në fuqi dhe nuk janë miratuar ende:

- Ndryshimet në SNK 21 Mungesa e Këmbyeshmërisë
- SNRF 18 Prezantimi dhe Shpallorjet në Pasqyrat Financiare
- SNRF 19 Filialet pa Përgjegjësi Publike: Shpallorjet

Drejtorët nuk presin që miratimi i standardeve të radhitura më sipër të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të bankës në periudhat e ardhshme, përveç nëse tregohet më poshtë.

### **Ndryshimet në SNK 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit të Valutave të Huaja me titull Mungesa e Këmbyeshmërisë**

Ndryshimet specifikojnë se si të vlerësohet nëse një valutë është e këmbyeshme dhe si të përcaktohet kursi i këmbimit kur ajo nuk është e këmbyeshme.

Ndryshimet përcaktojnë se një valutë është e këmbyeshme në një valutë tjetër kur një njësi ekonomike është në gjendje ta marrë valutën tjetër brenda një afati kohor që lejon një vonesë normale administrative dhe përmes një tregu ose mekanizmi të këmbimit në të cilin një transaksion këmbimi do të krijonte të drejta dhe detyrime të zbatueshme. Një njësi ekonomike vlerëson nëse një valutë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër në një datë matjeje dhe për një qëllim të caktuar. Nëse një njësi ekonomike është në gjendje të marrë jo më shumë se një sasi të parëndësishme të valutës tjetër në datën e matjes për qëllimin e specifikuar, valuta nuk është e këmbyeshme në valutë tjetër.

Vlerësimi nëse një valutë është e këmbyeshme në një valutë tjetër varet nga aftësia e një njësie ekonomike për të blerë valutën tjetër dhe jo nga qëllimi ose vendimi i saj për ta bërë këtë.

Kur një valutë nuk është e këmbyeshme në një valutë tjetër në një datë matjeje, nga një njësi ekonomike kërkohet të vlerësojë kursin e këmbimit 'spot' (të çastit) në atë datë. Objektivi i një njësie ekonomike në vlerësimin e kursit të këmbimit spot(të çastit) është të pasqyrojë kursin me të cilin do të zhvillohej një transaksion i rregullt këmbimi në datën e matjes ndërmjet pjesëmarrësve në treg në kushtet ekonomike mbizotëruese.

Ndryshimet nuk specifikojnë se si një njësi ekonomike e vlerëson kursin e këmbimit të çastit për të përmbushur atë objektivi. Një njësi ekonomike mund të përdorë një kurs këmbimi të vëzhgueshëm pa përshtatje apo një teknikë tjetër vlerësimi. Shembuj të një kursi këmbimi të vëzhgueshëm përfshijnë:

- një kurs këmbimi 'spot'(të çastit) për një qëllim tjetër nga ai për të cilin një njësi e vlerëson këmbyeshmërinë.
- kursi i parë i këmbimit me të cilin një njësi ekonomike mund të marrë valutën tjetër për qëllimin e specifikuar pasi të rivendoset këmbyeshmëria e valutës (kursi i parë pasues i këmbimit).

Një njësi ekonomike e cila përdor një teknikë tjetër vlerësimi mund të përdorë çfarëdo kurs këmbimi të vëzhgueshëm - duke përfshirë kurset nga transaksionet e këmbimit në tregje ose mekanizmat e këmbimit që nuk krijojnë të drejta dhe detyrime të zbatueshme - dhe ta përshtatë atë kurs, sipas nevojës, për të përmbushur objektivin e përcaktuar më sipër.

Kur një njësi vlerëson një kurs këmbimi 'spot'(të çastit) për shkak se një valutë nuk është e këmbyeshme në një valutë tjetër, njësi ekonomike duhet të shpallë informacionin i cili u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të kuptojnë se si valuta e cila nuk është e këmbyeshme në valutë tjetër ndikon, ose pritet të ndikojë, në performancën financiare, pozicionin financiar dhe rrjedhat e parasë së gatshme të njësisë ekonomike.

Ndryshimet shtojnë një shtojcë të re si pjesë integrale të SNK 21. Shtojca përfshin udhëzime zbatimi mbi kërkesat e prezantuar nga ndryshimet. Ndryshimet gjithashtu shtojnë Shembuj të rinj Ilustrues që shoqërojnë SNK 21, të cilët ilustrojnë se si një njësi ekonomike mund të zbatojë disa nga kërkesat në situata hipotetike bazuar në faktet e kufizuara të paraqitura. Përveç kësaj, BSNK bëri ndryshime pasuese në SNRF 1 për t'u përafëruar dhe për t'u referuar SNK 21 të rishikuar për vlerësimin e këmbyeshmërisë.

Ndryshimet janë në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2025 ose më pas, me zbatim të mëparshëm të lejuar. Një njësi ekonomike nuk lejohet të zbatojë ndryshimet në mënyrë retrospektive. Në vend të kësaj, një njësi ekonomike kërkohet të zbatojë dispozitat specifike kalimtare të përfshira në ndryshime.

Drejtorët e kompanisë nuk parashikojnë që zbatimi i këtyre ndryshimeve mund të ketë ndikim në pasqyrat financiare të bankës në periudhat e ardhshme.

### **SNRF 18 Prezantimi dhe Shpalljet në Pasqyrat Financiare**

SNRF 18 zëvendëson SNK 1, duke i çuar përpara shumë nga kërkesat në SNK 1 të pandryshuara dhe duke i plotësuar ato me kërkesa të reja. Veç kësaj, disa paragrafë të SNK 1 janë zhvendosur në SNK 8 dhe SNRF 7. Për më tepër, BSNK ka bërë ndryshime të vogla në SNK 7 dhe SNK 33 Fitimet për Aksion.

SNRF 18 prezanton kërkesa të reja për të:

- paraqitur kategori të specifikuar dhe nën-totalë të përcaktuar në pasqyrën e fitimit ose humbjes
- ofruar informacione shpjeguese mbi masat e performancës të përcaktuara nga menaxhmenti (MPM) në shënimet e pasqyrave financiare
- përmirësuar agregimin dhe disagregimin.

Nga një njësi ekonomike kërkohet të zbatojë SNRF 18 për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2027, ku zbatimi i mëhershëm është i lejuar. Ndryshimet në SNK 7 dhe SNK 33, si dhe SNK 8 dhe SNRF 7 të rishikuara, hyjnë në fuqi kur një njësi ekonomike zbaton SNRF 18. SNRF 18 kërkon zbatim retrospektiv me dispozita specifike kalimtare.

Drejtorët e kompanisë parashikojnë që zbatimi i këtyre ndryshimeve mund të ketë një ndikim në pasqyrat financiare të bankës në periudhat e ardhshme.

### **SNRF 19 Filialet pa Përgjegjësi Publike: Shpalljet**

SNRF 19 lejon që një filial i pranueshëm të ofrojë shpallje të reduktuara kur zbaton Standardet e Kontabilitetit SNRF në pasqyrat e saj financiare. Një filial është i pranueshëm për shpallje të reduktuara nëse nuk ka përgjegjësi publike dhe kompania e saj mëmë fundore apo ndonjë kompani mëmë e ndërmjetme prodhon pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik të cilat përputhen me Standardet e Kontabilitetit SNRF.

SNRF 19 është opsional për filialet që janë të pranueshme dhe përcakton kërkesat e shpallje për filialet që zgjedhin ta zbatojnë atë.

Një njësi ekonomike lejohet të zbatojë SNRF 19 vetëm nëse, në fund të periudhës së raportimit:

- është një filial (kjo përfshin një kompani mëmë të ndërmjetme)
- nuk ka përgjegjësi publike, dhe
- kompania e saj mëmë fundore apo çfarëdo kompani mëmë e ndërmjetme prodhon pasqyra financiare të konsoliduara, që janë disponueshme për përdorim publik dhe të cilat përputhen me Standardet e Kontabilitetit SNRF.

Një filial ka përgjegjësi publike nëse:

- instrumentet e saj të borxhit ose të kapitalit tregtohen në një treg publik, apo është në proces të lëshimit të instrumenteve të tilla për tregim në një treg publik (një bursë vendore ose e huaj ose një treg jashtë bursës, përfshirë tregjet lokale dhe rajonale), apo
- ajo mban aktive në një cilësi fiduciare për një grup të gjerë të palëve të jashtme si një nga bizneset e saj kryesore (për shembull, bankat, unionet e kreditit, subjektet e sigurimeve, ndërmjetësit/tregtarët e letrave me vlerë, fondet e ndërsjella dhe bankat e investimeve shpesh e plotësojnë këtë kriter të dytë).

Subjektet e pranueshme mund të zbatojnë SNRF 19 në pasqyrat e tyre financiare të konsoliduara, të veçanta apo individuale. Një kompani mëmë e ndërmjetme e pranueshme që nuk zbaton SNRF 19 në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara mund ta bëjë këtë në pasqyrat e saj financiare të veçanta.

Standardi i ri është në fuqi për periudhat raportuese të cilat fillojnë më 1 janar 2027 ose më pastaj, ku zbatimi i mëhershëm lejohet. Nëse një entitet (njësi ekonomike) zgjedh të zbatojë SNRF 19 për një periudhë raportimi më të hershme se periudha raportuese në të cilën ajo zbaton për herë të parë SNRF 18, ajo duhet të zbatojë një grup të modifikuar kërkesash për shpalosje të përcaktuara në një shtojcë të SNRF 19. Nëse një njësi zgjedh të zbatojë SNRF 19 për një periudhë raportimi vjetor përpara se të zbatojë ndryshimet në SNK 21, ajo nuk është e detyruar të zbatojë kërkesat për zbulim në SNRF 19 në lidhje me Mungesën e Këmbyeshmërisë.

Drejtorët e kompanisë nuk parashikojnë që SNRF 19 do të zbatohet për qëllimet e pasqyrave financiare të veçanta dhe të konsoliduara të Bankës.

## 2.4 Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e Bankës e përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare është Euro, meqenëse ajo është valuta e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin Banka operon dhe pasqyron substancën ekonomike të ngjarjeve themelore ("Valuta funksionale"). Të gjitha shumat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur tregohet ndryshe.

## 2.5 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare të veçanta, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

### 3. INFORMACIONI MATERIAL I POLITIKËS KONTABËL

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të veçanta.

#### 3.1 Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston meqenëse Banka është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me të investuarin (filialin) dhe mund të ndikojë në këto kthime nëpërmjet pushtetit të saj mbi subjektin në të cilin ka investuar.

Këto pasqyra financiare përfaqësojnë vetëm rezultatin dhe pozicionin financiar të Bankës dhe nuk përfshijnë ato të filialeve të saj, siç shpjegohet në detaje në Shënimin 13.

Banka përgatit pasqyra financiare të veçanta dhe të konsoliduara në përputhje me SNRF-të. Pasqyrat financiare të konsoliduara përgatiten për qëllime rregullatore vendore dhe nuk publikohen pasi që vetë Banka është një filial në pronësi të plotë dhe kompania mëmë fundore Raiffeisen Bank International prodhon pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik në faqen e internetit <http://www.rbinternational.com>, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF.

Interesat në filiale kontabilizohen me bazë të kostos në pasqyrat financiare të veçanta.

#### 3.2. Transaksione në valutë të huaj

Transaksionet e këmbimit valutor regjistrohen sipas kursit të këmbimit të vlefshëm në ditën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit që vlen në datën e raportimit.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi me kursin e këmbimit të fundvitit të aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në valutë të huaj njihen në fitim ose humbje nën Shënimin 23 Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet dhe Shënimin 24 Fitimet dhe humbjet, diferencat e këmbimit.

#### 3.3. Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

##### 3.3.1. Klasifikimi i aktiveve financiare

Banka i klasifikon të gjitha pasuritë e saj financiare bazuar në modelin biznesor për menaxhimin e asetëve dhe kushtet kontraktuale të asetëve, të matura me njërin nga vlerat në vijim:

- kostoja e amortizuar;
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI); dhe
- vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL).

##### 3.3.2. Klasifikimi i Detyrimeve Financiare

Të gjitha detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me kosto të amortizuar, përveç zërave të mëposhtëm që maten me FVTPL:

- Detyrimet financiare që mbahen për tregtim - duke përfshirë derivatet;
- Detyrimet financiare që lindin kur një transferim i një aktivi financiar nuk kualifikohet për çregjistrim ose kur zbatohet qasja e përfshirjes së vazhdueshme;
- Garancitë financiare dhe zotimet kreditore me interes nën normën e tregut;
- Shuma kontingjente e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi;
- Detyrimet financiare që janë përcaktuar si me (FVTPL) në njohjen fillestare.

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare në bazë të kostos së amortizuar dhe me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

##### 3.3.3. Modeli Biznesor

Banka përcakton modelin e saj biznesor në nivelin i cili e pasqyron më së miri mënyrën se si ajo menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit.

Modeli biznesor i Bankës nuk vlerësohet në bazë të instrumentit veç e veç, por në një nivel më të lartë të portofoleve të agreguara dhe bazohet në faktorë të vëzhgueshëm siç janë:

- Si vlerësohet dhe raportohet performanca e modelit biznesor dhe aktivet financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesor tek personeli kryesor i menaxhmentit të subjektit (njësisë ekonomike);
- Rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit biznesor (dhe aktivet financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesor) dhe, në veçanti, në mënyrën se si menaxhohen këto rreziqe.

- Si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara apo në rrjedhat e parasë së gatshme kontraktuale të mbledhur);
- Shpeshtësia, vlera dhe koha e pritshme e shitjeve përbëjnë gjithashtu aspekte të rëndësishme të vlerësimit të Bankës.

Megjithatë, vlerësimi i Bankës është se niveli më i lartë i mundshëm të agregimit është në nivel të departamentit të Bankës. Duhet të përdoren nënportofole të mëtejshme në mënyrë që secili portofol të ketë karakteristikat e njëta ose të ngjashme të mëposhtme;

- Fusha e biznesit;
- TKP-të e vlerësimit të performancës;
- Personeli kryesor i Menaxhmentit (B-1);
- Rreziqet dhe proceset e menaxhimit të rrezikut;
- Infrastruktura e TI-së.

Vlerësimi i modelit biznesor bazohet në skenarë të pritshëm në mënyrë të arsyeshme pa marrë parasysh skenarët e 'rastit më të keq' ose 'rastit të stresit'. Nëse rrjedhat e parasë së gatshme pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë që është e ndryshme nga pritshmëritë origjinale të Bankës, Banka nuk e ndryshon klasifikimin e aktiveve financiare të mbetura të mbajtura në atë model biznesor, por e inkorporon këtë informacion gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapokrijtura ose të blera rishtazi në vijim.

### 3.3.4. Karakteristika e flukseve monetare kontraktuale

Për aktivet financiare me model biznesor që ka të bëjë me mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale, banka vlerëson nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar krijojnë në data specifike rrjedha të parasë së gatshme që janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interes mbi shumën e papaguar të kryegjësë. Për këtë qëllim, interesi përkufizohet si kompensim për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun kreditor që lidhet me shumën e kryegjësë të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për rreziqe të tjera bazë të huadhënies (për shembull likuiditeti) dhe kostot (për shembull administrative), si dhe me një marzhë fitimi. Gjatë vlerësimit nëse rrjedhat monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit, banka do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një kusht kontraktual i cili mund ta ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në atë mënyrë që shkakton mos përbushjen e kushtit të tillë.

Banka merr në konsideratë:

- Parapagimi, kushtet e zgjatjes;
- Karakteristikat e leverazheve;
- Pretendimi është i kufizuar në aktive ose flukse monetare të specifikuar;
- Instrumentet e lidhura me kontratë.

Ky vlerësim duhet të kryhet mbi bazën e secilit instrument veç e veç në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar.

### 3.3.5. Modifikimi i vlerës kohore të parasë dhe testi i pikës referuese (Benchmark)

Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që ofron konsideratë vetëm për kalimin e kohës. Ajo nuk merr parasysh rreziqet e tjera (kreditë, likuiditeti etj.) ose kostot (administrative etj.) që lidhen me mbajtjen e një aktiviteti financiar.

Në disa raste, elementi i vlerës në kohë të parasë mund të modifikohet (i papërsosur). Ky do të ishte rasti, për shembull, nëse norma e interesit të një aktiviteti financiar rivendoset periodikisht, por shpeshtësia e asaj rivendosjeje nuk përputhet me afatin e normës së interesit. Në këtë rast, njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin nëse flukset monetare kontraktuale ende përfaqësojnë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit, d.m.th., termi i modifikimit nuk i ndryshon ndjeshëm flukset monetare nga një instrument referues 'i përsosur'. Ky vlerësim nuk është një zgjedhje e politikës kontabël dhe nuk mund të shmanget thjesht duke arritur në përfundimin se një instrument, në mungesë të një vlerësimi të tillë, do të matet me vlerën e drejtë.

Për tiparet kryesore kontraktuale të mëposhtme që potencialisht mund të modifikojnë vlerën në kohë të parasë, zbatohet një test i pikës referuese (Benchmark):

- Shpeshtësia e rivendosjes së normës nuk përputhet me maturimin e interesit;
- Treguesi i ngecjes;
- Klauzolë zbutëse;
- 'Grejs' Periudha;
- Referenca e rendimentit të tregut sekondar.

### 3.3.6. Njohja e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka fillimisht njeh kreditë, të arkëtueshmet dhe detyrimet e tjera financiare në datën në të cilën ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera financiare (përfshirë blerjet e rregullta dhe shitjet e aktiveve financiare) njihen në datën e tregimit, e cila është data në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Një pasuri ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për zërin që nuk është me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të tij.

### 3.3.7. Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

#### 3.3.7.1 Çregjistrimi për shkak të modifikimit thelbësor të termave dhe kushteve

Banka çregjistron një pasuri financiar, siç është një kredi për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegociuar deri në masën që, në thelb, ajo bëhet një kredi e re, me diferencën e njohur si një fitim ose humbje nga çregjistrimi. Kreditë e njohura rishtazi klasifikohen si Faza 1 për qëllime të matjes së ECL-së, përveç nëse kredia e re konsiderohet të jetë POCL.

Kur Banka vlerëson nëse duhet të çregjistrohet apo jo një kredi për një klient, ajo merr parasysh faktorët e mëposhtëm cilësorë:

- Ndryshimi i valutës së kredisë;
- Prezantimi i një tipari të kapitalit;
- Ndryshimi në palën tjetër;
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do ta përbushë më tutje kriterin SPPI

dhe faktorët sasiorë:

- Zgjatje e afatit mesatar të mbetur barazi me ose më shumë se 50% ose më shumë se 2 vjet (kumulative);
- Ndryshimet e shumës së kostos së amortizuar (të zbritur me EIR origjinal) të barabarta ose më shumë se 10% dhe/ose të barabarta ose më shumë se 100 mijë.
- Kreditë e Fazës 3 shpesh mund të ristrukturohen për t'u përputhur me pagesat maksimale të pritshme që mund të përballojë një klient i cili nuk përbushë detyrimet kontraktuale. Nëse rasti është kështu, atëherë një zgjatje përtej 2 viteve nuk rezulton automatikisht.

#### 3.3.7.2 Çregjistrimi përveç modifikimit thelbësor

Në çregjistrim dhe kërkon gjykim për të përcaktuar nëse zgjatja është ekonomikisht një instrument i ri.

Një pasuri financiare (ose, kur është e zbatueshme, një pjesë e një aktivi financiar apo një pjesë e një grupi aktivesh financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse parash nga aktivi financiar kanë skaduar. Banka gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ajo e ka transferuar aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

Banka e ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar; ose
- Ajo ruan të drejtat për flukset monetare, por ka marrë përsipër një detyrim për t'ia paguar plotësisht flukset monetare marra pa vonesë substanciale një pale të tretë sipas një marrëveshjeje 'kalimi'.

Marrëveshjet e kalimit janë transaksione nëpërmjet të cilave Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të një aktivi financiar ('aktivi origjinal'), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ia paguar këto flukse monetare një apo më shumë njësisive ekonomike ('përfituesit e mundshëm'), kur plotësohen të tri kushtet e mëposhtme:

- Banka nuk ka asnjë detyrim t'u paguajë shuma përfituesve të mundshëm, përveç nëse ka mbledhur shuma të barazvlefshme nga aktivi origjinal, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën e rikuperimit të plotë të shumës së dhënë hua plus interesi i akumuluar me norma të tregut.
- Banka nuk mund ta shesë ose ta lërë peng aktivin origjinal përveçse si garanci për marrësit e mundshëm,
- Banka duhet të transferojë çdo fluks monetar që mbledh në emër të përfituesve të mundshëm pa vonesa substanciale.

Përveç kësaj, Banka nuk ka të drejtë t'i ri investojë flukset e tilla monetare, përveç për investimet në para të gatshme ose ekuivalentë të parave të gatshme përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës ndërmjet datës së arkëtimit dhe datës së kërkuar nga marrësi i mundshëm.

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, ose
- Banka as nuk i ka transferuar dhe as nuk i ka mbajtur në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Banka konsideron se kontrolli do të jetë transferuar nëse dhe vetëm nëse, marrësi ka aftësinë praktike për t'ia shitur aktivin në tërësinë e tij një pale të tretë jo të ndërlidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Kur Banka as nuk i ka transferuar dhe as nuk i ka ruajtur në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet dhe ka ruajtur kontrollin e aktivit, aktivi vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, në të cilin rast, Banka njih edhe një detyrim të ndërlidhur. Aktivi i transferuar dhe detyrimi shoqërues maten mbi një bazë që pasqyron të drejtat dhe detyrimet që Banka i ka ruajtur.

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (apo të dyja) mbi aktivin e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet me vlerën që Banka do të duhej të paguante pas riblerjes. Në rastin e një opsioni për shitje me shkrim mbi

një pasuri që matet me vlerën e drejtë, shtirja e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike është e kufizuar në vlerën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit të transferuar dhe çmimit të ushtrimit të opsionit.

### **Detyrimet financiare**

Një detyrim financiar çregjistrohet kur obligimi sipas detyrimit shlyhet, anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës me kushte në mënyrë thelbësore të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues modifikohen në mënyrë thelbësore, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Çregjistrimi kontabilizohet për rastet kur ndryshimet në shumën e kostos së amortizuar (të zbritura me EIR origjinale) janë të barabarta ose më shumë se 10% dhe/ose të barabarta ose më shumë se 100 mijë. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar origjinal dhe shumës të paguar njihet në fitim ose humbje.

#### **3.3.8. Kompensimi**

Pasuritë dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur, Banka ka të drejtën ligjore të kompensojë shumat dhe kur ajo synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Ë ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohet sipas SNRF-ve.

#### **3.3.9. Matja e kostos së amortizuar**

'Kostoja e amortizuar' e një aktivi financiar ose detyrimi financiar është shuma me të cilën matet aktivi financiar apo detyrimi financiar në njohjen fillestare, minus shlyerjet e kryegjësë, plus ose minus amortizimi kumulativ me përdorimin e metodë së interesit efektiv të çfarëdo diference midis shumës fillestare të njohur dhe shumës së maturimit, minus çfarëdo reduktim për shkak të zhvlerësimit.

#### **3.3.10. Matja e vlerës së drejtë**

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të merrej për të shitur një pasuri ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në kryegjënë ose, në mungesë të saj, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mosperformancës së tij.

Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është të përcaktojë se cili do të ishte çmimi i transaksionit (d.m.th. një çmim dalës) në datën e matjes në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve në treg. Vlera e drejtë vlerësohet në bazë të rezultateve të një teknike vlerësimi që shfrytëzon maksimalisht të dhënat e tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në të dhënat specifike të njësisë ekonomike. Një teknikë vlerësimi pritet të arrijë në një vlerësim realist të vlerës së drejtë nëse:

- a) ajo pasqyron në mënyrë të arsyeshme se si pritet që tregu ta vlerësojë çmimin e instrumentit; dhe
- b) inputet në teknikën e vlerësimit përfaqësojnë në mënyrë të arsyeshme pritshmëritë e tregut dhe masat e faktorëve të rrezikut-kthimit të qenësishëm në instrumentin financiar.

Prandaj, një teknikë vlerësimi

- a) përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i merrnin parasysh në përcaktimin e një çmimi; dhe
- b) është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike të për përcaktimin e çmimeve të instrumenteve financiare.

Prova më e mirë e vlerës së drejtë së një instrumenti financiar në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit (p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë). Metodologji të tjera përfshijnë krahasimin e vlerës së drejtë të atij instrumenti përmes krahasimit me transaksione të tjera të vëzhgueshme aktuale të tregut në instrumentin e njëjtë/të ngjashëm (d.m.th. pa modifikim ose ripaketim) ose bazar në një teknikë vlerësimi variabël e së cilës përfshijnë të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme. Qasja e fluksit monetar të skontuar është një teknikë e përdorur për të lidhur shumat e ardhshme (flukset monetare) me të tashmen përmes një norme skontimi.

Konceptet e vlerës aktuale janë me rëndësi kritike për zhvillimin e teknikave për vlerësimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare, sepse çmimi i daljes nga tregu i një instrumenti financiar përfaqëson vlerësimin kolektiv të pjesëmarrësve në treg për vlerën aktuale të flukseve monetare të tij të pritshme. Prandaj, flukset monetare dhe norma e skontimit duhet të pasqyrojnë vetëm faktorët që janë specifikë për instrumentin financiar i cili matet dhe duhet të pasqyrojnë supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin në vlerësimet e tyre të vlerës së drejtë. Gjithashtu, pasi që flukset monetare të përdorura janë vlerësime dhe jo shuma të njohura, një vlerësim i vlerës së drejtë, me përdorimin e vlerës aktuale, bëhet në kushte pasigurie. Meqenëse pjesëmarrësit në treg në përgjithësi kërkojnë kompensim për mbajtjen e pasigurisë së qenësishme në flukset monetare (primi i rrezikut), efekti i ndryshueshmërisë (rrezikut) në flukset monetare duhet të pasqyrohet ose në flukset monetare ose në normën e skontimit.

Gjatë aplikimit të analizës së fluksit monetar të skontuar ("DCF"), Banka duhet të përdorë norma skontimi të barabarta me normat mbizotëruese të kthimit për instrumentet financiare të cilët në thelb kanë të njëjtat kushte dhe karakteristika, përfshirë cilësinë kreditore të instrumentit, afatin e mbetur gjatë të cilit norma e interesit kontraktual është e fikse, afatin e mbetur deri në shlyerjen e kryegjësë dhe valutën në të cilën duhen kryer pagesat. Flukset monetare të përdorura në modelin DCF duhet të "përshtaten" me normën e skontimit dhe gjithashtu duhet të marrin parasysh edhe karakteristikat e përmendura më sipër (p.sh. afatin e mbetur të normës së interesit kontraktual dhe të kryegjësë).

Kur është e disponueshme, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin bëhen me shpeshtësi dhe në vëllim

të mjaftueshëm për të ofruar informacione mbi çmimet në vazhdimësi. Në rast se nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave relevante të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët të cilët pjesëmarrësit në treg do t'i merrnin parasysh në përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shumta e pagueshme sipas kërkesës, e zbritur nga data e parë në të cilën mund të kërkohej që shumta të paguhet. Banka i njej transfertat ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë nga fundi i periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

### 3.3.11. Garancitë financiare, letrat e kreditit dhe zotimet e pa tërhequra të kredive

Banka lëshon garanci financiare, letra kredie dhe zotime kredie. Garancitë financiare njihen fillimisht në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë, që është primi i marrë. Në vijim të njohjes fillestare, detyrimi i Bankës sipas secilës garanci matet me shumën më të lartë midis shumës së njohur fillimisht minus amortizimi kumulativ i njohur në pasqyrën e të ardhurave, dhe sipas SNRF 9 - një provizion ECL. Primi i marrë njihet në pasqyrën e të ardhurave në të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet mbi bazën lineare përgjatë jetëgjatësisë së garancisë. Zotimet e pa tërhequra të kredisë dhe letrat kreditore janë zotime sipas të cilave, përgjatë kohëzgjatjes së zotimit, Banka kërkohej t'i ofrojë klientit një kredi me kushte të paracaktuara. Ngjashëm me kontratat e garancisë financiare, këto kontrata janë në fushëveprimin e kërkesave të ECL.

Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare, e letrave të kreditit dhe zotimeve të pa tërhequra të kredisë, ku kredia e rënë dakord për t'u dhënë ofrohet sipas kushteve të tregut, nuk regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlerat nominale të këtyre instrumenteve janë shpalosur në Shënimin 30 dhe ECL-të përkatëse janë shpalosur në Shënimin 6.

### 3.3.12. Instrumentet Financiare - Zhvlerësimi (SNRF 9)

Matja e zhvlerësimit për humbjet e pritshme kreditore në aktivet financiare të matura me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse është një fushë e cila kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozimeve të rëndësishme mbi kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e pagesave.

Në zbatimin e kërkesave kontabël për matjen e humbjeve të pritshme kreditore kërkohen gjykime të rëndësishme, ndër të tjera:

- Përcaktimi i kriterëve për rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e humbjeve të pritshme kreditore
- Përcaktimi i numrit dhe peshimeve relative të skenarëve parashikues për secilin lloj të produkti/tregu dhe humbjet e pritshme kreditore që lidhen me to.
- Krijimi i grupeve të aktiveve financiare të ngjashme për qëllime të matjes së humbjeve të pritshme kreditore.

Për bankën, rreziku i kreditit vjen nga rreziku i pësimit të humbjes financiare në rast se ndonjë prej konsumatorëve ose palëve të tjera të tregut të bankës nuk i përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Rreziku kreditor lind kryesisht nga kreditë ndërbankare, komerciale dhe personale, si dhe nga zotimet e kredive që rrjedhin nga aktivitete të tilla huadhënëse, por mund të lindë edhe nga garancitë financiare të dhëna, të tilla si garancitë kreditore, letrat e kreditit dhe pranimet. Banka është gjithashtu e ekspozuar ndaj rreziqeve të tjera kreditore të cilat rrjedhin nga investimet në letra me vlerë të borxhit.

Vlerësimi i rrezikut kreditor për qëllime të menaxhimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve, meqenëse rreziku ndryshon me ndryshimet në kushtet e tregut, flukset e pritshme monetare si dhe me kalimin e kohës. Vlerësimi i rrezikut kreditor të një portofoli aktivësh përfshin vlerësime të mëtejshme në lidhje me mundësinë e ndodhjes së mos përmbushjes së detyrimeve, raportet e ndërlidhura të mospagimit dhe korrelacionet e mospagimit ndërmjet palëve të tjera. SNRF 9 përshkruan një model tre-fazor për zhvlerësimin bazuar në ndryshimet në cilësinë kreditore nga pika e njohjes fillestare. Sipas këtij modeli, një instrument financiar i cili nuk është i zhvlerësuar nga krediti në njohjen fillestare klasifikohet në Fazën 1 dhe rreziku i tij kreditor monitorohet vazhdimisht. Sipas SNRF 9, kur maten humbjet e pritshme të kreditit, është e nevojshme të merret parasysh informacionet e parashikueshme. Pasuritë financiare të blera ose të origjinuara me zhvlerësim kreditor (POCI) janë ato aktive financiare që janë të zhvlerësuar nga ana kreditore në momentin e njohjes fillestare. Humbjet e tyre të pritshme kreditore maten gjithmonë mbi bazën e tërë jetëgjatësisë.

Bazuar në procesin e mësipërm, Banka i grupon kreditë e saj në Fazën 1, Fazën 2, Fazën 3 dhe POCl, siç përshkruhet më poshtë:

- Faza 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Banka njeht një shumë rezervë bazuar në ECL 12 mujore. Kreditë e Fazës 1 përfshijnë gjithashtu lehtësira ku rreziku kreditor është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 2. Stage 2: When a loan has shown a significant increase in credit risk since origination, the Bank records an allowance for the Lifetime expected credit losses - LTECLs. Stage 2 loans also include facilities, where the credit risk has improved and the loan has been reclassified from Stage 3.
- Faza 2: Kur një kredi ka shfaqur një rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor që nga krijimi, Banka regjistron një shumë për humbjet e pritshme kreditore përgjatë gjithë jetës - LTECL. Kreditë e Fazës 2 përfshijnë gjithashtu lehtësira, ku rreziku i kreditit është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 3.
- Faza 3: Kreditë që konsiderohen kredi të zhvlerësuar (siç përshkruhet në Shënimin 4). Banka regjistron një shumë rezervë për LTECL-të.
- POCl: Pasuritë e blera ose të origjinuara nga zhvlerësimi kreditor (POCI) janë aktive financiare që kanë pësuar zhvlerësim kreditor në njohjen fillestare. Pasuritë POCl regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi

më pastaj njihen në një EIR të rregulluar të kreditit. ECL-të njihen ose lirohen vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme kreditore. Për asetet financiare për të cilat Banka nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e të gjithë shumës së papaguar, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e aktivitet financiar zvogëlohet. Kjo konsiderohet një cregjistrim (i pjesshëm) i aktivitet financiar.

### ***Rritja e ndjeshme e rrezikut kreditor***

Banka konsideron se një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose mbështetëse janë përmbushur:

#### ***Kriteret sasiore***

Banka përdor kriteret sasiore si tregues kryesor të rritjes së ndjeshme të rrezikut kreditor për të gjitha portofolet materiale plus kriteret cilësore shtesë si vonesa në pagesë prej 30 ditësh ose masa lehtësuese për një strukturë të veçantë si kriteret mbështetëse. Për përcaktimin sasior të fazës, banka krahason kurbën PD të jetëgjatësisë në datën e raportimit me kurbën e parashikuar PD të jetëgjatësisë së ardhshme në datën e njohjes fillestare. Duke pasur parasysh natyrën e ndryshme të segmenteve retail dhe jo-retail, edhe metodat për vlerësimin e rritjeve potenciale të ndjeshme gjithashtu ndryshojnë paksa. Për rrezikun jo-retail, për t'i bërë të krahasueshme dy kurbat, PD-të shkallëzohen në PD-të vjetore. Një rritje e ndjeshme e rrezikut kreditor konsiderohet të ketë ndodhur nëse rritja e PD-së ishte 250 përqind ose më e lartë. Për maturime më të gjata, pragu prej 250 përqind reduktohet për të llogaritur efektin e maturimit. Nga ana tjetër, për ekspozimet retail, PD-të kumulative të mbetura krahasohen si diferenca logit midis "PD-së gjatë gjithë jetës në datën e raportimit" dhe "PD-së gjatë gjithë jetës në origjinë të kushtëzuar nga mbijetesa deri në datën e raportimit". Një rritje e ndjeshme e rrezikut të kreditore konsiderohet të ketë ndodhur kur kjo diferencë logit është mbi një prag të caktuar. Nivelet e pragut llogariten veçmas për secilin portofol i cili mbulohet nga modele individuale të PD-së gjatë gjithë jetës të bazuara në vlerësim. Bazuar në të dhënat historike, pragjet vlerësohen si kuantili i 50-të i shpërndarjes së diferencave logit të sipërpërmendura në portofolin në përkeqësim. Në këtë mënyrë, 50 përqind e përkeqësimit të PD-ve gjatë gjithë jetës me shkallën më të lartë konsiderohet i rëndësishëm. Kjo zakonisht përkthehet në një rritje të PD-së ndërmjet 150 dhe deri në 300 përqind, varësisht nga sjellja e mos pagesës e portofoleve të ndryshme. Për sa i përket pragut në të cilin një instrument financiar duhet të transferohet në fazën 2, Banka ka vendosur për pragjet bazuar në praktikën aktuale të tregut.

#### ***Kriteret cilësore***

Kriteret cilësore të bankës si një tregues dytësor i rritjes së ndjeshme të rrezikut kreditor për të gjitha portofolet materiale.

Një lëvizje në Fazën 2 ndodh kur plotësohen kriteret e mëposhtme. Për portofolet e sovranëve, bankave, klientë të korporatave dhe financimit të projekteve, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Treguesit e tregut të jashtëm
- Ndryshime në kushtet e kontratës
- Ndryshimet në qasjen e menaxhimit
- Gjykimi i ekspertëve

Vlerësimi i një rritjeje të ndjeshme të rrezikut kreditor përfshin informacione parashikuese dhe kryhet në baza tremujore në nivel transaksionesh individuale për të gjitha portofolet e klientëve sovranë, bankave, të korporatave dhe të financimit të projekteve të mbajtura nga banka.

Për portofolet retail, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Ri programimi
- Mos pagesa e ekspozimit tjetër e të të njëjtit klient (segmenti PI)
- Qasje holistike - E zbatueshme për rastet kur informacioni i ri parashikues bëhet i disponueshëm për një segment ose pjesë të portofolit dhe ky informacion nuk është përfshirë ende në sistemin e vlerësimit. Në qoftë se identifikohen raste të tilla, menaxhmenti e mat këtë portofol me humbjet e pritshme kreditore gjatë gjithë jetës (si një vlerësim kolektiv).
- Vlerësimi i rritjes së ndjeshme të rrezikut kreditor përfshin informacione parashikuese dhe kryhet në baza mujore në nivel transaksioni individual për të gjitha portofolet retail të mbajtura nga banka.

### **Mjeti mbështetës/rezerva (Backstop)**

Rezerva (backstop) aplikohet dhe instrumenti financiar konsiderohet se ka përjetuar rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor nëse huamarrësi ka më shumë se 30 ditë që është me vonesë në pagesat e tij kontraktuale. Në disa raste të kufizuara, supozimi se aktivitetet financiare që janë më shumë se 30 ditë të vonuara duhet të zhvendosen në Fazën 2, hidhet poshtë.

### **Përrjashtimi i rrezikut të ulët kreditor**

Në raste të përzgjedhura, kryesisht për letrat me vlerë të borxhit sovran, banka përdor përrjashtimin e rrezikut të ulët kreditor. Të gjitha letrat me vlerë që paraqiten si me rrezik të ulët kreditor kanë një vlerësim të barazvlefshëm me shkallën e investimit ose më të mirë.

Banka nuk e ka përdorur përrjashtimin e rrezikut të ulët kreditor për asnjë biznes kreditues.

### ***Përkufizimi i mospagesës (default) dhe aktiveve të kreditit të zhvlerësuar***

Mospagesa përcaktohet në nenin 178 të CRR si ngjarja kur një debitor specifik i bankës:

1. nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e kredisë ndaj bankës nga burimet parësore, OSE
2. debitori është vonuar më shumë se 90 ditë në çdo detyrim material kreditor ndaj bankës.

Treguesit për klasifikimin 'nuk ka gjasa të paguajë' përfshihen përafërsisht në nenin 178 (3) CRR.

#### ***Jo-Retail***

Banka ka përcaktuar 12 tregues të cilët përdoren aktualisht për të identifikuar kriterin 'nuk ka gjasa të paguajë' dhe vonesat prej 90 ditësh e që duhen duhet të merren parasysh në DDB (fusha: klasifikimi i mospagesës). Kolona 'Klasifikimi' ofron një referencë të cilës nga dy arsyet e renditura më sipër të mospagesës i referohet treguesi.

- Falimentim
- Shlyerje e drejtpërdrejtë
- Detyrimi kreditor/Pretendimi e shlyer kundrejt provizioneve
- Kredi/instrumenti kreditor është thirrur quajtur
- Ristrukturim i vështirë
- Pagesa e interesit është anuluar
- Detyrimi kreditor/Pretendimi shitur me humbje
- Pagesa e vonuar
- Licenca është tërhequr
- Moratoriumi i pagesave
- Humbja e pritshme ekonomike
- Mospagesa e tërthortë (cross default)

Llogaritja e pragut për vonesat materiale.

Pragu i materialitetit të bankës për klientët jo-retail është rregulluar në draft Standardet Teknike Rregullatore (RTS) mbi prapun e materialitetit për detyrimin kreditor në vonesë sipas Nenit 178 të Rregullores (BE) Nr. 575/2013, të miratuar nga Komisioni i BE-së si Rregullore e Deleguar (BE) Nr. 2018/171 - e cila hyri në fuqi më 26 shkurt 2018. Sipas rregullores së lartpërmendur, pragu përbëhet nga një komponent absolut dhe një relativ:

- a. komponenti absolut i pragut përcaktohet si shuma maksimale për shumën e të gjitha shumave të vonuara që një obligues i detyrohet bankës ('detyrim kredie i vonuar') dhe nuk duhet të kalojë 500 euro apo ekuivalentin e kësaj shume në valutën përkatëse kombëtare; dhe
- b. komponenti relativ i pragut vendoset si një raport, i shprehur në përqindje, i shumës së vonuar siç përmendet në pikën (a), kundrejt shumës totale të të gjitha ekspozimeve në bilanc ndaj obliguesit, me përjashtim të ekspozimeve të kapitalit ('detyrimi kreditor në bilanc'); dhe është i barabartë me 1%.

#### ***Retail***

Banka përdor treguesit e mëposhtëm të mospagesës me pakicë: treguesin 90+DPD dhe 17 tregues të kriterit 'nuk ka gjasa të paguajë', duke përfshirë 4 situata të mospagesës së tërthortë.

#### ***90 + ditë vonese***

Për qëllime të zbatimit të pikës (b) të nenit 178(1) të CRR-së, obliguesi konsiderohet se është mospagues në rast se është me vonesë për më shumë se 90 ditë rresht për çdo detyrim material kreditor.

Pragu i materialitetit të bankës përbëhet nga një komponent absolut dhe një relativ:

- Komponenti i pragut absolut është i barabartë me 100 euro.
- Komponenti i pragut relativ është i barabartë me 1% të shumës totale të ekspozimit në bilanc.

Numëruesi i llogaritjes së pragut relativ duhet të përfshijë të gjitha shumat e vonuara që ekzistojnë për një kredi/një obligues (llogaritur në bazë të nivelit të përdorur të aplikimit të mospagesës). Emëruesi i llogaritjes së pragut relativ duhet të përfshijë ekspozimin në bilanc të obliguesit ndaj bankës, duke përfshirë të gjitha shumat e vonuara të konsideruara në numërues.

#### ***Treguesit e kriterit 'nuk ka gjasa të paguajë'***

- Statusi joakrual
- Rregullimet specifike të rrezikut kreditor
- Shitja e borxhit
- Ristrukturimi i vështirë
- Falimentimi
- Mashtrimi me kredi

- Vdekja e obliguesit
- Humbja e të ardhurave
- Borxhi i konsiderueshëm
- Shkelja e marrëveshjeve kontraktuale
- Thirrja e kontratës para maturimit
- Shitja e kolateralit
- POCI

### *Situatat e mospagesës tërthore*

- Mospagesa tërthore e produktit
- Efekti tërheqës
- Mospagesa e detyrimit të përbashkët
- Mospagesa e klientit të lidhur

### **Koncepti i llogaritjes SNRF 9**

SNRF 9 përdor një model të humbjeve të pritshme të kredisë për të njohur rënien në vlerë. Modeli i humbjeve të pritshme të kredisë zbatohet për instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, të arkëtueshme nga qiraja, aktiveve kontraktuale dhe zotimeve të kredisë dhe kontratave të garancive financiare që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Ekzistojnë 3 qasje kryesore të cilat mund të përdoren për të llogaritur humbjet e pritshme kreditore, e ato janë:

- Qasja e përgjithshme
- Qasja e thjeshtuar
- Pasuritë financiare të blera apo të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar.

#### **A. Qasja e Përgjithshme**

Me përdorimin e qasjes së përgjithshme, shumat e humbjeve të pritshme kreditore të njohura si një rezervë ose provizion për humbje varet nga vlerësimi i shkallës së përkeqësimit të kredisë që nga njohja fillestare. Prandaj, ekzistojnë dy mundësi:

- Kur rreziku kreditor për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, banka do të masë shumën e humbjes për atë instrument financiar në një shumë e cila është e barabartë me humbjet e pritshme kreditore 12-mujore (SNRF 9.5.5.5). Këto aktive janë në Fazën 1.
- Kur rreziku kreditor i një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, banka do të masë shumën e humbjes në një shumë që është e barabartë me humbjet e pritshme kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë (SNRF 9.5.5.4). Këto aktive janë në Fazën 2.

Objektivi i kërkesave për rënien në vlerë është të njohja e humbjeve të pritshme kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë për të gjitha instrumentet financiare për të cilat ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor nga njohja fillestare - qoftë nëse vlerësohen në bazë individuale apo kolektive - duke marrë parasysh të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur, përfshirë informacionin parashikues (SNRF 9.5.5.4). Vlerësimi nëse duhet të njihen humbjet e pritshme kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë bazohet në rritjet e konsiderueshme të gjasave ose rrezikut që mospagesa të ndodh që nga njohja fillestare, pavarësisht nëse një instrumenti financiar i është ripërcaktuar çmimi për të reflektuar një rritje të rrezikut kreditor.

#### **B. Qasja e thjeshtuar**

Ekziston një qasje e thjeshtuar e cila ka disa thjeshtëzime operacionale dhe që duhet të zbatohet ose është një zgjedhje e politikave për të arkëtueshmet tregtare, aktivet kontraktuale dhe të arkëtueshmet nga qiraja. Kjo përfshin kërkesën ose zgjedhjen e politikave për të aplikuar qasjen e thjeshtuar e cila nuk kërkon që njësitë ekonomike të gjurmojnë ndryshimet në rrezikun kreditor, sepse të gjitha do të ishin në Fazën 2 si një mundësi praktike për të llogaritur humbjet e pritshme kreditore në të arkëtueshmet tregtare me përdorimin e një matrice të provizionit. Qasja e thjeshtuar nuk zbatohet nga banka.

#### **C. Pasuritë financiare të blera apo të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar**

Për aktivet financiare që janë të kreditit të zhvlerësuar në njohjen fillestare, banka do të njohë vetëm ndryshimet kumulative në humbjet e pritshme kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë që nga njohja fillestare si një shumë humbjeje për aktivet financiare të blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar (SNRF 9.5.5.14). Një pasuri financiar është i kreditit të zhvlerësuar kur kanë ndodhur një ose më shumë ngjarje të cilat kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të atij aktivi financiar.

#### **Kriteret e përcaktimit të fazës**

Në çdo datë raportimi, banka do të vlerësojë nëse rreziku kreditor për një instrument financiar është rritur ndjeshëm nga data e njohjes fillestare (SNRF 9.5.5.9). Analiza e rrezikut kreditor është një analizë j shumëfaktorëse dhe holistike. Kjo do të thotë se vlerësimi bëhet duke përdorur të dhëna cilësore dhe sasiore dhe nëse një faktor specifik është i rëndësishëm dhe pesha e tij krahasuar me faktorët e tjerë do të varet nga lloji i produktit, karakteristikat e instrumenteve financiare dhe huamarrësi, si dhe rajoni gjeografik. Ka mundësi të ndodh gjithashtu që disa faktorë ose tregues të mos janë të disponueshëm në nivel individual

dhe prandaj duhet të vlerësohen në baza kolektive. Në një rast të tillë, faktorët ose treguesit duhet të vlerësohen për portofole të përshtatshme, grupe portofolësh apo pjesë të një portofoli të instrumenteve financiare. Vlerësimi sasior duhet të bëhet duke shqyrtuar ndryshimin në rrezikun e mospagesës që ndodh përgjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar. Kur përcakton nëse kërkohet njohja e humbjeve të pritshme kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë, banka duhet të marrë parasysh informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të panevojshme (SNRF 9.5.5.9). Kjo do të thotë që banka nuk ka nevojë të ndërmarrë një kërkim shterues për informacion gjatë përcaktimit nëse rreziku kreditor është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Për sa kohë që tek banka, ekziston një mjet praktik dhe kushte të caktuara, ndryshimi i rrezikut të mospagesës për disa instrumente financiare ose grupe instrumentesh financiare mund të vlerësohet bazuar në humbjet e pritshme kreditore 12-mujore. Kjo është e mundur për instrumentet financiare për të cilat modelet e mospagesës nuk janë të përqendruara në një pikë specifike përgjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumenteve financiare. Megjithatë, për disa instrumente financiare, apo në disa rrethana, përdorimi i ndryshimeve në rrezikun e mospagesës që ndodh gjatë 12 muajve të ardhshëm ka mundësi të mos jetë i përshtatshëm. Këto rrethana do të ishin:

- Instrumenti financiar ka detyrime të rëndësishme pagese vetëm përtej 12 muajve të ardhshëm;
- Ndryshimet në faktorët përkatës makroekonomikë ose faktorët e tjerë që lidhen me kredinë e që nuk pasqyrohen në mënyrë adekuate në rrezikun e mospagesës për 12 muajt e ardhshëm; ose
- Ndryshimet në faktorët që lidhen me kredinë kanë ndikim vetëm në rrezikun kreditor të instrumentit financiar (ose kanë një efekt më të theksuar) përtej 12 muajve (SNRF 9.B5.5.14).

Duhet theksuar se, me disa përjashtime të cilat lidhen me mjetet praktike të përshkruara më poshtë, vlerësimi për të vendosur nëse rreziku kreditor për një instrument financiar është rritur ndjeshëm duhet të bëhet në bazë relative dhe jo absolute.

Kjo do të thotë se duke pasur parasysh një ndryshim në terma absolutë për një instrument financiar, ka më shumë gjasa të vlerësohet se ka rrezik kreditor i cili është rritur ndjeshëm, nëse rreziku fillestar i kreditor është i ulët në krahasim me nëse ai është i lartë. Një mundësi e tillë praktike është zgjidhja e opsionit të përjashtimit të rrezikut të ulët kreditor, i cili thotë se një njësi ekonomike mund të supozojë se rreziku kreditor për një letër me vlerë (por jo një hua sipas udhëzimeve GRAECL) nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse letra me vlerë përcaktohet se ka rrezik të ulët kreditor në datën e raportimit. Për letrat me vlerë me rrezik të ulët kreditor, banka do të njoh një provizion bazuar në humbjet e pritshme kreditore 12-mujore. Letrat me vlerë nuk konsiderohen të kenë rrezik të ulët kreditor kur ato konsiderohen se kanë një rrezik të ulët humbjeje thjesht për shkak të vlerës së kolateralit. Nga një këndvështrim teorik, rreziku i ulët i kreditor përkufizohet si një letër me vlerë që ka rrezik të ulët mospagese, ku huamarrësi ka një kapacitet të fortë për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale të flukseve monetare dhe kushtet e pafavorshme të ardhshme nuk do ta zvogëlojnë domosdoshmërisht aftësinë e huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij të flukseve monetare kontraktuale. Nga pikëpamja praktike, në bankë, kjo do të thotë se letrat me vlerë që konsiderohen të shkallës investive nuk ka nevojë të vlerësohen për të parë nëse rreziku kreditor për një letër me vlerë është rritur ndjeshëm. Këtu shkalla investive përcaktohet nga agjencitë e jashtme të njohura të vlerësimit/rejtingut si një vlerësim midis AAA-BBB.

## Shkaktarët e fazës 2

### Supozimet në lidhje me shkaktarët që kualifikohen për trajtim të fazës 2

Kur përcaktohet se cili horizont kohor duhet të përdoret për vlerësimin e rrezikut kreditor të rritur ndjeshëm, SNRF 9 BC5.174 thekson që [...] *mos pasqyrimi i strukturës së afatit mund të rezultojë gjithashtu në vlerësimin se rreziku i mospagesës ka ndryshuar thjesht për shkak të kalimit të kohës.*

Kjo mund të ndodhte edhe nëse banka do të kishte pritur një ndryshim të tillë në njohjen fillestare. Sipas mendimit të BSNK-së, vlerësimi i kriterëve nuk duhet të ndryshojë vetëm sepse data e maturimit afrohet. Për më tutje, përderisa rreziku i një mospagese përgjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar zakonisht zvogëlohet me kalimin e kohës, kjo nuk është gjithmonë kështu. Për instrumentet financiare, të cilat kanë vetëm detyrime të rëndësishme pagese afër afatit të maturimit të instrumentit financiar, rreziku i ndodhjes së mospagesës mund të mos ulet automatikisht me kalimin e kohës. Në një rast të tillë, banka duhet të marrë në parasysh edhe faktorët e tjerë cilësorë që do të tregojnë nëse rreziku kreditor është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Rritja e ndjeshme e rrezikut kreditor për qëllime të provizionit të fazës 2 perceptohet në terma të:

- Një masë sasiore, kur kjo mund të llogaritet; dhe
- Një masë cilësore në raste të tjera dhe
- Treguesit e mjetit mbështetës/rezervës (Backstop)

## Shkaktarët cilësorë dhe sasiorë jo-statistikorë

Një numër faktorësh janë të rëndësishëm kur vlerësohet rritja e ndjeshme e rrezikut kreditor, siç sugjeron lista jo-shteruese në SNRF 9 B.5.5.16/17. Prandaj, faktorët cilësorë merren parasysh për të plotësuar vlerësimin e rritjes së rrezikut kreditor dhe gjithashtu në rastet kur ekzistojnë vetëm faktorë cilësorë ose faktorë sasiorë jo-statistikorë, vlerësimi do të drejtohet vetëm nga këta faktorë.

Duke u bazuar në këtë, është e rëndësishme që banka të marrë parasysh informacionin e vëzhgueshëm të tregut në lidhje me rrezikun kreditor të instrumentit të veçantë financiar ose instrumenteve të ngjashme financiare. Ndërtimi i paralajmërimeve jo-statistikorë cilësorë dhe sasiorë bazohet në listën e mëposhtme:

- B5.5.16 "analiza holistike"
- B5.5.17.a "treguesit e brendshëm të çmimeve"

- B5.5.17.b "normat/kushtet"
- B5.5.17.c "treguesit e tregut të jashtëm"
- B5.5.17.d "vlerësimi/rejtingu i jashtëm kreditor"
- B5.5.17.e "vlerësimi i brendshëm kreditor"
- B5.5.17.f "kushtet afariste/financiare/ekonomike"
- B5.5.17.g "rezultatet operative"
- B5.5.17.h "instrumentet e tjera"
- B5.5.17.i "mjedisi i biznesit"
- B5.5.17.j "vlera e kolateralit"
- B5.5.17.k "cilësia e garancisë"
- B5.5.17.l "mbështetje nga njësia mëmë"
- B5.5.17.m "ndryshimet e kontratës"
- B5.5.17.n "performanca dhe sjellja"
- B5.5.17.o "qasje e menaxhimit të kredisë"
- B5.5.17.p "informacioni mbi vonesat"

Ekziston një supozim i kundërshtueshëm se rreziku kreditor për një pasuri financiare është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, më së voni kur pagesat kontraktuale janë më shumë se 30 ditë të vonuara. Supozimi mund të kundërshtohet nëse banka ka informacione të arsyeshme dhe të mbështetura që demonstrojnë se rreziku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare (SNRF 9.5.5.11). Prandaj, ka mundësi të ndodh që supozimi të jetë i kundërshtueshëm kur pagesat kontraktuale janë më shumë se 30 ditë në vonesë nëse:

- Mospagesa ishte një mbikëqyrje administrative
- Banka ka qasje në evidencën historike që tregon se ekziston një korrelacion midis rritjeve të ndjeshme të rrezikut kreditor dhe një numri të ditëve në vonesë që është më e lartë se 30 ditë në vonesë (p.sh. 40 ditë në vonesë ose 50 ditë në vonesë etj.) (SNRF 9.B5.5.20).

Në rastet kur supozimi i kundërshtueshëm hidhet poshtë, duhet theksuar se banka nuk mund ta përafrojë kohën e rritjeve të ndjeshme të rrezikut kreditor dhe njohjen e humbjeve të pritshme kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë me atë se kur një pasuri financiare konsiderohet si i aktiv i kreditit të zhvlerësuar ose kur instrumenti financiar konsiderohet se ka mospagesë (SNRF 9.B5.5.21). Në rastet kur vonesa prej 30 ditësh është hedhur poshtë, do të jetë e nevojshme të vendoset një limit për një kriter kufirit të ri që nuk do të jetë më i lartë se 90 ditë vonesë dhe të sigurohen dëshmi për këtë.

### ***Vlerësimi i transferimit të fazave mbi baza kolektive***

Mund të mos jetë e mundur të vlerësohet nëse ka pasur një rritje të rrezikut kreditor në baza individuale dhe për këtë arsye ky vlerësim mund të kryhet edhe në baza kolektive. Për shembull, ky mund të jetë rasti kur për kreditë retail ka pak ose aspak informacion të përditësuar për rrezikun kreditor që merret dhe monitorohet në mënyrë rutinore në një instrument individual derisa një klient të shkelë kushtet kontraktuale. Në rastet e tilla, humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë do të njihen mbi një bazë kolektive që merr parasysh informacionin gjithëpërfshirës të rrezikut kreditor. Këto informacione gjithëpërfshirëse të rrezikut kreditor duhet të përfshijnë jo vetëm informacionin e vonesës, por edhe të gjithë informacionin përkatës të kreditit, përfshirë informacionin makroekonomik parashikues, në mënyrë që të përafrohet rezultati i njohjes së humbjeve të pritshme kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë kur ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare. Karakteristikat e rrezikut të qirasë. Karakteristikat e përbashkëta të rrezikut kreditor mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, me sa vijon:

- Lloji i instrumentit;
- Vlerësimet e rrezikut kreditor;
- Lloji i kolateralit;
- Data e njohjes fillestare;
- Afati i mbetur deri në maturim;
- Industria;
- Vendndodhja gjeografike e huamarrësit; dhe
- Vlera e kolateralit në raport me aktivin financiar nëse ka ndikim në gjasën e ndodhjes së një mospagese (për shembull, kredi pa rekurs në disa juridiksione ose raportet kredisë ndaj vlerës) (SNRF 9.B5.5.5)

### ***Shkaktarët e fazës 3***

Sipas modelit të përkeqësimit, një instrument financiar duhet të transferohet në fazën 3 (pra, është me kredi të zhvlerësuar) kur kanë ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset e vlerësuar të ardhshme të parave të gatshme. Nëse kërkesat për transferimin e fazave nuk përmbushen për më tutje (pra, instrumenti nuk është më me kredi të zhvlerësuar), ai do të transferohet prapa tek faza 1 ose 2 (pra, qasja është simetrike).

- vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose huamarrësit;
- shkelje të kontratës, siç ngjarje mospagese apo vonesë;
- huadhënësi/ët e huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale që lidhen me vështirësitë financiare të huamarrësit, i kanë dhënë huamarrësit koncesion(e) të cilin huadhënësi(t) në të kundërtën nuk do ta merrte parasysh.
- po bëhet e mundur që huamarrësi të hyjë në falimentim ose në ndonjë riorganizim tjetër financiar;
- zhdukja e një tregu aktiv për atë pasuri financiare për shkak të vështirësive financiare; ose

- blerja ose krijimi i një aktivi financiar me një zbritje të madhe e cila pasqyron humbjet e pësuarat kreditorë.

Për shkak të fushëveprimit të ndryshuar të SNRF 9 krahasuar me SNK 39, gjithashtu edhe zotimet kreditorë dhe kontratat e garancisë financiare do të mbulohen nga i njëjti proces (zëvendësimi i vlerësimit të SNK 37). Ekziston një supozim i kundërshtueshëm se mospagesa nuk ndodh më vonë se sa kur një pasuri financiar është 90 ditë në vonesë, përveç nëse banka ka informacione të arsyeshme dhe të mbështetura për të demonstruar se një kriter i mospagesës më të vonuar është më i përshtatshëm. Përkufizimi i mospagesës i përdorur për këto qëllime duhet të zbatohet vazhdimisht për të gjitha instrumentet financiare, përveç nëse ka informacionet të disponueshme që demonstrojnë se një përkufizim tjetër i mospagesës është më i përshtatshëm për një instrument të veçantë financiar. Për shkak të fushëveprimit të ndryshuar të zhvlerësimit të SNRF 9 krahasuar me SNK 39, do të merren parasysh aspektet e mëposhtme.

Në bankë, përkufizimi i kredisë së zhvlerësuar është në përputhje me përkufizimin (rregullator - Neni 178 CRR) të mospagesës së detyrimeve, meqenëse përkufizimet e mospagesës dhe kreditit të zhvlerësuar janë të ngjashme dhe kjo është në përputhje me proceset aktuale të menaxhimit të rrezikut. Kjo do të thotë se të gjitha instrumentet në kuadër të fushëveprimit të zhvlerësimit sipas SNRF 9, ku pala tjetër është në mospagesë do të transferohen në fazën 3. Për më tepër, kreditë e kolateralizuara plotësisht me provizion zero rreziku, ku pala tjetër është në mospagesë, do t'i caktohen fazës 3 (nëse zbatohet 'modeli i përkeqësimit të kredisë'). Për shkak të nevojës për të llogaritur një ECL me probabilitet të ponderuar, provizionet me rrezik zero në fazën 3 priten vetëm në raste të rralla. Në fund, për shkak të periudhave rregullatore të provës, mund të ketë situata ku provizioni i rrezikut është i ulët apo zero (pasi që banka nuk ka pritshmëri për mospagesa apo vonesa në pagesë), por statusi i mospagesës është ende aktiv. Në rastet e tilla, ekspozimi do të mbetet në fazën 3 për sa kohë që debitori është në mospagesë.

### **Koncepti i përgjithshëm i modelit**

Humbjet e pritshme kreditorë llogariten si shuma të humbjeve marginale që ndodhin në çdo periudhë kohore të datës së bilancit. Humbjet marginale rrjedhin nga parametra individuale që vlerësojnë ekspozimet dhe humbjet në rast të mospagesës dhe probabilitetin marginal të mospagesës për çdo periudhë. Llogaritjet e humbjeve të pritshme kreditorë bazohen në katër komponentë:

- Probabiliteti i mospagesës ("PD") – Ky është një vlerësim i gjasave të mospagesës së detyrimeve përgjatë një horizonti të caktuar kohor.
- Ekspozimi në mospagesë ("EAD") – Ky është një vlerësim i ekspozimit në një datë të ardhshme të mospagesës, duke marrë parasysh ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë shlyerjet e kryeqjësë dhe interesit, dhe tërheqjet e pritura nga lehtësitë e zotuara.
- Humbja në rast mospagesë ("LGD") – Ky është një vlerësim i humbjes që rrjedh nga mospagesa e detyrimeve. Ai bazohet në diferencën midis flukseve monetare kontraktuale dhe atyre që huadhënësi do të priste të merrte, duke përfshirë edhe nga çdo kolateral. Zakonisht shprehet si përqindje e EAD.
- Norma e skontimit – Kjo përdoret për të skontuar një humbje të pritshme në vlerën aktuale në datën e raportimit duke përdorur normën efektive të interesit (EIR) në njohjen fillestare.

Banka do të masë humbjet e pritshme kreditorë të një instrumenti financiar në një mënyrë e cila pasqyron:

- Një shumë të paanshme dhe probabilitetin e ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një varg rezultatesh të mundshme;
- Vlerën e parasë në atë kohë; dhe
- Informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit në lidhje me ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve ekonomike të ardhshme (SNRF 9.5.5.17).

Kur maten humbjet e pritshme kreditorë, banka nuk ka nevojë që domosdoshmërisht të identifikojë çdo skenar të mundshëm. Megjithatë, ajo do të marrë në konsideratë rrezikun ose gjasën që një humbje kreditorë të ndodhë duke pasqyruar mundësinë që një humbje kreditorë të ndodhë dhe mundësinë që mos të ndodhë asnjë humbje kreditorë, qoftë edhe nëse mundësia e ndodhjes së një humbjeve kreditorë është shumë e ulët. Kjo do të thotë që sado e ulët që të jetë gjasa për ndodhjen e një humbjeve kreditorë, ajo nuk do të jetë asnjëherë zero për shkak të ponderimit të probabilitetit.

### **Qasja ndaj zërave në bilanc**

Humbjet e pritshme kreditorë janë një vlerësim me probabilitet të ponderuar të humbjeve kreditorë (d.m.th. vlera aktuale e të gjitha mungesave të parasë së gatshme) përgjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar. Mungesa e parasë së gatshme është diferenca midis flukseve monetare që i detyrohen bankës në përputhje me kontratën dhe flukseve monetare të cilat banka pret t'i marrë. Për shkak se humbjet e pritshme kreditorë marrin parasysh shumën dhe kohën e pagesave, një humbje kreditorë rezulton edhe nëse banka pret që të paguhet plotësisht, por në datë më të vonë se sa data e caktuar me kontratë (SNRF 9.B5.5.28). Qëllimi i vlerësimit të humbjeve të pritshme kreditorë nuk është as vlerësimi i skenarit të rastit më të keq dhe as vlerësimi i skenarit më të mirë. Në vend të kësaj, një vlerësim i humbjeve të pritshme kreditorë duhet të pasqyrojë gjithmonë mundësinë që të ndodhë një humbje kreditorë dhe mundësinë që të mos ndodhë asnjë humbje kreditorë qoftë edhe nëse gjasa më e mundshme është se nuk do të ketë humbje kreditorë.

Prandaj, për qëllime praktike, përdorimi i vlerësimeve me probabilitet të ponderuar të humbjeve kreditorë nuk ka nevojë të marrë në konsideratë një numër të madh skenarësh. Sidoqoftë, humbjet e pritshme kreditorë duhet të pasqyrojnë të paktën dy rezultate (SNRF 9.B5.5.41). Duhet të theksohet se humbjet e pritshme kreditorë 12-mujore janë një pjesë e humbjeve të pritshme kreditorë përgjatë gjithë jetëgjatësisë dhe se përfaqësojnë mungesat e parasë së gatshme përgjatë gjithë jetëgjatësisë të cilat do të rezultojnë nëse ndodh një mospagesë në 12 muajt pas datës së raportimit (apo në një periudhë më të shkurtër nëse jetëgjatësia e pritshme e një instrumenti financiar është më e shkurtër se 12 muajt), të ponderuara me probabilitetin që

ajo mospagesë të mos ndodhë. Për qëllime të matjes së humbjeve të pritshme kreditore, vlerësimi i mungesës së pritshme të parasë së gatshme do të pasqyrojë flukset monetare të pritshme nga kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë që janë pjesë e kushteve kontraktuale dhe nuk njihen veçmas nga banka. Vlerësimi i mungesës së pritshme të parasë së gatshme në një instrument financiar të kolateralizuar pasqyron shumën dhe kohën e flukseve monetare që priten nga përvetësimi i kolateralit minus kostot e marrjes dhe shitjes së kolateralit, pavarësisht nëse përvetësimi është i mundshëm (d.m.th. vlerësimi i flukseve monetare të pritshme merr parasysh probabilitetin e një përvetësimi dhe flukset monetare që do të rezultojnë prej tij). Rrjedhimisht, çdo fluks monetar që pritet nga realizimi i kolateralit përtej maturimit kontraktual të kontratës duhet të përfshihet në këtë analizë. Çdo kolateral i marrë si rezultat i konfiskimit nuk njihet si një pasuri që është i ndarë nga instrumenti financiar i kolateralizuar, përveçse kur plotëson kriteret e njohjes (SNRF 9.B5.5.55). Humbjet e pritshme kreditore do të skontohej deri në datën e raportimit duke përdorur instrumentin e normës së ndryshueshme Humbjet e pritshme kreditore do të skontohej duke përdorur normën aktuale efektive të interesit (SNRF 9.B5.5.44).

### ***Qasja ndaj zërave jashtë bilancit***

Për zotimet e kredive dhe kontratat e garancisë financiare, data në të cilën banka bëhet palë e zotimit të parevokueshëm do të konsiderohet të jetë data e njohjes fillestare për qëllime të zbatimit të kërkesave të zhvlerësimit. Për zotimet e kredive, banka shqyrton ndryshimet në rrezikun e mospagesës së një kredie me të cilën lidhet një zotim i kredisë. Për kontratat e garancisë financiare, banka shqyrton ndryshimet në rrezikun që debitori i specifikuar do të ketë mospagesa në kontratë.

Për një pasuri financiare në të dyja rastet, humbja kreditore është vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale që i detyrohen bankës sipas kontratës dhe flukseve monetare që banka pret t'i marrë. Në rastin e zotimeve të pa tërhequra (papaguara) të kredisë, humbja kreditore është vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale që i detyrohen bankës nëse mbajtësi i zotimeve të kredisë e tërheq kredinë dhe flukset monetare që banka pret t'i marrë nëse kredia tërhiqet. Vlerësimi i Bankës për humbjet e pritshme kreditore për zotimet e kredive do të jetë në përputhje me pritshmëritë e saj për tërheqje të këtij zotimi të kredisë, pra, ajo do të marrë parasysh pjesën e pritshme të zotimit të kredisë që do të tërhiqet brenda 12 muajve nga data e raportimit, kur vlerësohen humbjet e pritshme kreditore 12 mujore dhe pjesën e pritshme të zotimit të kredisë që do të tërhiqet përgjatë jetëgjatësisë të zotimit të kredisë kur vlerësohen humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë. Për një kontratë garancie financiare, bankës i kërkohet të bëjë pagesa vetëm në rast të një mospagese nga debitori, në përputhje me kushtet e instrumentit që është garantuar. Në përputhje me rrethanat, mungesat e parave të gatshme janë pagesat e pritshme për ta rimbursuar mbajtësin për një humbje kreditore që ai pëson, minus shumat që banka pret të marrë nga mbajtësi, debitori apo ndonjë palë tjetër. Nëse aset i është plotësisht i garantuar, vlerësimi i mungesave të parave të gatshme për një kontratë garancie financiare do të ishte në përputhje me vlerësimet e mungesave të parave të gatshme për pasurinë që i nënshtrohet garancisë.

Humbjet e pritshme kreditore për një zotim të kredisë do të zbriten duke përdorur normën efektive të interesit, apo një përafrim të saj, që do të zbatohet kur njihet pasuria financiare që rezultojnë nga zotimi i kredisë. Humbjet e pritshme kreditore për kontratat e garancisë financiare ose për zotimet e kredisë për të cilat nuk mund të përcaktohet norma efektive e interesit do të zbriten duke aplikuar një normë skontimi e cila pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën e parasë në atë kohë dhe rreziqet që janë specifike për flukset monetare por vetëm nëse, dhe në masën që, rreziqet merren parasysh duke rregulluar normën e skontimit në vend që të rregullohen mungesat e parave që skontohej.

### ***Informacioni parashikues***

Një matje e humbjeve të pritshme kreditore është një shumë e paanshme e ponderuar në probabilitet, e cila përcaktohet duke vlerësuar një varg rezultatesh të mundshme dhe duke përdorur informacion të arsyeshëm dhe të mbështetur që është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit në lidhje me ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike. Kur ekziston një marrëdhënie jo-lineare ndërmjet skenarëve të ndryshëm parashikues dhe humbjeve të tyre të ndërlidhura kreditore, më shumë se një skenar parashikues do të duhet të përfshihet në matjen e humbjeve të pritshme kreditore për të përmbushur objektivin e mësipërm të miratuar.

Numri i skenarëve ekonomikë: modelohen skenarë përfaqësues që kapin jolinearitetet materiale (p.sh. një skenar bazë, një skenar pozitiv dhe një skenar negativ). Numra të ndryshëm skenarësh mund të jenë të përshtatshëm në varësi të fakteve dhe rrethanave - p.sh. në periudha të rritjes së luhatshmërisë së pritur. Përcaktimi i skenarëve ekonomikë alternativë: qoftë nëse banka prodhon vlerësimet e veta ekonomike të ardhshme ose përdor vlerësime të palëve të treta, ajo merr në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme, përveç rastit kur efekti marginal i përdorimit të të dhënave shtesë do të ishte i parëndësishëm. Në disa ekonomi, të dhënat gjithëpërfshirëse do të jenë në dispozicion, por në territore të tjera mund të ketë më pak informacione në dispozicion.

Skenarët përfaqësues: Skenarët pozitivë dhe negativë të përdorur nuk janë të njëanshëm ndaj skenarëve ekstremë, në atë mënyrë që gama dhe peshimi i skenarëve të përdorur të mos jetë përfaqësues. Në veçanti, siç theksohet në GCRAECL të Komitetit të Bazelit, "skenarët e stresit të zhvilluar për qëllime mbikëqyrëse në mbarë industrinë nuk synohen të përdoren drejtpërdrejt për qëllime kontabël".

Skenari bazë: Skenari bazë është në përputhje me inputet përkatëse për vlerësimet e tjera në pasqyrat financiare (p.sh. rikuperimi i tatimit të shtyrë dhe zhvlerësimi i emrit të mirë), buxhetet, planet strategjike dhe kapitale dhe informacionet e tjera të përdorura në menaxhimin dhe raportimin nga banka. Megjithatë, këto inpute nuk duhet të jenë të vonuara ose të njëanshme. Edhe nëse inputet e përdorura janë në kohë dhe të paanshme, nëse buxheti i bankës zhvillohet në shtator, por kushtet makroekonomike kanë ndryshuar deri në fund të dhjetorit, ose nëse buxheti përmban optimizëm ose pesimizëm të qenësishëm, atëherë bëhen rregullimet e duhura për këto inpute kur përdoren për të përcaktuar skenarin bazë për qëllimet e llogaritjes së ECL në fund të vitit.

Ndjeshmëritë dhe asimetritë: skenarët e përzgjedhur janë përfaqësues dhe marrin në konsideratë shtytësit kryesorë të ECL, veçanërisht ndjeshmëritë jolineare dhe asimetrike brenda portofoleve. Për shembull, nëse banka ka ekspozime të rëndësishme të

pronave dhe rrjedhimisht ndjeshmëri të konsiderueshme të ECL ndaj vlerave të ardhshme të pronës, atëherë modelohen ndryshime të ndryshme në çmimet e pronave. Ndjeshmëria e ECL ndaj secilit parametër individual të parashikuar ekonomik monitorohet për të identifikuar faktorët kryesorë dhe për të vlerësuar efektet e ndryshimeve në parametra të ECL. Koherenca e parametrave: në zhvillimin e detajeve të një skenari specifik ekonomik (p.sh. një skenar me vlerësime individuale pikësh të BPV-së së ardhshme, papunësisë, normave të interesit, etj.), çdo korrelacion i pritshëm ose ndërlidhje tjetër ndërmjet parametrave (p.sh. një rritje e papunësisë pritet të rezultojë në një ulje të normave të interesit) merret parasysh në zhvillimin e skenarit në mënyrë që ai të jetë realist. Granulariteti i rregullimeve: llogaritja e një rregullimi të modeluar të veçantë për të pasqyruar ndikimin e skenarëve më pak të mundshëm dhe ndikimet jolineare që rezultojnë, kryhet në një nivel të duhur të ulët të granularitetit, i cili merr në konsideratë karakteristikat dhe ndjeshmëritë cilësisht të ndryshme të rrezikut.

## Matja e humbjeve të pritshme kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë në Fazën 1/2

### Perspektiva parashikuese

Informacioni historik është një spirancë apo bazë e rëndësishme nga e cila mund të maten humbjet e pritshme kreditore. Megjithatë, banka do të rregullojë të dhënat historike, të tilla si përvoja e humbjeve kreditore, në bazë të të dhënave aktuale të vëzhgueshme për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale dhe parashikimet e saj për kushtet e ardhshme që nuk kanë ndikuar në periudhën në të cilën bazohen të dhënat historike, dhe për të hequr efektet e kushteve në periudhën historike që nuk janë të rëndësishme për flukset monetare të ardhshme kontraktuale. Në disa raste, informacioni më i mirë i arsyeshëm dhe i mbështetur mund të jetë informacioni historik i parregulluar, varësisht nga natyra e informacionit historik dhe koha kur është llogaritur, krahasuar me rrethanat në datën e raportimit dhe karakteristikat e instrumentit financiar që vlerësohet. Vlerësimet e ndryshimeve në humbjet e pritshme kreditore duhet të pasqyrojnë dhe të jenë në përputhje për nga drejtimit me ndryshimet në të dhënat përkatëse të vëzhgueshme nga periudha në periudhë (siç janë ndryshimet në normat e papunësisë, çmimet e pronave, çmimet e mallrave, statusi i pagesës ose faktorët e tjerë që janë tregues të humbjeve kreditore në instrumentin financiar ose në grupin e instrumenteve financiare dhe të përmasave të këtyre ndryshimeve). Banka do të rishikojë në baza të rregullta metodologjinë dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e humbjeve të pritshme kreditore për të reduktuar çfarëdo diferencë midis vlerësimeve dhe përvojës faktike të humbjeve kreditore.

Nga banka nuk kërkohet të përfshijë parashikime të kushteve të ardhshme përgjatë gjithë jetëgjatësisë së pritshme të një instrumenti financiar. Shkalla e gjykimit që kërkohet për të vlerësuar humbjet e pritshme kreditore varet nga disponueshmëria e informacionit të detajuar. Përderisa horizonti i parashikimit rritet, disponueshmëria e informacionit të detajuar zvogëlohet ndërsa shkalla e gjykimit që kërkohet për të vlerësuar humbjet e pritshme kreditore rritet. Vlerësimi i humbjeve të pritshme kreditore nuk kërkon një vlerësim të detajuar për periudhat që i përkasin të ardhmes së largët- për periudhat e tilla, banka mund të ekstrapolojë parashikimet nga informacioni i disponueshëm dhe i detajuar.

### PD (Probabiliteti i Mospagesës)

PD e përdorur për SNRF 9 duhet të pasqyrojë këndvështrimin aktual të menaxhmentit për të ardhmen dhe duhet të jetë i paanshëm (d.m.th. nuk duhet të përfshijë ndonjë konservatorizëm ose optimizëm). Ekzistojnë dy lloje të PD-ve që përdoren për llogaritjen e ECL-ve:

- PD-të 12-mujore – Ky është probabiliteti i vlerësuar që mospagesa të ndodhë brenda 12 muajve të ardhshëm (ose përgjatë jetëgjatësisë së mbetur të instrumentit financiar nëse ajo është më pak se 12 muaj). Kjo përdoret për të llogaritur ECL-të 12-mujore.
- PD-të përgjatë gjithë jetëgjatësisë – Ky është probabiliteti i vlerësuar që një mospagesë të ndodhë përgjatë jetëgjatësisë së mbetur të instrumentit financiar. Ky përdoret për të llogaritur ECL-të përgjatë gjithë jetëgjatësisë për ekspozimet e 'fazës 2', ndërsa PD përgjatë gjithë jetëgjatësisë për Fazën 3 është 100 %.

Rreziku që të ndodhë mos pagesa në instrumentet financiare që kanë rrezik kreditor të krahasueshëm, është më i lartë sa më e gjatë të jetë jetëgjatësia e pritshme e instrumentit, për shembull, rreziku që të ndodhë një mospagim në një obligacion të vlerësuar me AAA me jetëgjatësi të pritshme prej 10 vjetësh është më i lartë se ai në një obligacion të vlerësuar me AAA me një jetëgjatësi të pritshme prej pesë vjetësh. Efekti i një përmirësimi në rrezikun kreditor të një aseti të maturuar duhet të merret parasysh për krahasimin e rrezikut kreditor në fillim dhe rrezikut aktual të kredisë.

Për produktet me histori të pamjaftueshme të mospagesës, mungesë të të dhënave ose në rast të produkteve të reja, opsioni i fundit është përdorimi i një **standardi/pike referuese për PD 12-mujore**. Standardet janë llogaritur nga Rreziku Retail i Raiffeisen Bank International duke përdorur vlerat mesatare të PD të llogarive me vlerësimet ekzistuese të PD. Llogaritja bazohet në të dhënat aktuale në dispozicion, duke përfshirë llogaritë në mospagim dhe jo të vlerësuara dhe duke përdorur mesataret e thjeshta. Standardet grupohen sipas produktit dhe rajonit gjeografik dhe rumbullakohen me një hap prej 50 bps. Ato do të rivlerësohen çdo vit dhe do të përditësohen nëse është e nevojshme. Standardet e vlefshme 12-mujore të PD aktualisht janë:

Segmenti	Lloji i produktit	PD
PI	Hipotekë	2.50%
	Kredi Personale	5.00%
	Kartelat e Kreditit	4.00%
	Mbitërheqjet	3.00%
	Kredi për Makina	2.50%
	Produkte të tjera	5.00%
Mikro-NVM	Të gjitha produktet	6.50%

Për vlerësimin e PD-së përdoren fletënotimet e aplikimit, sjelljes dhe transaksioneve. Pikët në përgjithësi mund të përkufizohen si një teknikë statistikore për të parashikuar, në një moment të caktuar kohor e përmes informacionit të disponueshëm, probabilitetin

e një ngjarjeje të ardhshme (p.sh. mospagesë ose mos përmbushje të detyrimit). Modelet e fletënotimeve (SC) përfaqësojnë mjete statistikore të vlerësimit të rrezikut, të projektuara posaçërisht për ekspozimet retail. Humbjet e pritura të kreditit llogariten duke marrë parasysh vlerësimin (i cili përfaqëson probabilitetin e mospagesës), ekspozimin në rast mospagese dhe humbjen në rast mospagese.

Tabela e mëposhtme përfaqëson notat e vlerësimit retail të përdorura nga banka:

URG	Përshkrimi i URG-së	Gama e poenave të URG	Intervali teorik i PD (%)	PD teorik (% mesatarja gjeometrike e intervallit teorik PD)
0	I pavlerësuar		I pavlerësuar	
0.5A		860 < Rezultati	PD < 0.043%	0.03%
0.5B	Rrezik minimal	820 < Rezultati ≤ 860	0.043% ≤ PD < 0.087%	0.06%
0.5C		780 < Rezultati ≤ 820	0.087% ≤ PD < 0.17%	0.12%
1.0	Gjendje e shkëlqyer kreditor	740 < Rezultati ≤ 780	0.17% ≤ PD < 0.35%	0.24%
1.5	Gjendje shumë e mirë kreditore	700 < Rezultati ≤ 740	0.35% ≤ PD < 0.69%	0.49%
2.0	Gjendje e mirë kreditore	660 < Rezultati ≤ 700	0.69% ≤ PD < 1.37%	0.97%
2.5	Gjendje e shëndoshë kreditore	620 < Rezultati ≤ 660	1.37% ≤ PD < 2.7%	1.92%
3.0A		600 < Rezultati ≤ 620	2.7% ≤ PD < 3.78%	3.20%
3.0B	Gjendje e pranueshme kreditore	580 < Rezultati ≤ 600	3.78% ≤ PD < 5.26%	4.46%
3.5A		560 < Rezultati ≤ 580	5.26% ≤ PD < 7.28%	6.19%
3.5B	Gjendje marginale kreditore	540 < Rezultati ≤ 560	7.28% ≤ PD < 10.00%	8.53%
4.0	Gjendje e dobët kreditore	500 < Rezultati ≤ 540	10.00% ≤ PD < 18.18%	13.48%
4.5A		460 < Rezultati ≤ 500	18.18% ≤ PD < 30.77%	23.65%
4.5B	Gjendje shumë e dobët kreditore	Rezultati ≤ 460	30.77% ≤ PD < 100.00%	38.05%
5.0	Mospagesë (Default)	Mospërmbushje e detyrimit (PD e ekspozimit në mungesë pagese është 100%)		

Më poshtë janë dhënë informacionet e klasifikimit (vlerësimit) të brendshëm të kreditit jo-retail të bankës siç përdore për qëllime të brendshme si dhe të dhënat krahasuese përkatëse:

Nota e vlerësimit/ rejttingut të brendshëm	Përshkrimi i vlerësimit të brendshëm	Periudha 12 mujore Basel II PD		Nota e vlerësimit ndërkombëtar të rrezikut
		Lower PD bound	Upper PD bound	
1A		>0.0000%	≤0.022%	AAA, AA+, AA, AA-
1B	Shkëlqyeshëm	>0.022%	≤0.026%	
1C		>0.026%	≤0.0300%	
2A		>0.0300%	≤0.0408%	A+, A, A-
2B		>0.0408%	≤0.0553%	
2C	I fuqishëm	>0.0553%	≤0.0751%	
3A		>0.0751%	≤0.1019%	
3B		>0.1019%	≤0.1383%	
3C		>0.1383%	≤0.1878%	
4A		>0.1878%	≤0.2548%	BBB+, BBB, BBB-
4B		>0.2548%	≤0.3459%	
4C		>0.3459%	≤0.4694%	
5A	Mirë	>0.4694%	≤0.6371%	BB+
5B		>0.6371%	≤0.8646%	
5C		>0.8646%	≤1.1735%	
6A		>1.1735%	≤1.5927%	BB, BB-
6B		>1.5927%	≤2.1616%	
6C		>2.1616%	≤2.9338%	B+
7A	I kënaqshëm	>2.9338%	≤3.9817%	B
7B		>3.9817%	≤5.4040%	

7C		>5.4040%	≤7.3344%	B-
8A		>7.3344%	≤9.9543%	
8B		>9.9543%	≤13.5101%	
8C		>13.5101%	≤18.3360%	CCC+, CCC
9A	Nën standard	>18.3360%	≤24.8857%	
9B		>24.8857%	≤33.7751%	CCC-, CC, C
9C		>33.7751%	<100%	
10	Kredit i zhvlerësuar	100%	100%	D

### LGD (Humbja në rast Mospagese)

Një komponent kyç i metodës së shumës së humbjeve marginale është Humbja në rast Mospagese (LGD). Banka përdor një kombinim të PD dhe LGD për të llogaritur flukset monetare të pritshme nga projekcioni i flukseve monetare kontraktuale. Vlerësimet e LGD duhet të marrin në konsideratë informacionin parashikues. Qasja e modelimit për LGD (por jo domosdoshmërisht vlerësimet faktike të LGD-së) në përgjithësi nuk ndryshon në varësi të fazës në cilën është ekspozimi, d.m.th. ekziston një metodologji e zakonshme LGD që zbatohet vazhdimisht.

Metodologjia e modelimit për LGD është projektuar, aty ku është e përshtatshme, në një nivel komponenti, ku llogaritja e LGD ndahet në një seri shtytësish/drejtuesish. Për ekspozimet e siguruar, qasja merr në konsideratë të paktën komponentët e mëposhtëm:

- Parashikimet e vlerësimeve të ardhshme të kolateralit, duke përfshirë skontimet e pritshme të shitjeve;
- Kohën deri në realizimin e kolateralit (dhe rikuperimeve të tjera);
- Shpërndarjen e kolateralit nëpër ekspozime ku ka një numër ekspozimesh ndaj të njëjtës palë (kolateralizimi i tërthortë);
- Normat e kurimit (duke përfshirë marrjen parasysh të mënyrës se si njësi i ka parë ri-mospagesat brenda llogaritjes së jetëgjatësisë); dhe
- Shpenzimet e jashtme të realizimit të kolateralit. Për ekspozimet e pasiguruara, qasja merr në konsideratë të paktën komponentët e mëposhtëm:

Për ekspozimet e pasiguruara, qasja merr në konsideratë të paktën komponentët e mëposhtëm:

- Koha e rikuperimit;
- Normat e rikuperimit; dhe
- Normat e kurimit (duke përfshirë marrjen parasysh të mënyrës se si njësi i ka parë ri-mospagesat brenda llogaritjes së jetëgjatësisë).

Vlerësimi i komponentëve merr në konsideratë gamën e shtytësve përkatës, duke përfshirë: gjeografinë (vendndodhjen e palës tjetër dhe kolateralit) dhe vjetërsinë e ekspozimit të kredisë. Vlerësimi i LGD pasqyron ndryshimet e pritura në ekspozim (në përputhje me supozimet e përdorura në modelimin e EAD), në mënyrë që të mos jetë i njëanshëm (për shembull, një vlerësim konservativ mund të lindë nëse shumica e pritshme e ekspozimit bie me kalimin e kohës, por kjo nuk merret parasysh në vlerësimin e LGD). Njësia merr në konsideratë nëse vlerat e komponentëve varen nga faktorët makroekonomikë dhe pasqyron çdo varësi të tillë në modelimin e saj duke marrë parasysh informacionin e duhur parashikues. Në veçanti, për ekspozimet e siguruar kundrejt pasurive të paluajtshme, njësia merr parasysh ndërvarësinë ndërmjet çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe variablave makroekonomikë. Në mënyrë të ngjashme, njësia shqyrton nëse ka ndonjë korrelacion ose ndërvarësi midis komponentëve të LGD dhe më pas e pasqyron atë korrelacion në vlerësimin e LGD.

Historia e të dhënave që mbështet modelimin e LGD dhe komponentëve të saj mbulon një periudhë të përshtatshme për të mbështetur rëndësinë dhe besueshmërinë e modelimit (p.sh. përgjatë një cikli të plotë ekonomik). Vlerësimi i vlerave të komponentëve brenda LGD pasqyron të dhënat historike në dispozicion dhe merr në konsideratë nëse ka pasur ose pritet të ketë ndonjë ndryshim në kushtet ekonomike, ose ndryshime në politikat ose procedurat e brendshme, që do të ndikonte në llogaritjen e LGD-së, por që nuk janë pasqyruar ndryshe në modelim. Qasja e LGD pasqyron skontimin e mungesës së parasë së gatshme duke marrë parasysh kohën e tyre të pritshme duke përdorur EIR.

Nëse vlerat rregullatore të LGD-së përdoren si pikënisje, atëherë rregullohet efekti i normave të ndryshme të skontimit, të qenësishme në vlerën rregullatore të LGD-së. Për më tepër, nëse vlerat rregullatore LGD të përdorura si pikënisje përmbajnë vlera të kufirit të poshtëm që do të çonin në një rezultat të njëanshëm, këto vlera hiqen për qëllime të SNRF 9. LGD sipas SNRF 9 pasqyron vetëm përmirësimet kreditore që janë pjesë përbërëse e kushteve të ekspozimit dhe që nuk kontabilizohen veçmas. Nëse vlerat rregullatore të LGD-së përdoren si pikënisje dhe pasqyrojnë përmirësimet e kredisë që nuk duhet të përfshihen për qëllime të SNRF 9 (p.sh. shkëmbimet (SWAPs) e mospagesave kreditore), atëherë ndikimi hiqet. Për produktet me histori të pamjaftueshme të mospagesës, mungesë të të dhënave apo në rast të produkteve të reja, do të përdoren standardet LGD. Standardet llogariten nga Rreziku Retail i Raiffeisen Bank International duke përdorur vlerat mesatare të LGD-së të llogarive me vlerësimet ekzistuese të LGD-së. Llogaritja bazohet në të dhënat aktuale të disponueshme, duke përfshirë llogaritë në mospagim dhe jo të vlerësuar dhe duke përdorur mesataret e thjeshta. Standardet grupohen sipas produktit dhe rajonit gjeografik dhe rrumbullakohen me një hap prej 5pp. Ato do të rivlerësohen në baza vjetore dhe do të përditësohen nëse është e nevojshme. Standardet aktualisht të vlefshme të LGD në përdorim nga banka janë:

Segmenti	Lloji i produktit	LGD
PI	Hipotekë	25.00%
	Kredi Personale	50.00%
	Kartela e Kreditit	40.00%
	Mbitërheqje	50.00%
	Kredi për Makina	50.00%
	Produkte të tjera	50.00%
Mikro-NVM	Të gjitha produktet	50.00%

### EAD (Ekspozimi në Mospagesë)

Edhe pse SNRF 9 nuk kërkon në mënyrë eksplicite nga njësitë që të modelojnë EAD, të kuptuarit se si pritet të ndryshojnë ekspozimet kreditore me kalimin e kohës është me rëndësi thelbësore për një matje të paanshme të ECL-ve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për kreditë e 'fazës 2', ku pika e mospagesës mund të jetë pas disa vitesh në të ardhmen. Injorimi i një rënieje të pritshme të ekspozimit (p.sh. për një kredi të ripagueshme me këste) mund të çojë në atë që matjet e ECL-ve të jenë shumë të larta. Injorimi i një rritjeje të pritshme të ekspozimit (p.sh. tërheqjet brenda një limiti të rënë dakord për një produkt revolving) mund të çojë në atë që matjet e ECL-ve të jenë shumë të ulëta.

Periudha maksimale gjatë së cilës do të maten humbjet e pritshme kreditore është periudha maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjatjes) gjatë së cilës njësitë është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor. Për zotimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare, kjo është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës njësi ka një detyrim kontraktual aktual për të dhënë kredi. Megjithatë, disa instrumente financiare përfshijnë edhe komponentë të kredisë edhe komponentë të zotimit të patërhequr dhe aftësia kontraktuale e njësisë për të kërkuar shlyerjen dhe anulimin e zotimit të patërhequr nuk e kufizon ekspozimin e njësisë ndaj humbjeve të kredisë në periudhën e njoftimit kontraktual. Për shembull, produktet kreditore revolving, të tilla si kartelat e kreditit dhe mbitërheqjet, mund të tërhiqen kontraktualisht nga huadhënësi me anë të një njoftimi prej vetëm një dite.

Megjithatë, në praktikë huadhënësit vazhdojnë të japin kredi për një periudhë më të gjatë dhe mund ta tërheqin produktin vetëm pasi të rritet rreziku kreditor i huamarrësit, gjë që mund të jetë tepër vonë për të parandaluar disa ose të gjitha humbjet e pritshme kreditore. Këto instrumente financiare në përgjithësi kanë karakteristikat e mëposhtme si rezultat i natyrës së instrumentit financiar, mënyrës në të cilën instrumentet financiare menaxhohen dhe natyrës së informacionit në dispozicion në lidhje me rritjet e konsiderueshme të rrezikut kreditor:

- Instrumentet financiare nuk kanë një afat të caktuar ose strukturë shlyerjeje dhe zakonisht kanë një periudhë të shkurtër anulimi kontraktual (për shembull, një ditë).
- Aftësia kontraktuale për të anuluar kontratën nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm të instrumentit financiar dhe kontrata mund të anulohet vetëm kur njësitë vie në dijeni për një rritje të rrezikut kreditor në nivelin e produktit kreditor.
- Instrumentet financiare menaxhohen mbi baza kolektive.

Gjatë përcaktimit të periudhës gjatë së cilës njësitë pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor, por për të cilën humbjet e pritura kreditore nuk do të zbuteshin nga veprimet normale të menaxhimit të rrezikut kreditor të njësisë, një njësi duhet të marrë parasysh faktorë të tillë si informacioni historik dhe përvoja rreth:

- Periudhës gjatë së cilës njësitë ishte e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor në instrumente të ngjashme financiare;
- Periudha kohore që mospagesat e lidhura të shfaqen në instrumente të ngjashme financiare pas një rritjeje të ndjeshme të rrezikut kreditor; dhe
- Veprimet e menaxhimit të rrezikut të kreditit që një njësi pret të ndër marrë pasi që rreziku kreditor në instrumentin financiar të jetë rritur, të tilla si reduktimi apo heqja e limiteve të patërhequra

Një njësi nuk ka nevojë të ndërmarrë një kërkim shterues për informacione, por duhet të marrë në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme dhe që është i rëndësishëm për vlerësimin e humbjeve të pritshme kreditore, duke përfshirë efektin e parapagimeve të pritshme. Informacioni i përdorur duhet të përfshijë faktorë që janë specifikë për huamarrësin, kushtet e përgjithshme ekonomike dhe një vlerësim si të drejtimit aktual ashtu edhe atij të parashikuar të kushteve në datën e raportimit. Një njësi mund të përdorë burime të ndryshme të të dhënave që mund të jenë të brendshme (specifike për atë njësi) dhe të jashtme. Burimet e mundshme të të dhënave përfshijnë përvojën e brendshme të humbjeve kreditore historike, vlerësimet e brendshme, përvojën e humbjeve kreditore të subjekteve të tjera dhe vlerësimet e jashtme, raportet dhe statistikën.

Subjektet ekonomike që nuk kanë fare ose nuk kanë burime të mjaftueshme të të dhënave specifike për njësinë mund të përdorin përvojën e grupeve simotra për instrumentin financiar të krahasueshëm (ose grupe instrumentesh financiare). Qasja e modelimit për EAD pasqyron ndryshimet e pritshme në bilancin e papaguar përgjatë gjithë jetëgjatësisë së ekspozimit kreditor, të cilat lejohen nga kushtet aktuale kontraktuale, duke përfshirë:

- Planin e kërkuar të ri-pagimit/shlyerjes;
- Shlyerjen e plotë e parakohshme (p.sh. ri-financimi i parakohshëm);
- Mbipagesat mujore (domethënë pagesat në shuma më të larta se pagesat e kërkuara të ri-pagimit, por jo për shumën e plotë të kredisë);

- Ndryshime në përdorimin e një zotimit të patërhequr brenda limiteve të kredisë të rëna dakord përpara mospagesës;
- Veprimet për zbutjen e kreditit të ndërmarra para mospagesës.

Njësia përdor një model të flukseve monetare për të llogaritur ekspozimin e vlerësuar në fund të çdo muaji të ardhshëm. Ky model është në përputhje me çdo model të ngjashëm të përdorur për qëllime të EIR ose mbrojtëse makro të vlerës së drejtë. Ky model i fluksit monetar pasqyron më tej lëvizjet në EAD në muajt përpara mospagesës.

Inputet në modelin EAD rishikohen për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre për SNRF 9 dhe rregullohen, aty ku kërkohet, për të siguruar një llogaritje të paanshme, të ponderuar të probabilitetit të ECL, e cila reflekton pritshmëritë aktuale dhe informacionin parashikues. Modelet EAD janë të diferencuara për të pasqyruar karakteristikat e ndryshme të rrezikut të portofoleve të ndryshme. Njësia i merr parasysht këta shtytës të ndryshëm themelorë në përcaktimin e inputeve të ndryshme në modelet e EAD.

### **Norma e skontimit**

ECL-të maten në një mënyrë e cila pasqyron vlerën në kohë të parasë. Kjo do të thotë që mungesat e parasë së gatshme që lidhen me mospagesë kërkohet të skontohen në datën e bilancit. Për një pasuri financiare, një njësi përdor normën efektive të interesit (EIR) (d.m.th. e njëjta normë e përdorur për të njohur të ardhurat nga interesi) ose një përafrim. Efekti i skontimit mund të jetë i rëndësishëm sepse ngjarjet e mospagesës dhe/ose mungesat e ndërlidhura të parasë mund të ndodhin në një kohë të largët në të ardhmen. Vlera në kohë e parasë duhet të merret parasysht gjatë llogaritjes së humbjeve të pritshme kreditore. Flukset e parasë do të skontohen deri në datën e raportimit. Përveç përjashtimeve të përmendura më poshtë, flukset monetare që priten të merren skontohen duke përdorur normën efektive të interesit (EIR) të përcaktuar me njohjen fillestare të një instrumenti në bilanc ose një përafrim të saj.

### **Matja e humbjeve të pritshme kreditore përgjatë gjithë jetëgjatësisë në Fazën 3**

Për një pasuri financiare që është i kreditit të zhvlerësuar në datën e raportimit, por që nuk është një pasuri financiare i blerë ose i origjinës i kreditit të zhvlerësuar, banka do të masë humbjet e pritshme kreditore si diferencë midis vlerës kontabël bruto të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën fillestare efektive të interesit të asetit financiar. Çdo rregullim njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga zhvlerësimi. Për asetet e kolateralizuara, vlerësimi përfshin gjithashtu edhe flukset monetare nga përvetësimi/realizimi i kolateralit minus kostot e marrjes dhe shitjes së kolateralit, pavarësisht nëse është i mundshëm realizimi. Të gjitha kërkesat e matjes vlejné edhe për letrat me vlerë të borxhit. Gjatë përcaktimit të mospagesës për qëllime të përcaktimit të rrezikut të mospagesës, banka duhet të zbatojë një përkufizim të mospagesës që është në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime të menaxhimit të rrezikut të brendshëm të kredisë për instrumentin financiar përkatës dhe të marrë parasysht treguesit cilësorë (për shembull, marrëveshjet financiare) kur është e përshtatshme. Megjithatë, ekziston një supozim i kundërshtueshëm që mospagesa nuk ndodh më vonë se kur një pasuri financiare është 90 ditë me vonesë, përveç rastit kur një njësi ka informacion të arsyeshëm dhe të mbështetur për të demonstruar se një kriter më i mospagesës më të vonuar është më i përshtatshëm. Përkufizimi i mospagesës të përdorur për këto qëllime do të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha instrumentet financiare, përveç rastit kur bëhet i disponueshëm informacioni që tregon se një përkufizim tjetër i mospagesës është më i përshtatshëm për një instrument financiar të caktuar. Vlera kontabël bruto mund të përfshijë principalin e papaguar (duke përfshirë çfarëdo shumë të vonuar), interesin e përlllogaritur, tarifën dhe kostot e pa amortizuara, fitimet ose humbjet e modifikuara të paamortizuara, ndryshimet e paamortizuara në pritshmëritë e fluksit monetar, rregullimet e mbrojtjes të vlerës së drejtë të paamortizuara si dhe diferencat fillestare të paamortizuara ndërmjet vlerës së drejtë dhe çmimit të transakcionit (të shtyra sipas SNRF 9.B5.1.2A (b)).

Gjatë përcaktimit të ECL-së përgjatë gjithë jetëgjatësisë për ekspozimet e fazës 3, zbatohen të njëjtat kërkesa sikur për ekspozimet e fazës 2. Kjo do të thotë se ECL përgjatë jetëgjatësisë së mbetur të një instrumenti financiar do të matet në një mënyrë e cila pasqyron një shumë të paanshme dhe të ponderuar me probabilitet që përcaktohet duke vlerësuar një varg rezultatesh të mundshme, vlerën në kohë të parasë dhe informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur në lidhje me ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura të ngjarjeve të ardhshme (që janë të disponueshme në datën e raportimit pa kosto ose përpjekje të panevojshme). Supozimet dhe inputet duhet të harmonizohen në të gjitha fazat e modelit të rënies në vlerë (zhvlerësimit), kjo është veçanërisht e rëndësishme për informacionin parashikues siç janë ndryshoret makro.

### **Ponderimi i Probabilitetit**

Humbjet e pritshme kreditore duhet të pasqyrojnë një shumë me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke peshuar një varg rezultatesh të mundshme. Të gjithë skenarët përkatës (në vend të vetëm skenarit më të mundshëm) do të merren parasysht. Skenarët që kanë shumë pak gjasa të ndodhin nuk do të merren parasysht kur vlerësohet ECL. Edhe nëse vetëm një strategji ristrukturimi/riprogramimi është realiste, zakonisht do të jetë e përshtatshme dhe e nevojshme të merren parasysht të paktën dy vlerësime të ndryshme të flukseve monetare. Për aktivet me rrezik, siç është borxhi i papaguar, flukset faktike monetare mund të jenë shumë të ndryshme nga pritshmëritë. Metoda e preferuar për llogaritjen e flukseve monetare të pritshme në raste të tilla është përdorimi i skenarëve më të mirë dhe skenarëve më të këqij të realizueshëm. Skenari i realizueshëm më i mirë nuk do të jetë skenari i cili maksimizon të gjitha inputet, por përkundrazi, ai i cili merr parasysht marrëdhënien midis inputeve në një mënyrë reale. Skenari më i keq duhet gjithashtu të marrë parasysht marrëdhënien midis inputeve në një mënyrë reale. Duhet gjithashtu të theksohet se sa më me rrezik të jenë flukset monetare, aq më e madhe duhet të jetë gama e flukseve monetare. Strategjitë e ristrukturimit duhet të pasqyrohen në vlerësimin e flukseve monetare. Skenarët e tillë të ristrukturimit mund të jenë për shembull:

- Kurimi (rikuperim i plotë, shlyerje e plotë dhe kalimi në nivelin ku mospagesat eliminohen);
- Ristrukturimi (ripagimi i flukseve monetare të rinegociuara);
- Likuidimi i kolateralit (skenari i mosvijueshmërisë);

- Transferimi i aktivitetit nëpërmjet shitjes;
- Një kombinim i sa më sipër.

Shuma dhe koha e flukseve monetare për skenarë të veçantë duhet të përcaktohet dhe një probabilitet duhet ta shoqërojë çdo vlerësim të flukseve monetare. Shuma e flukseve monetare me probabilitet të ponderuar për secilin skenar përkatës do të skontohej më pas deri në datën e raportimit. Zgjedhja e skenarit, peshimi dhe raporti i flukseve monetare të skenarit më të keq/rastit më të mirë duhet të bazohet në përvojën historik.

### **Informacioni Parashikues**

Nevvoja për të inkuorporuar informacionin parashikues do të thotë se aplikimi i standardit do të kërkojë gjykim të konsiderueshëm, në veçanti, se si do të ndikojnë në provizione ndryshimet e faktorëve makroekonomikë.

### **Kolaterali**

Flukset e vlerësuarat monetare që merren parasysht do të përfshijnë flukset monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur apo përmirësimet e tjera të kredisë që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale, d.m.th. që janë pjesë e kushteve kontraktuale (qoftë edhe nëse jo në mënyrë eksplicite) dhe nuk njihen veçmas (për të shmangur numërimin e dyfishtë).

### **Zërat jashtë bilancit**

Për një kontratë garancie financiare, humbja e pritshme përcaktohet bazuar në pagesat e pritshme për të rimbursuar mbajtësin për një humbje kredie, minus çdo shumë që banka pret të marrë nga mbajtësi, debitori ose ndonjë palë tjetër. Megjithatë, të ardhurat e ardhshme të primit që duhen paguar nga mbajtësi nuk duhet të merren parasysht në matjen e humbjes së pritshme nga aktivi që i nënshtrohet garancisë. Kjo është për shkak se flukset monetare sipas garancisë varen nga rreziku i dështimit të (mospagesës) të pasurisë financiare të garantuar, ndërsa primit që do të merren i nënshtrohen rrezikut të mospagesës nga mbajtësi i garancisë. Për zotimet e kredisë, banka do të marrë parasysht gjithashtu tërheqjen e pritshme individuale. Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë më e lartë se 1, pasi që ECL nuk duhet të njihet për asnjë ekspozim ku nuk ka detyrim kontraktual.

### **Norma e skontimit**

Vlera në kohë e parasë duhet të merret parasysht gjatë llogaritjes së humbjeve të pritshme kreditore. Flukset monetare skontohej deri në datën e raportimit. Përveç përjashtimeve të përmendura, flukset monetare që priten të merren skontohej duke përdorur normën efektive të interesit (EIR) të përcaktuar në njohjen fillestare të instrumentit në bilanc ose një përafrim të saj. Nëse një instrument financiar ka një normë interesi të ndryshueshme, ECL duhet të skontohej duke përdorur EIR-në aktuale (d.m.th. EIR fillestare të rregulluar për rivendosjen e vlerës së zërit të ndryshueshëm në datën e tij më të fundit të rivendosjes së çmimit). Nëse instrumenti është ose është përcaktuar si zë i mbrojtur në një marrëdhënie mbrojtëse me vlerën e drejtë, çdo rishikim sipas SNRF 9.6.5.10 do të merret parasysht gjithashtu. Për të arkëtueshmet e qirasë, norma e skontimit e përdorur në matjen e këtyre të arkëtueshmeve të qirasë është në përputhje me SNRF 16. Nëse një instrument financiar ishte i zhvlerësuar krediti në njohjen fillestare (POCI), ECL-të duhet të skontohej duke përdorur një normë të rregulluar efektive të interesit. Për zotimet e kredive, EIR e ardhshme e përcaktuar për t'u aplikuar për aktivin që do të njihet fillimisht në datën e pritshme të përdorimit të parë të ardhshëm të zotimeve, pasi aktivi financiar që njihet pas një tërheqjeje në një zotim kredie trajtohet si vazhdim i atij zotimi dhe jo si një instrument i ri financiar. Për garancitë financiare, norma e skontimit duhet të pasqyrojë vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet që janë specifike për flukset monetare, por vetëm nëse, dhe në masën që, rreziqet merren parasysht duke rregulluar normën e skontimit në vend të rregullimit të mungesës së parasë së gatshme që po skontohej.

#### **3.3.13. Kategoria e kostos së amortizuar**

Një pasuri financiare do të matet me koston e amortizuar nëse është brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur/arkëtuar flukset monetare kontraktuale dhe flukset monetare kontraktuale të aktivitetit financiar janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit në shumën e papaguar të principalit.

Në njohjen fillestare, aktivet financiare dhe detyrimet financiare maten me vlerën e drejtë plus kostot e pranueshme të transaksionit.

Nëse ka një diferencë ndërmjet vlerësimit të vlerës së drejtë të njësisë ekonomike në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit, atëherë:

- nëse vlerësimi i vlerës së drejtë përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme, atëherë diferenca njihet në fitim ose humbje; ose,
- në të gjitha rastet e tjera, diferenca shtyhet si një rregullim i vlerës kontabël të instrumentit financiar, i cili amortizohet nëpërmjet PL përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit financiar.

Portofoli i kredive dhe paradhënive të bankës mbartet me koston të amortizuar dhe të ardhurat nga interesi njihen në fitim dhe humbje duke përdorur normën efektive të interesit.

#### **3.3.14. Kategoria FVOCI (Vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse)**

Aktivi financiar klasifikohet si i matur me FVOCI nëse mbahet brenda një modeli biznesor, objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare dhe plotëson kriterin e pagesave vetëm të principalit dhe interesit (SPPI).

### 3.3.15. Kategoria FVTPL (Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes)

Të gjitha aktivet e tjera financiare – d.m.th. aktivet financiare që nuk plotësojnë kriteret për klasifikim si të matura më pas me koston e amortizuar ose FVOCI – klasifikohen si të matura më pas me vlerën e drejtë, ku ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim ose humbje.

Përveç kësaj, Banka ka opsionin që në njohjen fillestare të caktojë në mënyrë të pakthyeshme një pasuri financiare si me FVTPL, nëse kjo eliminon apo redukton ndjeshëm një mospërputhje të matjes ose njohjes – pra, një 'mospërputhje kontabël' – e cila përndryshe do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve. ose njohja e fitimeve dhe humbjeve mbi to, mbi baza të ndryshme.

Në njohjen fillestare, aktivet financiare të klasifikuara si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes do të maten me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare, aktivet financiare të klasifikuara si me vlerë të drejtë do të maten me vlerën e drejtë dhe kostot e transakcionit njihen në fitim ose humbje.

### 3.3.16. Instrumente financiare derivative

Derivatitë njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën në të cilën është lidhur një kontratë derivative dhe më pas maten me vlerën e tyre të drejtë. Vlerat e drejta përfitohen nga çmimet e kuotuar të tregut në tregjet aktive, duke përfshirë transakcionet e fundit të tregut dhe teknikat e vlerësimit, duke përfshirë modelet e flukseve monetare të skontuara sipas rastit. Të gjithë derivativët mbarten si aktive kur vlera e drejtë është pozitive dhe si detyrime kur vlera e drejtë është negative. Fitimet dhe humbjet që vijnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve përfshihen në 'Të ardhurat neto nga instrumentet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes' në fitim ose humbjen për periudhën përkatëse. Banka përdor instrumente financiare derivative të tilla si këmbimet e normave të interesit jashtë bursës (OTC) për të menaxhuar rrezikun e saj që rrjedh nga luhatjet e normave të interesit të tregut. Për instrumentet derivative nuk aplikohet kontabiliteti mbrojtës.

### 3.3.17. Cash and cash equivalents and mandatory reserves

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë kartëmonedhat dhe monedhat në dorë (duke përfshirë rezervat e kufizuara - shih më poshtë), bilancet e pakufizuara të mbajtura me bankat qendrore dhe pasuritë financiare shumë likuide me maturime fillestare prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimit në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e zotimeve të saj afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

## 3.4. Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet e rëndësishme kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare të Bankës kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumën e raportuar e të ardhurave, shpenzimeve, pasurive dhe detyrimeve, dhe shpalesjet shoqëruese, si dhe shpalesjet e detyrimeve kontingjente. Pasiguria në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të rezultojë në rezultate që kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të aktiveve ose detyrimeve të prekura në periudhat e ardhshme. Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Bankës, menaxhmenti ka bërë gjykimet dhe supozimet e mëposhtme në lidhje me të ardhmen dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Rrethanat ekzistuese dhe supozimet për zhvillimet e ardhshme mund të ndryshojnë për shkak të rrethanave që janë jashtë kontrollit të Bankës dhe pasqyrohen në supozime nëse dhe kur ato ndodhin. Zërat me efektin më të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare të veçanta me gjykim dhe/ose vlerësime të konsiderueshme të menaxhmentit janë renditur më poshtë në lidhje me gjykimet/vlerësimet e përfshira.

Gjykime të rëndësishme kontabël dhe kontabiliteti përshkruhen në shënimet e mëposhtme:

- 3.3.12 Zhvlerësimi i aktiveve financiare
- 3.3.16 Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare;
- 3.3.17 Kostoja e amortizuar dhe kategoria;
- 3.3.18 Kategoria FVOCI;
- 3.3.19 Kategoria FVTPL;
- 3.8 Prona e riposeduar.

## 3.5. Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përmbushë kërkesat e likuiditetit mesatar minimal ditore. Kërkesa për likuiditet llogaritet në baza javore si 10 për qind e bazës së depozitave, e përcaktuar si mesatarja e detyrimeve totale të depozitave ndaj publikut jo-bankar në euro dhe valuta të tjera, gjatë ditëve të punës të periudhës së mbajtjes. Pasuritë me të cilat Banka mund të përmbushë kërkesat e saj për likuiditet janë depozitat në euro në BQK dhe 50 për qind e ekuivalentit në euro të parave të gatshme të shprehura në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat në BQK nuk duhet të jenë më pak se 5 për qind e bazës së aplikueshme të depozitave. Meqenëse aktivet likuide përkatëse nuk janë të disponueshme për të financuar operacionet e përditshme të Bankës, ato janë përjashtuar nga paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë.

## 3.6. Prona dhe pajisje

### 3.6.1. Prona dhe pajisjet në pronësi

Pronat dhe pajisjet paraqiten me koston historike minus amortizimi i akumuluar dhe zhvlerësimi i akumuluar, nëse ka ndonjë. Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurive ose njihen si aktiv i veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen shpenzimeve të tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Vlerat kontabël të pronës dhe pajisjeve rishikohet për rënie në vlerë kur ngjarjet ndryshojnë apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ka indikacione të tilla dhe kur vlerat kontabël tejkalojnë shumën e parashikuar të rikuperueshme, aktivet ose njësitë gjeneruese të parasë (CGU) shlyhen deri në vlerën e tyre të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e pronës dhe pajisjeve është vlera e drejtë minus kostot e shitjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të vlerësuara skontoohen në vlerën e tyre aktuale me përdorimin një normë skontimi para tatimit e cila pasqyron vlerësimet aktuale të tregut të vlerës kohore të parasë dhe rreziqeve specifike për ato pasuri.

Për një aktiv i cili nuk gjeneron flukse monetare kryesisht të pavarura, shumta e rikuperueshme përcaktohet për njësitë gjeneruese të parasë (CGU) të cilave u përket aktiv. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Amortizimi i aktiveve ngarkohet në mënyrë lineare me norma të përcaktuara për të alokuar koston e pronës dhe pajisjeve përgjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme të vlerësuar.

Normat vjetore të amortizimit përcaktohen nga jetëgjatësia e dobishme e vlerësuar e aktiveve të caktuara sipas tabelës në vijim:

Përmirësimet brenda pronave me qira amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër ndërmjet jetës së dobishme dhe afatit të qirasë. Puna në proces nuk amortizohen derisa aktiv i të vihet në përdorim.

Bankomatet, pajisjet e tjera bankare të zyrës	5-10 years
Hardueri kompjuterik	4-7 years
Ndërtesa të përdorura për qëllime vetanake	50 years

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në çdo datë raportimi.

### 3.6.2. Prona dhe pajisjet me qira

Banka njih pasurinë me të drejtë përdorimi dhe një detyrim qiraje në datën e fillimit të qirasë. Pasuria me të drejtë përdorimi fillimisht matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose përpara datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte e shkaktuar dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe heqjen e aktivit bazë ose për të rivendosur aktivin bazë ose vendndodhjen në të cilën është vendosur, minus çdo stimul i pranuar i qirasë.

Aktiv me të drejtën e përdorimit amortizohet më pastaj duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fundin e jetëgjatësisë së dobishme të aktivit me të drejtë përdorimi apo deri në fund të afatit të qirasë, cilado që ndodhë më herët.

Jetëgjatësia e vlerësuar e dobishme e aktiveve me të drejtën e përdorimit përcaktohet në bazë të kushteve të qirasë. Pasuritë me të drejtën e përdorimit amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme të aktivit me të drejtën e përdorimit, cilado që është më e shkurtër. Nëse një qira transferon pronësinë e aktivit bazë ose kostoja e aktivit me të drejtën e përdorimit pasqyron se njësi ekonomike pret të ushtrojë një opsion blerjeje, aktiv i lidhur me të drejtën e përdorimit amortizohet përgjatë jetëgjatësisë së dobishme të aktivit bazë. Përveç kësaj, aktiv me të drejtën e përdorimit reduktohet në mënyrë periodike nga humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka ndonjë, dhe rregullohet për ri-matjet e caktuara të detyrimit të qirasë.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë sa vijon:

- pagesat fikse, duke përfshirë pagesat fikse në substancë;
- pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, të matura fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit;
- shumat që pritet të jenë të pagueshme sipas një garancie të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i ushtrimit sipas një opsioni blerjeje që Banka është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do ta ushtrojë, pagesat e qirasë në një periudhë rinovimi opsionale nëse Banka është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të ushtrojë një opsion zgjatjeje, dhe penaltitë për ndërprerjen e parakohshme të një qiraje, përveç rasteve kur Banka është e sigurt në mënyrë të arsyeshme që nuk do ta ndërpresë atë para afatit.

Detyrimi i qirasë matet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk paguhen në datën e fillimit, të skontuar duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira apo, në qoftë se kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, normën inkrementale (rritëse) të huamarrjes të Bankës. Në përgjithësi, Banka përdor normën e saj inkrementale të huamarrjes si normë skontimi. Ai ri-matet kur ka ndonjë ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë të cilat rrjedhin nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Bankës për shumën që pritet të jetë e pagueshme sipas një garancie të vlerës së mbetur, ose nëse Banka ndryshon vlerësimin e saj se a do të ushtrojë një opsion blerjeje, vazhdimi apo ndërprerjeje.

Kur detyrimi i qirasë ri-matet në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël të aktivit me të drejtë përdorimi, apo regjistrohet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e aktivit me të drejtë përdorimi është reduktuar në zero.

Banka paraqet aktivet me të drejtë përdorimi që nuk plotësojnë përkufizimin e pronës investive në "prona, impiante dhe pajisje" dhe detyrimet e qirasë në "detyrime të tjera" në pasqyrën e pozicionit financiar (shënimi 18).

Në fillim të një kontrate, Banka vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohore në këmbim të një shume. Për të vlerësuar nëse një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar, Banka vlerëson nëse:

- kontrata përfshin përdorimin e një aktivi të identifikuar – kjo mund të specifikohet shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar dhe duhet të jetë fizikisht e dallueshme ose të përfaqësojë në thelb të gjithë kapacitetin e një aktivi fizikisht të dallueshëm. Nëse furnizuesi ka një të drejtë thelbësore të zëvendësimit, atëherë aktivi nuk identifikohet;
- Banka ka të drejtën të marrë në mënyrë thelbësore të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivitetit (asetit) përgjatë gjithë periudhës së përdorimit; dhe
- Banka ka të drejtë të drejtojë përdorimin e aktivitetit. Banka e ka këtë të drejtë kur ka të drejtat e vendimmarrjes që janë më të rëndësishme për ndryshimin e mënyrës se si dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi. Në raste të rralla kur vendimi se si dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi është i paracaktuar, Banka ka të drejtën të drejtojë përdorimin e aktivitetit nëse:
- Banka ka të drejtë të operojë me aktivitetin (asetin); ose
- Banka e ka projektuar aktivitetin në një mënyrë e cila paracaktonte se si dhe për çfarë qëllimi do të përdoret ai.

Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura ose të ndryshuara më ose pas datës 1 janar 2019.

Në fillimin ose në rivlerësimin e një kontrate që përmban një komponent qiraje, Banka shpërndan shumën në kontratë për secilin komponent të qirasë në bazë të çmimeve të tyre relative të pavarura. Megjithatë, për qiratë e tokës dhe ndërtesave në të cilat është qiramarrëse, Banka ka zgjedhur të mos ndajë komponentët jo-qira dhe të llogarisë komponentët e qirasë dhe ato jo-qira si një komponent i vetëm i qirasë.

Banka zgjedhi të përdorte përjashtimet e njohjes në qiratë afatshkurtra, si dhe qiratë me vlerë të ulët.

- Një qira afatshkurtër përkufizohet si një qira që ka një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak.
- Një prag prej 5,000 €, qiratë me vlerë të ulët nën prag.

Çdo kriter zbatohet individualisht, që do të thotë se nuk ka kufizime në kualifikimin e qirasë afatshkurtër bazuar në vlerën e qirasë dhe anasjelltas. Zgjedhjet do të bëhen sipas klasës. Banka vendosi të përdorë këtë përjashtim për të gjitha klasat e aktiveve. Çdo modifikim pasues i qirasë afatshkurtër do të konsiderohet si qira e re dhe kriteret do të rivlerësohen.

### 3.6.3. Prona e rimarrë në posedim

Pasuritë (Asetet) e rimarra në posedim merren nëpërmjet ekzekutimit të garancisë mbi kreditë joperformuese dhe paradhëniet për klientët që nuk fitojnë të ardhura nga qiraja dhe nuk përdoren nga Banka, si dhe janë të destinuara për shitje (nxjerrje jashtë përdorimit) në një periudhë të arsyeshme kohore.

Pasuritë e rimarra në posedim njihen fillimisht duke përdorur vlerën e caktuar nga përmbartuesi në ankandin e fundit dhe më pastaj maten me vlerën e koston ose vlerën neto të realizueshme, cilado që është më e ulët, dhe çdo rënie në vlerë njihet në fitim ose humbje. Pasuritë e rimarra në posedim njihen si inventarë dhe paraqiten në inventarin e mallrave dhe llogarinë pezull për shërbimet e kryera ende të pa paraqitura si shpenzim në pasqyrën e pozicionit financiar dhe si shpenzime nga aktivitetet jo-bankare në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Në rastin e shitjes, të ardhurat njihen dhe vlera kontabël e pasurive njihet si shpenzim.

Vlera neto e realizueshme vlerësohet një herë në vit dhe çdo zhvlerësim/rikthim njihet si shpenzim/të ardhura në periudhën që ka ndodhur.

## 3.7. Pasuritë jomateriale

Pasuritë jomateriale njihen nëse ka të ngjarë që përfitimet ekonomike të ardhshme që i atribuohen aktivitetit do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri. Pasuritë jomateriale maten fillimisht me koston. Vlerat kontabël të aktiveve jomateriale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Pasuritë jomateriale përbëhen në tërësi nga softueri kompjuterik i cili amortizohet duke përdorur metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme të vlerësuar prej pesë vjetësh dhe licencat të cilat amortizohen gjatë afatit të licencës.

## 3.8. Depozitat, huamarrjet dhe detyrimet e varura

Depozitat, huamarrjet dhe detyrimet e varura janë pjesë e burimeve të financimit të borxhit të Bankës.

Depozitat, huamarrjet dhe detyrimet e varura njihen fillimisht me vlerën e drejtë, minus kostot e transaksionit të shkaktuara. Më pas paraqiten me koston të amortizuar; çdo diferencë ndërmjet të ardhurave neto të kostove të transaksionit dhe vlerës së kthimit njihet në fitim ose humbje përgjatë periudhës duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### 3.9. Kontabiliteti mbrojtës

Banka përcakton instrumentet derivativë të caktuar si instrumente mbrojtëse në lidhje me rrezikun e valutës së huaj dhe rrezikun e normës së interesit në mbrojtjen e vlerës së drejtë, mbrojtjen e fluksit monetar ose mbrojtjen e investimeve neto në operacionet e huaja. Mbrojtjet e rrezikut të këmbimit valutator mbi zotimet e sigurta kontabilizohen si mbrojtje të fluksit monetar.

Në fillim të marrëdhënies mbrojtëse, banka dokumenton marrëdhënien ndërmjet instrumentit mbrojtës dhe zërit të mbrojtur, së bashku me objektivat e saj të menaxhimit të rrezikut dhe strategjinë e saj për ndërmarrjen e transaksioneve të ndryshme mbrojtëse. Për më tej, në fillimin e mbrojtjes dhe në mënyrë të vazhdueshme, banka dokumenton nëse instrumenti mbrojtës është efektiv në kompensimin e ndryshimeve në vlerat e drejta ose fluksit monetar të zërit të mbrojtur që i atribuohen rrezikut të mbrojtur, që ndodh kur marrëdhëniet mbrojtëse përbushin të gjitha kërkesat e mëposhtme të efektivitetit të mbrojtjes:

- ekziston një marrëdhënie ekonomike ndërmjet zërit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës
- efekti i rrezikut kreditor nuk dominon ndryshimet e vlerës që rrjedhin nga ajo marrëdhënie ekonomike
- raporti i mbrojtjes i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me atë që rrjedh nga sasia e zërit të mbrojtur që banka në fakt mbron dhe sasia e instrumentit mbrojtës që banka në fakt përdor për të mbrojtur atë sasi të zërit të mbrojtur.

Nëse një marrëdhënie mbrojtëse pushon së përbushuri kërkesën e efektivitetit të mbrojtjes në lidhje me raportin e mbrojtjes, por objektivi i menaxhimit të rrezikut për atë marrëdhënie mbrojtëse të përcaktuar mbetet i njëjtë, banka rregullon raportin e mbrojtjes së marrëdhënies mbrojtëse (domethënë ri-balancin mbrojtjen) në mënyrë që ajo të përbushë përsëri kriteret kualifikuese. Banka përcakton ndryshimin e plotë në vlerën e drejtë të një kontrate forward (d.m.th. duke përfshirë elementët forward) si instrument mbrojtës për të gjitha marrëdhëniet e saj mbrojtëse që përfshijnë kontratat forward.

Banka përcakton vetëm vlerën e brendshme të kontratave opsionale si një zë i mbrojtur, d.m.th. duke përjashtuar vlerën në kohë të opsionit. Ndryshimet në vlerën e drejtë të vlerës në kohë të harmonizuar të opsionit njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohen në koston e rezervës mbrojtëse. Nëse zëri i mbrojtur ndërlihet me transaksionin, vlera në kohë riklasifikohet në fitim ose humbje kur zëri i mbrojtur ndikon në fitim ose humbje. Nëse zëri i mbrojtur lidhet me periudhën kohore, atëherë shuma e akumuluar në koston e rezervës mbrojtëse riklasifikohet në fitim ose humbje mbi një bazë racionale - banka zbaton amortizimin linear.

Këto shuma të riklasifikuara njihen në fitim ose humbje në të njëjtën linjë sikur zëri i mbrojtur. Nëse zëri i mbrojtur është një zë jo-financiar, atëherë shuma e akumuluar në koston e rezervës mbrojtëse hiqet drejtpërdrejt nga kapitali dhe përfshihet në vlerën fillestare kontabël të zërit jo-financiar të njohur. Për më tepër, nëse banka pret që një pjesë ose e gjithë humbja e akumuluar në koston e rezervës mbrojtëse nuk do të rikuperohet në të ardhmen, kjo shumë riklasifikohet menjëherë në fitim ose humbje. Shënimi 4 përcakton detajet e vlerave të drejta të instrumenteve derivate të përdorura për qëllime të mbrojtjes.

#### ***Mbrojtjet e vlerës së drejtë***

Ndryshimi i vlerës së drejtë të instrumenteve mbrojtëse kualifikuese njihet në fitim ose humbje, përveç rasteve kur instrumenti mbrojtës mbron një instrument kapitali të përcaktuar me FVTOCI (vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse), në të cilin rast ai njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Vlera kontabël e një zëri të mbrojtur që nuk është matur tashmë me vlerë të drejtë rregullohet për ndryshimin e vlerës së drejtë që i atribuohet rrezikut të mbrojtur me një regjistrim korrespondues në fitim ose humbje. Për instrumentet e borxhit të matura me FVTOCI (vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse), vlera kontabël nuk rregullohet pasi që ajo tashmë është në vlerë të drejtë, mirëpo fitimi ose humbja mbrojtëse njihet në fitim ose humbje në vend të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Kur zëri i mbrojtur është një instrument kapitali i përcaktuar në FVTOCI, fitimi ose humbja mbrojtëse mbetet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për t'u përputhur me atë të instrumentit mbrojtës. Kur fitimet ose humbjet mbrojtëse njihen në fitim ose humbje, ato njihen në të njëjtën linjë si zëri i mbrojtur. Banka ndërpret kontabilitetin mbrojtës vetëm kur marrëdhënia mbrojtëse (apo një pjesë e saj) pushon së përbushuri kriteret kualifikuese (pas ri-balancimit, nëse është e aplikueshme). Kjo përfshin rastet kur instrumenti mbrojtës skadon ose shitet, ndërpritet ose ushtrohet. Ndërprerja kontabilizohet në mënyrë prospektive. Rregullimi i vlerës së drejtë në vlerën kontabël të zërit të mbrojtur që rrjedh nga rreziku i mbrojtur amortizohet në fitim ose humbje nga ajo datë.

#### ***Mbrojtjet e fluksit të parasë***

Pjesa efektive e ndryshimeve në vlerën e drejtë të derivateve dhe instrumenteve të tjera mbrojtëse që kualifikohen si mbrojtje të fluksit të parave njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohet nën titullin rezerva mbrojtëse të fluksit të parave, e kufizuar në ndryshimin kumulativ në vlerën e drejtë të zërit të mbrojtur që nga fillimi i mbrojtjes. Fitimi ose humbja që lidhet me pjesën joefektive njihet menjëherë në fitim ose humbje dhe përfshihet në zërin "fitimet dhe humbjet e tjera".

Shumat e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe të akumuluar në kapital riklasifikohen në fitim ose humbje në periudhat kur zëri i mbrojtur ndikon në fitim ose humbje, në linjën e njëjtë si zëri i mbrojtur i njohur. Megjithatë, kur transaksioni i parashikuar i mbrojtur rezulton në njohjen e një aktivi jo-financiar ose një detyrimi jo-financiar, fitimet dhe humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe të akumuluar në ekuitet hiqen nga kapitali dhe përfshihen në matjen fillestare të koston e aktivitetit jo-financiar apo detyrimit jo-financiar. Ky transferim nuk ndikon në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Për më tutje, nëse banka pret që një pjesë ose e gjithë humbja e akumuluar në rezervën e mbrojtjes së fluksit monetar nuk do të rikuperohet në të ardhmen, kjo shumë riklasifikohet menjëherë në fitim ose humbje.

Banka ndërpret kontabilitetin mbrojtës vetëm kur marrëdhënia mbrojtëse (ose një pjesë e saj) pushon së përbushuri kriteret kualifikuese (pas ri-balancimit, nëse është e aplikueshme). Kjo përfshin rastet kur instrumenti mbrojtës skadon ose shitet, ndërpritet ose ushtrohet. Ndërprerja kontabilizohet në mënyrë prospektive. Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse

dhe e akumuluar në rezervën mbrojtëse të fluksit monetar në atë kohë mbetet në ekuitet dhe riklasifikohet në fitim ose humbje kur ndodh transaksioni i parashikuar. Kur një transaksion i parashikuar nuk pritet për më tutje të ndodhë, fitimi ose humbja e akumuluar në rezervën mbrojtëse të fluksit monetar riklasifikohet menjëherë në fitim ose humbje.

### ***Mbrojtjet e investimeve neto në operacionet e huaja***

Mbrojtjet e investimeve neto në operacionet e huaja kontabilizohen në mënyrë të ngjashme me mbrojtjet e fluksit monetar. Çdo fitim ose humbje nga kontratat forward në valutë të huaj që lidhen me pjesën efektive të mbrojtjes njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohet në rezervën e konvertimit të valutës së huaj. Fitimi ose humbja që lidhet me pjesën joefektive njihet menjëherë në fitim ose humbje dhe përfshihet në zërin 'fitimet dhe humbjet e tjera'. Fitimet dhe humbjet në instrumentin mbrojtës të akumuluar në rezervën e konvertimit të valutës së huaj riklasifikohen në fitim ose humbje me shitjen apo shitjen e pjesshme të operacionit të huaj.

### **3.10. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të mëparshme, Banka ka një detyrim të tanishëm ligjor ose të krijuar që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që do të duhen të harxhohen mjete monetare për të mbuluar detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të pritshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe risqet ndaj detyrimit. Korrigjimi i skontimit njihet si kosto financiare. Detyrimet kontingjente mund të zhvillohen në një mënyrë që nuk është pritur fillimisht.

Prandaj, ato vlerësohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse dalja e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është bërë e mundshme. Në rast se detyrimi kontingjent rezulton në një detyrim aktual që mund të matet me besueshmëri, duhet të regjistrohet në bilanc provizioni për shumën. Vetëm zotimet e pakthyeshme shkaktojnë rrezik kreditor, pra vetëm kontingjentat dhe zotimet e pakthyeshme mund të jenë objekt i provizionimit. Për ekspozimet e konsiderueshme, vlerësimi bëhet në mënyrë individuale. Në rast të vlerësimit të bazuar në portofol, ndërtimi i portofolit dhe llogaritja e provizioneve të bazuara në portofol llogariten siç tregohet në zhvlerësimin e Kredive dhe Paradhënieve.

### **3.11. Përfitimet e punonjësve**

Banka paguan vetëm kontribute për planin pensional të administruar publikisht në baza të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzim i përfitimeve të punonjësve në kohën kur ato duhet të paguhen.

### **3.12. Kapitali aksionar**

#### ***Dividentët në aksionet e zakonshme***

Dividentët në aksionet e zakonshme njihen në ekuitet në periudhën në të cilën janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividentët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit shpalosen si ngjarje pas fundit të periudhës së raportimit.

### **3.13. Rezervat e ekuitetit**

Rezervat e kapitalit përbëhen nga rezervat e vlerës së drejtë dhe fitimet e pashpërndara.

Rezervat e regjistruara në OCl brenda kapitalit në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës përfshijnë:

- Rezerva e vlerës së drejtë që përfshin ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Fitimet e mbajtura përfshijnë fitimet kumulative jo të shpërndara dhe shpërndahen me miratimin e Aksionarit të Përgjithshëm të Bankës dhe miratimin rregullator të Bankës Qendrore.

### **3.14. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare me interes njihen përmes fitimit ose humbjes për periudhën përkatëse brenda 'të ardhurave nga interesi' dhe 'shpenzimeve nga interesi' me përdorimin e metodës së interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar dhe e shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse.

Norma efektive e interesit është norma e cila skonton saktësisht pagesat ose arkëtimet e ardhshme të parave të gatshme gjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, gjatë një periudhe më të shkurtër në vlerën kontabël neto të aktivit ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por nuk merr parasysh humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksionit dhe tarifat dhe pikët e paguara ose të marra që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një aktivi financiar apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në fitim ose humbje përfshijnë:

- interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar të llogaritura në bazë të interesit efektiv; dhe
- interesin në letrat me vlerë të investimit të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI), i llogaritur në bazë të interesit efektiv.

Kur një pasuri financiare bëhet i kreditit të zhvlerësuar (i rënë në vlerë) dhe, për këtë arsye konsiderohet si 'Faza 3', Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar neto të aktivitetit financiar. Nëse aktivet financiare trajtohen dhe nuk i përkasin më tutje kreditit të zhvlerësuar, Banka kthehet në llogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza bruto.

Për aktivet financiare të blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar (POCI), Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke llogaritur normën efektive të interesit të kreditit të rregulluar dhe duke aplikuar atë normë në koston e amortizuar të aktivitetit. NEI (norma efektive e interesit) e kreditit të rregulluar është norma e interesit që, në njohjen fillestare, zvogëlon rrjedhat monetare të ardhshme të vlerësuara (duke përfshirë humbjet kreditore) në koston e amortizuar të pasurive të POCI. Banka mban gjithashtu investime në aktivet e emetuara në vende me norma negative të interesit. Banka shpallë interesin e paguar për këto aktive si shpenzim interesi, me shpallje shtesë në Shënimin 21. Të ardhurat nga interesi në të gjitha aktivet tregtare dhe aktivet financiare të detyrueshme për t'u matur me FVPL, njihen duke përdorur normën e interesit kontraktual në të ardhurat neto të tregtueshme dhe fitimet/(humbjet) neto të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, përkatësisht.

### 3.15. Tarifa dhe komisioni

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një pasuri financiare ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Nëse një zotim kredie nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e një kredie, atëherë tarifa përkatëse e zotimit të kredisë njihet në bazë lineare përgjatë periudhës së zotimit.

Të ardhurat e tjera nga tarifat dhe komisionet – duke përfshirë tarifat e shërbimit të llogarisë, komisionin e shitjeve, tarifat e kartelave dhe të bankomatëve, tarifat e arkëtimit të pagesave, njihen përderisa shërbimet përkatëse kryhen, përkatësisht me kalimin e kohës përderisa shërbimet ofrohen dhe/ose në një moment në kohën kur kryhet transaksioni (tarifa të bazuara në transaksion). Më shumë informacione rreth detyrimeve të performancës së Bankës janë dhënë në Shënimin 23.

Një kontratë me një klient që rezulton në një instrument financiar të njohur në pasqyrat financiare të Bankës mund të jetë pjesërisht në objektin e SNRF 9 dhe pjesërisht në objektin e SNRF 15. Nëse ndodh ashtu, atëherë Banka së pari zbaton SNRF 9 për të ndarë dhe matur pjesën e kontratës që është në objektin e SNRF 9 dhe zbaton SNRF 15 për komponentin e mbetur. Shpenzimet e tjera për tarifat dhe komisionet lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimesh të cilat paraqiten si shpenzim në momentin që pranohen shërbime.

### 3.16. Të ardhura neto nga instrumentet të tjera financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Të ardhurat neto nga instrumentet e tjera financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes ndërlidhen me instrumentet derivative jo të tregtueshme të mbajtura për qëllime të menaxhimit të riskut që nuk janë pjesë e raporteve kualifikuese mbrojtëse dhe aktiveve dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Ato përfshijnë të gjitha ndryshimet e realizuara dhe të parealizuara të vlerës së drejtë, interesin, dividendat dhe ndryshimet në këmbimin valutë.

### 3.17. Tatimi në të ardhura

Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Ai njihet në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur drejtpërdrejt në ekuitet apo në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

#### *Tatimi aktual*

Tatimi aktual përfshin tatimin e pritshëm të pagueshëm ose të arkëtueshëm mbi të ardhurat ose humbjet e tatueshme për vitin përkatës dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm apo të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Ai matet duke përdorur normat tatimore të hyra në fuqi apo të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit.

#### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë është tatimi që pritet të paguhet ose rikuperohet mbi diferencat ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës tatimore përkatëse të përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe kontabilizohet duke përdorur metodën e detyrimeve.

Detyrimet tatimore të shtyra përgjithësisht njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen në masën që ka të ngjarë që fitimet e tatueshme të jenë të disponueshme kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme. Këto aktive dhe detyrime nuk njihen nëse diferenca e përkohshme lind nga njohja fillestare (përveç një kombinimi biznesi) e aktiveve dhe detyrimeve të tjera në një transaksion që nuk ndikon as në fitimin e tatueshëm dhe as në fitimin kontabël.

Vlera kontabël e pasurive tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në masën që nuk është më e mundshme që fitime të mjaftueshme të tatueshme do të jenë të disponueshme për të mundësuar rikuperimin e të gjithë ose një pjesë të aktivitetit. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që priten të zbatohen në periudhën kur detyrimi shlyhet, ose aktiviteti është realizuar në bazë të ligjeve dhe normave tatimore që kanë hyrë në fuqi apo në thelb janë miratuar në datën e raportimit.

## 4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

### 4.1. Përmbledhje

Banka është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga shfrytëzimi i instrumenteve financiare:

- rreziku kreditor
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operativ

Ky shënim paraqet informacione rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit nga risqet të mësipërme, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e riskut, si dhe menaxhimin e kapitalit nga ana e Bankës.

#### Korniza e menaxhimit të rrezikut

Kontrollet e brendshme dhe mjete tjera të kontrollit të riskut të vendosura nga Menaxhimi i rrezikut i Raiffeisen International mundësojnë menaxhimin e kontrolluar të rrezikut të Bankës. Mjetet kryesore të menaxhimit të riskut janë miratuar nga Raiffeisen International dhe zbatohen për përdorim nga Banka.

Banka ka vepruar në përputhje dhe ka raportuar bazuar në kërkesat e Basel II në nivel të Grupit duke mbuluar rreziqet e kreditit dhe të tregut. Zbatimi i kërkesave të Basel II duhet të sigurojë një menaxhim më të mirë të kapitalit.

Bazuar në politikat e Bankës, totali i aktiveve të Bankës klasifikohet dhe analizohet si më poshtë:

- Analiza e aktiveve bazuar në klasën e aktivitet/produktit (aktivet klasifikohen bazuar në Katalogun e Produkteve të Grupit);
- Analiza e aktiveve bazuar në cilësinë e kredisë (aktivet klasifikohen në bazë të Direktivave të Grupit);
- Analiza e aktiveve në përputhje me bazën e matjes;

Analiza e aktiveve në bazë të vjetërsisë, që nënkupton analiza të kryera për aktivet që janë në vonesë pagesës, por nuk janë zhvlerësuar;

- Analiza individuale e aktiveve të përcaktuara si të zhvlerësuar nga faktorët e zhvlerësimit;
- Analiza e aktiveve bazuar në llojin e kolateralit dhe duke marrë parasysh shumën e vlerësuar të rikuperueshme;

Analiza e aktiveve bazuar në përqendrimin e risqeve për industrinë/sectorin/segmentin/shumën e caktuar të ekspozimit.

### 4.2. Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për Bankën nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe shfaqet kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e bankës për klientët dhe bankat e tjera dhe investimet në letrat me vlerë. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, banka i merr në konsideratë të gjitha elementët e ekspozimit ndaj riskut kreditor (siç është rreziku i mospagesës i obliguesit individual, rreziku i vendit dhe sektorit). Banka merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut kreditor i cili është rreziku që pala tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë shumat e plota në kohën e duhur. Banka i strukturon nivelet e rrezikut kreditor që i merr përsipër duke vendosur limite në sasinë e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës dhe segment gjeografik apo industrial. Rreziqet e tilla monitorohen vazhdimisht dhe i nënshtrohen rishikimit mujor ose më të shpeshtë. Limitet në nivelin e rrezikut kreditor nga huamarrësi miratohen nga menaxhmenti.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor menaxhohet përmes analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve potencialë për të përmbushur detyrimet e pagesës së interesit dhe principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur kjo është e përshtatshme. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor menaxhohet, pjesërisht, me marrjen e kolateralit dhe garancive të korporatave dhe atyre personale.

Ekspozimi maksimal i Bankës ndaj rrezikut kreditor reflektohet para se gjithash në vlerat kontabël të aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar. Ndikimi i kompensimit reciprok (netimit) të mundshëm të aktiveve dhe detyrimeve për të zvogëluar ekspozimin e mundshëm kreditor nuk është i rëndësishëm.

Rreziku kreditor për instrumentet financiare jashtë bilancit përcaktohet si mundësia e mbajtjes së humbjes si rezultat i asaj që një palë tjetër në një instrument financiar nuk arrin të veprojë në përputhje me kushtet e kontratës. Banka përdor politikat e njëjta kreditore kur bën detyrimet e kushtëzuara ashtu siç bën për instrumentet financiare të bilancit nëpërmjet miratimeve të përcaktuara të kredive, limiteve të kontrollit të rrezikut dhe procedurave të monitorimit.

Banka mban lloje të ndryshme të kolateralit si siguri për rrezikun kreditor. Përveç kësaj, zbatohen edhe metoda të tjera për

përmirësimin kreditor. Llojet kryesore të kolateralit janë të cekura më poshtë:

- Prona (tokë, ndërtesa)
- Apartamente
- Automjete
- Pajisje
- Garancione Personale

Vlera e kolateralit llogaritet sipas metodave të specifikuar të cilat përfshijnë formula të standardizuara të llogaritjes bazuar në vlerat e tregut, zbritjet e paracaktuara dhe vlerësimet e ekspertëve.

Vlerësimi dhe rivlerësimi i kolateralit janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Specialistëve të Kolateralit të bankës, për të gjitha llojet e kolateraleve. Vlerësimi i pasurive të patundshme përditësohet një herë në vit. Ky përditësim vjetor realizohet nga Specialistët e brendshëm të Kolateralit. Nëse përditësimi i rivlerësimit nuk bëhet çdo 18 muaj, atëherë vlera e ponderuar e kolateralit (WCV) hipotekar përkatës zbritet 10 për qind për secilin vit për sa kohë që nuk kryhet përditësimi. Kërkohet monitorim më i shpeshtë kur tregu i pasurive të patundshme është subjekt i ndryshimeve të rëndësishme të rrethanave.

### ***Kreditë e zhvlerësuara dhe letrat me vlerë të zhvlerësuara***

Kreditë e zhvlerësuara dhe letrat me vlerë të zhvlerësuara janë kreditë dhe letrat me vlerë për të cilat Banka përcakton se ka:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose huamarrësit;
- një shkelje të kontratës, e tillë si një mospagesë e detyrimeve ose një ngjarje e vonuar;
- huadhënësi/ët e huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale që lidhen me vështirësitë financiare të huamarrësit, i ka/në dhënë huamarrësit një koncesion/e të cilin/at huadhënësi në të kundërtën nuk do t'i kishte marrë në konsideratë.
- po bëhet e mundshme që huamarrësi të hyjë në falimentim ose në një riorganizim tjetër financiar;
- zhdukja e një tregu aktiv për atë pasuri financiare për shkak të vështirësive financiare; ose
- blerja ose krijimi i një aktivi financiar me një zbritje të thellë që pasqyron humbjet e shkaktuara nga kredia.

ECL-të maten në një mënyrë e cila pasqyron vlerën në kohë të parasë. Kjo do të thotë se mungesat e parave të gatshme që lidhen me mospagimin kërkohet të skontohehen në datën e bilancit. Për aktivet e Fazës 3, ECL-të skontohehen duke përdorur EIR origjinale, ndërsa për aktivet POCl ECL-të zbriten duke përdorur CAEIR.

### ***Kreditë me kushte të rinegociuara***

Kreditë me kushte të rinegociuara janë kreditë që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të gjendjes financiare të huamarrësit dhe ku Banka ka bërë lëshime që në të kundërtën nuk do t'i merrte në konsideratë. Pasi që kredia të ristrukturohet, ajo mbetet në këtë kategori derisa të vërehet performanca e qëndrueshme. Performanca e qëndrueshme përkufizohet si tri pagesa kontraktuale të njëpasnjëshme të principalit dhe/ose interesit.

### ***ECL (Humbjet e pritshme kreditore)***

Banka vendos shuma dhe provizione për humbjet e pritshme kreditore që përfaqësojnë vlerësimin e saj të humbjeve të pritshme në portofolin e saj të kredive/ letrave me vlerë dhe atë jashtë bilancit.

### ***Politika e shlyerjes/fshirjes***

Pasuritë financiare fshihen pjesërisht ose në tërësi vetëm kur Banka ka ndaluar së ndjekuri rikuperimin.

Kriteret e mëposhtme janë të zbatueshme për ekspozimet retail:

- kur aktivi klasifikohet si jo-performues dhe aktivi nuk është i siguar me kolateral, aktivi shlyhet brenda 18 muajve;
- kur aktivi klasifikohet si jo-performues dhe aktivi është i siguar me kolateral të lënë peng, aktivi shlyhet brenda 36 muajve;
- Kur aktivi klasifikohet si jo-performues dhe aktivi është i siguar me hipotekë, aktivi shlyhet brenda 60 muajve.

Kriteret e mëposhtme janë të zbatueshme për ekspozimet jo-retail:

- kur llogaritja e ILLP-së bëhet me qasjen e mosvijimësisë dhe aktivi provizionohet 100%;
- kur ka mungesë të flukseve monetare të ardhshme të pritshme nga operacionet;
- kur vlera e drejtë minus kostoja e shitjes së një kolateralit ende ekzistues të përdorur në llogaritjen e zhvlerësimit është zero ose për më tej nuk ka kolateral.

Nëse shuma për t'u shlyer është më e madhe se shuma për humbje të akumuluar, diferenca trajtohet fillimisht si një shlyerje e drejtpërdrejtë në pasqyrën e fitimit dhe humbjes. Çdo rikuperim i mëvonshëm kreditohet në shpenzimet e humbjeve nga kreditë.

## Përmbledhje e kredive të riprogramuara

Tabelat e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje të aktiveve të modifikuara të Bankës më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024.

31 Dhjetor 2025	Faza 2					Faza 3			Raporti i kredive të modifikuara
	Vlera kontabël	Modifikime të përkoreshme të T&C për shkak të COVID-19	Modifikime të përhershme të T&C	Totali i kredive performuese të riprogramuara	Modifikime të përkoreshme të T&C për shkak të COVID-19	Modifikime të përhershme të T&C	Totali i kredive joperformuese të riprogramuara	Totali i kredive të riprogramuara	
Detyrimet nga bankat	47,443	-	-	-	-	-	-	-	0%
<b>Kredi dhe paradhënie për klientët</b>									
Jo retail	453,722	267	2,582	-	65	3,410	-	-	0%
Retail	835,496	11,500	2,820	1,634	2,067	2,650	2,356	3,990	0%
<b>Totali i kredive dhe paradhënieve për klientët</b>	<b>1,289,218</b>	<b>11,767</b>	<b>5,402</b>	<b>1,634</b>	<b>2,132</b>	<b>6,060</b>	<b>2,356</b>	<b>3,990</b>	<b>0%</b>

31 Dhjetor 2024	Faza 2					Faza 3			Raporti i kredive të modifikuara
	Vlera kontabël	Modifikime të përkoreshme të T&C për shkak të COVID-19	Modifikime të përhershme të T&C	Totali i kredive performuese të riprogramuara	Modifikime të përkoreshme të T&C për shkak të COVID-19	Modifikime të përhershme të T&C	Totali i kredive joperformuese të riprogramuara	Totali i kredive të riprogramuara	
Detyrimet nga bankat	3,143	-	-	-	-	-	-	-	0%
<b>Kredi dhe paradhënie për klientët</b>									
Joretail	408,710	603	1,577	-	152	3,504	-	-	0%
Retail	701,888	17,590	3,466	1,548	3,118	2,789	2,467	4,015	1%
<b>Totali i kredive dhe paradhënieve për klientët</b>	<b>1,110,598</b>	<b>18,193</b>	<b>5,043</b>	<b>1,548</b>	<b>3,270</b>	<b>6,293</b>	<b>2,467</b>	<b>4,015</b>	<b>1%</b>

## Përmbledhje e kredive të riprogramuara

31 Dhjetor 2025	Shuma bruto e kredive të modifikuara			ECL-të e kredive të modifikuara		
	Faza 2	Faza 3	Gjithsej	Faza 2 kolektive	Faza 3 Kolektive	Gjithsej
Detyrime nga bankat	-	-	-	-	-	-
<b>Kredi dhe paradhënie për klientët</b>						
Joretail	-	-	-	-	-	-
Retail	1,409	1,760	3,169	194	1,412	1,606
<b>Totali i kredive dhe paradhënieve për klientët</b>	<b>1,409</b>	<b>1,760</b>	<b>3,169</b>	<b>194</b>	<b>1,412</b>	<b>1,606</b>

31 Dhjetor 2024	Shuma bruto e kredive të modifikuara			Humbjet e pritshme të kredive të modifikuara		
	Faza 2	Faza 3	Gjithsej	Faza 2 Kolektive	Faza 3 Kolektive	Gjithsej
Detyrime nga bankat	-	-	-	-	-	-
<b>Kredi dhe paradhënie për klientët</b>						
Joretail	-	-	-	-	-	-
Retail	1,501	1,863	3,364	266	1,459	1,725
<b>Totali i kredive dhe paradhënieve për klientët</b>	<b>1,501</b>	<b>1,863</b>	<b>3,364</b>	<b>266</b>	<b>1,459</b>	<b>1,725</b>

**Kreditë dhe paradhëniet për klientët**

Ekspozimet maksimale ndaj rrezikut kreditor para përmirësimeve të kolateralit dhe përmirësimeve tjera kreditore më 31 dhjetor 2025 të aktiveve financiare sipas sektorit të palës tjetër.

<b>Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor</b>		
	<b>31-Dhjetor-25</b>	<b>31-Dhjetor-24</b>
Banka Qendrore e Kosovës	100,121	79,092
Bankat e tjera	93,380	10,510
Investimet në filiale	4,234	4,234
Sovranët	322,421	236,094
Korporatat Ndërkombëtare	-	9,523
Korporatat lokale	453,722	408,710
Klientët lokalë retail	835,496	701,888
<b>Gjithsej ekspozimi ndaj rrezikut të aktiveve financiare</b>	<b>1,809,374</b>	<b>1,450,051</b>

Tabelat më poshtë paraqesin informacionin në lidhje me cilësinë kreditore së kredive dhe paradhëniet për klientët dhe shumën për zhvlerësim/humbje të mbajtur nga Banka kundrejt këtyre aktiveve.

<b>Kreditë dhe paradhëniet për klientët</b>		
	<b>2025</b>	<b>2024</b>
<b>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor</b>		
Shuma bruto	1,289,218	1,110,598
Provizioni për zhvlerësim	(46,386)	(38,155)
<b>Vlera kontabël neto</b>	<b>1,242,832</b>	<b>1,072,443</b>
<b>Kredi me kushte të rinegociuara</b>		
Vlera kontabël bruto	25,361	32,798
Provizioni për zhvlerësim	(6,510)	(7,704)
<b>Vlera kontabël neto</b>	<b>18,851</b>	<b>25,094</b>

**Kreditë dhe paradhëniet për klientët**

Më poshtë është paraqitur një analizë e kolateralit dhe përmirësimit të kredisë të marrë gjatë viteve:

<b>31 Dhjetor 2025</b>	<b>Kreditë dhe paradhëniet për klientët</b>			<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>		
	<b>Retail</b>	<b>Korporata</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>Retail</b>	<b>Korporata</b>	<b>Gjithsej</b>
Pasuri të Paluajtshme Komerçiale	1	7,844	7,845	-	7,003	7,003
Pasuri të Paluajtshme për Banim	128,660	-	128,660	114,689	-	114,689
Pasuri të luajtshme	519,963	429,314	949,277	205,974	402,085	608,059
Të pasiguruara	186,872	16,564	203,436	-	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>835,496</b>	<b>453,722</b>	<b>1,289,218</b>	<b>320,663</b>	<b>409,088</b>	<b>729,751</b>

<b>31 Dhjetor 2024</b>	<b>Kreditë dhe paradhëniet për klientët</b>			<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>		
	<b>Pakicë</b>	<b>Korporatë</b>	<b>Totali</b>	<b>Pakicë</b>	<b>Korporatë</b>	<b>Totali</b>
Pasuri të Paluajtshme Komerçiale	60	7,822	7,882	45	7,024	7,069
Pasuri të Paluajtshme për Banim	103,214	-	103,214	94,243	-	94,243
Pasuri të luajtshme	174,935	383,762	558,697	59,628	355,239	414,867
Të pasiguruara	423,679	17,126	440,805	-	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>701,888</b>	<b>408,710</b>	<b>1,110,598</b>	<b>153,916</b>	<b>362,263</b>	<b>516,179</b>

Më poshtë është paraqitur një analizë e aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar. Përveç nëse tregohet në mënyrë specifike, për aktivet financiare, shumat në tabelë përfaqësojnë vlerat kontabël bruto:

31 Dhjetor 2025	Gjithsej vlera kontabël bruto	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Vlera e drejtë e kolateralit
Klientë jo-retail	453,722	416,323	13,992	23,407	320,663
Klientë retail	835,496	726,044	84,588	24,864	409,088
<b>Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët</b>	<b>1,289,218</b>	<b>1,142,367</b>	<b>98,580</b>	<b>48,271</b>	<b>729,751</b>

31 Dhjetor 2024	Gjithsej vlera kontabël bruto	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Vlera e drejtë e kolateralit
Klientë jo-retail	408,710	339,617	56,112	12,981	153,916
Klientë retail	701,888	544,308	135,138	22,442	362,263
<b>Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët</b>	<b>1,110,598</b>	<b>883,925</b>	<b>191,250</b>	<b>35,423</b>	<b>516,179</b>

Një analizë e përqendrimeve të rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 për kreditë dhe paradhëniet për klientët me vonesë dhe të zhvlerësuar - Faza 3 dhe POCI paraqitet më poshtë:

31 Dhjetor 2025	Sipas kërkesës dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Klientë jo-retail	10,784	55	2,368	4,397	17,604
Klientë retail	3,223	336	2,373	22,850	28,782
<b>Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët, të zhvlerësuar</b>	<b>14,007</b>	<b>391</b>	<b>4,741</b>	<b>27,247</b>	<b>46,386</b>

31 Dhjetor 2024	Sipas kërkesës dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Klientë jo-retail	1,731	716	1,668	7,644	11,759
Klientë retail	2,638	364	1,632	21,762	26,396
<b>Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët, të zhvlerësuar</b>	<b>4,369</b>	<b>1,080</b>	<b>3,300</b>	<b>29,406</b>	<b>38,155</b>

Banka monitoron përqendrimet e rrezikut kreditor sipas sektorëve. Përqendrimet e rrezikut të sektorit ekonomik brenda portofolit të kredive për klientë janë si më poshtë:

	2025	%	2024	%
Tregtia	174,558	14%	158,420	14%
Individët	1,057,697	82%	892,484	80%
Prodhimi, kimike dhe përpunuese	39,337	3%	40,687	4%
Shërbimet	7,831	1%	8,431	1%
Ndërtim dhe servise ndërtimi	5,310	0%	5,359	0%
Industria ushqimore dhe bujqësia	4,485	0%	5,106	0%
Të tjera	-	0%	111	0%
<b>Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët para provizionit për zhvlerësim të kredisë</b>	<b>1,289,218</b>	<b>100%</b>	<b>1,110,598</b>	<b>100%</b>

### Detyrimet nga bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga menaxhimi i riskut dhe Departamenti i Thesarit. Banka i kufizon depozitat dhe transaksionet e tjera bankare në banka solide vendore ose ndërkombëtare. Përpara se të fillohet një marrëdhënie biznesi me një bankë të caktuar, menaxhmenti dhe Departamenti i Rrezikut kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korresponduese, si dhe emetuesit e bonove në të cilat Banka ka ekspozime investimi, monitorohen vazhdimisht për vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit. Për të përfaqësuar vlerësimet e agjencive të ndryshme ndërkombëtare të vlerësimit, tabelat më poshtë janë përgatitur në përputhje me shkallët e vlerësimit të Bankës Qendrore të Kosovës të cilat përfaqësojnë si vijon:

Vlerësimet Ndërkombëtare të Rrezikut				
Përkufizimet e vlerësimeve	Shkalla e Vlerësimit e Moody's		Shkalla e Vlerësimit e Fitch	
	Shkalla e vlerësimit afatgjatë	Shkalla e vlerësimit afatshkurtër	Shkalla e vlerësimit afatgjatë	Shkalla e vlerësimit afatshkurtër
Cilësi e lartë e kredisë	Aaa	P-1	AAA	F1+
	Aa1		AA+	
	Aa2		AA	
	Aa3		AA-	
Kapacitet i fortë pagese	A1	P-2	A+	F1/F1+/F2
	A2		A	
	A3		A-	
Kapacitet adekuat pagese	Baa1	P-3	BBB+	F2/F3
	Baa2		BBB	
	Baa3		BBB-	
Kapacitet spekulativ pagesës	Ba1	Jo Kryesor	BB+	B
	Ba2		BB	
			BB-	

Një funksion i pavarur nga departamenti i thesarit, zakonisht menaxhimi i rrezikut, duhet të monitorojë që ekspozimi ndaj të gjitha bankave të mos tejkalojë kufijtë rregullatorë ose kufijtë e brendshëm të përcaktuar nga menaxhmenti i Bankës. Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk do të kenë ndonjë ekspozim të përgjithshëm ndaj rrezikut kreditor ndaj palëve të ndërlidhura që tejkalon 15 përqind të Kapitalit Rregullator të Nivelit I.

Detyrimet nga bankat jepen pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse dhe depozitat e afatizuara të Bankës me bankat korresponduese sipas vlerësimit(klasifikimit) kreditor, të cilat klasifikohen të gjitha si Faza 1.

Më 31 dhjetor	2025	2024
P-1	45,938	10,510
P-2	-	-
P-3	-	-
	<b>45,938</b>	<b>10,510</b>

### Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letra me vlerë janë kryesisht bonot qeveritare me vendet e OECD-së, bonot e thesarit të Republikës së Kosovës dhe bonot e korporatave.

Investimet janë kryesisht për menaxhimin e likuiditetit të bankës dhe sigurojnë diversifikim të mjaftueshëm të rrezikut për sa i përket ekspozimit kreditor me një sovran, duke marrë në konsideratë edhe mjedisin rregullator lokal dhe kufizimin e ekspozimeve të mëdha.

Tabela e mëposhtme paraqet ekspozimin ndaj letrave me vlerë bazuar në vlerësimin(klasifikimin) ndërkombëtar të rrezikut:

	2025	2024
Aaa	79,523	102,274
Aa1	142,752	66,747
Aa2	-	40,741
Aa3	34,835	-
A3	22,110	-
Baa3	-	3,586
Ba3	-	32,236
BB-	43,166	-
	<b>322,386</b>	<b>245,584</b>

Duke filluar nga viti 2024, Bonot e Qeverisë së Kosovës janë vlerësuar me BB-.

### 4.3. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve nga detyrimet e saj financiare. Banka është e ekspozuar ndaj thirrjeve ditore për burimet e saj të parave të disponueshme nga llogaritë rrjedhëse, depozitat e maturuara, tërheqjet e kredive dhe garancitë. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga Menaxhmenti i Bankës.

Banka mban aktive afatmesme deri në afatgjata dhe për shkak të kushteve të tregut, financon pjesën më të madhe të portofolit të saj me borxh afatshkurtër. Në këtë proces Banka merr rrezikun e likuiditetit që lidhet me mospërputhjet e maturitetit. Banka lëshon aktive afatgjata, si kredi PI dhe kredi hipotekare, dhe këto portofole financohen kryesisht nga depozita pa afat dhe depozita me afat deri në 1 vit. Menaxhmenti merr në baza ditore informacionin e raportit të likuiditetit të Bankës, dhe gjithashtu në baza javore merr një raport të likuiditetit të renditur sipas segmentit të biznesit. Duke qenë se Banka emeton aktive afatmesme deri në afatgjata dhe e financon atë me borxh afatshkurtër dhe afatmesëm, ajo është gjithashtu e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

Rezerva rregullatore e likuiditetit llogaritet si 10 për qind e detyrimeve mesatare të pagueshme brenda një viti, e cila rezervë mbahet nga depozitat në bankën qendrore dhe 50 për qind e parash fizike. Banka monitoron këtë kërkesë dhe e raporton atë në baza mujore rezervën e likuiditetit të detyrueshëm për çdo ditë pune. Tabela më poshtë tregon vlerat kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 sipas maturimit të mbetur kontraktual të tyre.

Sidoqoftë, Banka pret që shumë klientë nuk do të kërkojnë ripagesën e depozitave në datën më të hershme që mund të kërkohej të paguhen dhe tabela nuk pasqyron flukset e parave të gatshme të pritshme të treguara nga historia e saj e mbajtjes së depozitave. Veç kësaj, Banka po përdor aktin e deleguar të BE-së LCR për menaxhimin e likuiditetit dhe kërkohej të mbajë likuiditet nga 10 për qind në 10.9 për qind për depozitat e pasiguruara retail dhe për qindje për depozitat e siguruara. Për joretail planifikohet një dalje prej 33 për qind deri në 85 për qind, bazuar në atë nëse llogaria është operacionale apo jo. LCR i BE-së duhet të jetë mbi 100 për qind. Më 31 dhjetor 2025, Banka ishte shumë mbi këtë limit në mbi 300 për qind.

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Totali
<b>Pasuritë</b>					
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	254,501	-	-	-	254,501
Detyrimet nga bankat	49,199	-	-	-	49,199
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	21,469	22,883	222,025	976,455	1,242,832
Investimet ne letra me vlerë	73,867	-	108,236	140,283	322,386
Pasuritë e tjera	-	-	2,962	-	2,962
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>399,036</b>	<b>22,883</b>	<b>333,223</b>	<b>1,116,738</b>	<b>1,871,880</b>
<b>Detyrimet</b>					
Depozitat nga klientët	1,350,894	49,440	106,902	44,761	1,551,997
Detyrimet ndaj bankave	134,934	-	148	-	135,082
Borxhi i varur	80	-	-	10,000	10,080
Detyrimet e tjera financiare jo-derivative	-	-	42,457	-	42,457
Detyrimet e tjera financiare derivative	-	-	59	-	59
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,485,908</b>	<b>49,440</b>	<b>149,566</b>	<b>54,761</b>	<b>1,739,675</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2025</b>	<b>(1,086,872)</b>	<b>(26,557)</b>	<b>183,658</b>	<b>1,061,977</b>	<b>132,205</b>

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Totali
<b>Asetet</b>					
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	183,645	-	-	-	183,645
Detyrimet nga bankat	9,491	-	-	-	9,491
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	26,413	30,688	200,698	814,644	1,072,443
Investimet ne letra me vlerë	-	67,011	93,851	84,722	245,584
Pasuritë e tjera	-	-	5,787	-	5,787
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>219,549</b>	<b>97,699</b>	<b>300,336</b>	<b>899,366</b>	<b>1,516,950</b>
<b>Detyrimet</b>					
Depozitat nga klientët	1,281,295	740	3,928	43,101	1,329,064
Detyrimet ndaj bankave	10,854	-	1,016	-	11,870
Borxhi i varur	94	-	-	10,000	10,094
Detyrimet e tjera financiare jo-derivative	-	-	62,436	-	62,436
Detyrimet e tjera financiare derivative	-	-	27	-	27
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,292,243</b>	<b>740</b>	<b>67,407</b>	<b>53,101</b>	<b>1,413,491</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut neto më 31 dhjetor 2024</b>	<b>(1,072,694)</b>	<b>96,959</b>	<b>232,929</b>	<b>846,265</b>	<b>103,459</b>

Analiza e maturitetit të kredive për klientët bazohet në datat e mbetura të maturitetit të marrëveshjeve për kredi, që do të thotë duke marrë parasysh këstet që duhet paguar në baza mujore.

Raportimi i likuiditetit në baza javore në nivel të segmentit të biznesit, monitorimi i raportit të pandryshueshmërisë veçmas për të gjitha segmentet e biznesit, limitet në librin bankar dhe raportet të cilat matin rreziqet e interesit dhe hendeqet, janë aktualisht mjetet të cilat aplikohen për të menaxhuar dhe kufizuar rrezikun themelor të bërjes së biznesit.

Rezervat e detyrueshme të likuiditetit përfshihen brenda produkteve të paafatizuara dhe atyre më pak se një muaj, pasi në këtë kategori përfshihen edhe pjesa më e madhe e detyrimeve me të cilat lidhet ky bilanc.

Analiza e maturitetit për detyrimet financiare analizohet si më poshtë:

- Bazuar në datën më të hershme kontraktuale të maturitetit – skenari i rastit më të keq;
- Bazuar në flukset monetare të paskontuara kontraktuale;
- Përcaktimi i intervaleve kohore;
- Flukset e pritshme të parasë së gatshme përdoren si informacione plotësuese.

Përputhja dhe/ose mospërputhja e kontrolluar e maturiteteve dhe normave të interesit të aktiveve dhe detyrimeve është thelbësore për menaxhimin e Bankës. Është e pazakontë që bankat të jenë plotësisht në përputhje meqenëse biznesi i kryer është shpesh i një afati të pasigurt dhe i llojeve të ndryshme. Një pozicion i papërputhur rrit potencialisht përfitimin, por gjithashtu mund të rrisë rrezikun e humbjeve. Maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve dhe aftësia për të zëvendësuar detyrimet me interes ndërsa ato maturojnë me një kosto të pranueshme janë faktorë të rëndësishëm në vlerësimin e likuiditetit të Bankës dhe ekspozimit të saj ndaj ndryshimeve në interesin dhe kursin e këmbimit.

Banka ka një mospërputhje të konsiderueshme të maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve që maturojnë brenda një viti. Kjo mospërputhje e likuiditetit lind për faktin se burimi kryesor i financimit të Bankës më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 ishin llogaritë e klientëve të paafatizuara dhe që maturoheshin në më pak se një muaj. Menaxhmenti beson se përkundër se një pjesë e konsiderueshme e llogarive të klientëve janë të paafatizuara, diversifikimi i këtyre depozitave sipas numrit dhe llojit të depozituesve do të tregonte se llogaritë e këtyre klientëve ofrojnë një burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm financimi për Bankën.

Banka e ka përmirësuar pozicionin neto nëpërmjet burimeve të tjera të financimit, të cilat ofrojnë financa afatmesme dhe synojnë të vazhdojnë përputhjen e maturitetit të aktiveve me detyrimet në periudhat në vijim. Gjithashtu, Banka ka një Marrëveshje të papërdorur për Instrumente Kreditore, e cila do të ofrojë mbështetje në rast nevojash për likuiditet. Shuma totale e papaguar kontraktuale e zotimeve për dhënie e kredisë nuk përfaqëson domosdoshmërisht kërkesat e ardhshme të parave të gatshme, pasi që shumë prej këtyre zotimeve do të skadojnë ose ndërpriten pa u financuar.

#### 4.4. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që vlera e një investimi të ulet për shkak të lëvizjeve të faktorëve të tregut. Katër faktorët standardë të rrezikut të tregut janë:

- Rreziku i kapitalit ose rreziku që çmimet e stoqeve do të ndryshojnë.
- Rreziku i normës së interesit ose rreziku që normat e interesit do të ndryshojnë.
- Rreziku valutor ose rreziku që kurset e këmbimit të valutës së huaj do të ndryshojnë.
- Rreziku i mallrave ose rreziku që çmimet e mallrave (p.sh., drithërat, metalet, etj.) do të ndryshojnë.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj rreziqeve të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në normat e interesit dhe produktet valutore, të cilat të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Menaxhmenti vendos kufizime mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të mëdha domethënëse të tregut.

#### Rreziku gjeografik

Përqendrimi gjeografik i aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 është paraqitur më poshtë:

	Kosovë	BE	Të tjera	Totali
<b>Pasuritë</b>				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	210,276	44,225	-	254,501
Detyrimet nga bankat	-	49,199	-	49,199
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	1,235,309	-	7,523	1,242,832
Investimet në letrat me vlerë	43,015	259,648	19,723	322,386
Pasuritë e tjera	2,962	-	-	2,962
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>1,491,562</b>	<b>353,072</b>	<b>27,246</b>	<b>1,871,880</b>
<b>Detyrimet</b>				
Depozitat nga klientët	1,505,759	19,767	26,471	1,551,997
Depozitat nga bankat	148	134,934	-	135,082
Borxhi i varur	-	10,080	-	10,080
Detyrimet e tjera	20,857	21,600	59	42,516
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,526,764</b>	<b>186,381</b>	<b>26,530</b>	<b>1,739,675</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2025</b>	<b>(35,202)</b>	<b>166,691</b>	<b>716</b>	<b>132,205</b>

	Kosovë	BE	Të tjera	Totali
<b>Pasuritë</b>				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	183,019	626	-	183,645
Detyrimet nga bankat	-	9,491	-	9,491
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	1,060,527	-	11,916	1,072,443
Investimet në letrat me vlerë	32,237	156,394	56,953	245,584
Asete të tjera	5,787	-	-	5,787
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>1,281,570</b>	<b>166,511</b>	<b>68,869</b>	<b>1,516,950</b>
<b>Detyrimet</b>				
Depozitat nga klientët	1,285,205	17,491	26,368	1,329,064
Depozitat nga bankat	10,239	1,631	-	11,870
Borxhi i varur	-	10,094	-	10,094
Detyrimet e tjera	42,836	19,600	27	62,463
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,338,280</b>	<b>48,816</b>	<b>26,395</b>	<b>1,413,491</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2024</b>	<b>(56,710)</b>	<b>117,695</b>	<b>42,474</b>	<b>103,459</b>

## Rreziku valutor

Ky është një formë rreziku që lind nga ndryshimi i çmimit të një valute kundrejt valutës funksionale. Rreziku valutor menaxhohet nëpërmjet monitorimit dhe menaxhimit të pozicioneve të hapura valutore FX. Këto pozicione caktohen për pozicionet ditore dhe veçmas, për pozicionet gjatë natës. Analiza e ndjeshmërisë i ofrohet menaxhmentit në baza javore.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në kurset mbizotëruese të këmbimit në valutë të huaj në pozicionin e saj financiar dhe flukset e parasë së gatshme. Menaxhmenti përcakton kufizime në nivelin e ekspozimit sipas valutës dhe në total, si dhe kufijtë e ndalimit të humbjeve, të cilat monitorohen në baza ditore dhe mbulohen në përputhje me rrethanat duke futur pozicione kompensuese. Përdorimi i euros në Kosovë i mundëson bankës të hyjë në derivativë me likuiditet të lartë, siç janë SWAP-et ndër-valutore, që do të përdoren si mjete mbrojtëse ndaj devijimeve afatshkurtra të likuiditetit.

Raporti i rrezikut të tregut që përfshin Raportin e rrezikut të normës së interesit dhe raportin e valutës së hapur FX i dërgohet menaxhmentit në baza javore. Raporti përkatës prodhohet nga menaxhmenti i rrezikut i RBI bazuar në inputet që ofrohen nga burimet e raportimit vendor.

Tabela më poshtë përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit valutor më 31 dhjetor 2025 dhe 2024. Të përfshira në tabelë janë aktivet dhe detyrimet financiare të Bankës në vlera kontabël, të kategorizuara sipas valutës dhe të konvertuara në '000 euro.

	Euro	USD	Të tjera	Totali
<b>Pasuritë</b>				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	240,907	9,534	4,060	254,501
Detyrimet nga bankat	43,679	3,112	2,408	49,199
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	1,242,832	-	-	1,242,832
Investimet në letrat me vlerë	268,585	53,801	-	322,386
Pasuritë e tjera	2,962	-	-	2,962
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>1,798,965</b>	<b>66,447</b>	<b>6,468</b>	<b>1,871,880</b>
<b>Detyrimet</b>				
Depozitat nga klientët	1,474,023	65,766	12,208	1,551,997
Depozitat nga bankat	135,065	17-	-	135,082
Borxhi i varur	10,080	-	-	10,080
Detyrimet e tjera	42,516	-	-	42,516
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,661,684</b>	<b>65,783</b>	<b>12,208</b>	<b>1,739,675</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2025</b>	<b>137,281</b>	<b>664</b>	<b>(5,740)</b>	<b>132,205</b>
	Euro	USD	Other	Total
<b>Pasuritë</b>				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	146,020	5,923	31,702	183,645
Detyrimet nga bankat	3,502	3,569	2,420	9,491
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	1,072,443	-	-	1,072,443
Investimet në letrat me vlerë	188,631	56,953	-	245,584
Pasuritë e tjera	5,787	-	-	5,787
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>1,416,383</b>	<b>66,445</b>	<b>34,122</b>	<b>1,516,950</b>
<b>Detyrimet</b>				
Depozitat nga klientët	1,203,111	68,701	57,252	1,329,064
Depozitat nga bankat	11,870	-	-	11,870
Borxhi i varur	10,094	-	-	10,094
Detyrimet e tjera	62,463	-	-	62,463
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,287,538</b>	<b>68,701</b>	<b>57,252</b>	<b>1,413,491</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2024</b>	<b>128,845</b>	<b>(2,256)</b>	<b>(23,130)</b>	<b>103,459</b>

### Rreziku i valutës së huaj

Valutat e huaja ndaj të cilave Banka është kryesisht e ekspozuar janë dollari Amerikan (USD), frangu Zviceran (CHF) dhe funta Britanike (GBP). Kufiri për pozicionin agregat të hapur të valutës së huaj mirëmbahet brenda kërkesave rregullatore. Kjo zvogëlon ekspozimin ndaj rrezikut ndaj çdo luhatjeje në treg dhe minimizon ndikimin e mundshëm të rivlerësimit të valutës së huaj FX në fitimin dhe humbjen e bankës.

Kurset për valutat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave në datën e raportimit, të shprehura në valuta të huaja, ishin si më poshtë (në euro):

Krahasuar me EUR	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
1 USD	1.175005	1.103890
1 CHF	0.9314	0.941
1 GBP	0.872605	0.82918

### Rreziku i normës së interesit

Ky është rreziku që vlera relative e një aktivi me interes do të humbasë në vlerë. Duke qenë se aktivet janë kryesisht në kredi fikse afatmesme dhe afatgjata dhe detyrimet janë kryesisht depozita afatshkurtra, kjo gjë e ekspozon Bankën ndaj një mospërputhjeje në normat e interesit dhe rrjedhimisht hendeqet përkatëse e ekspozojnë Bankën ndaj lëvizjeve të normave të interesit në treg.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe rrjedhat e parasë. Margjinat e interesit mund të rriten si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të zvogëlohen ose krijojnë humbje në rast se linden lëvizje të papritura.

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit, kryesisht si rezultat i kredihënies me norma fikse të interesit, me shuma dhe për periudha, të cilat ndryshojnë nga ato të depozitave me afat me norma fikse interesi. Në praktikë, normat e interesit janë përgjithësisht fikse në një bazë afatshkurtër. Menaxhmenti vendos kufizime në nivelin e mospërputhjes së normës së interesit për ndryshim të çmimit që mund të ndërmerret. Sipas kontratave të shkëmbimit të normës së interesit, Banka bie dakord të këmbëjë diferencën midis shumës fikse dhe asaj të ndryshueshme të interesit të llogaritur mbi shumën nocionale të kryegjësë të dakorduara. Paraja në dorë dhe bilanci në BQK-në në të cilat nuk paguhet interes përfshihen në kolonën "pa interes" në tabelën e mëposhtme si dhe depozitat pa interes të klientëve.

Për t'u mbrojtur për hendeqet ndërmjet kredive fikse afatmesme dhe afatgjata kundrejt borxhit variabël afatshkurtër dhe afatmesëm, përdoret instrumenti derivativ financiar i quajtur shkëmbim (SWAP) i normës së interesit, ku Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C SH.A është kryesisht paguese e anës së interesit fiks, ndërsa pala tjetër është paguese e normës së ndryshueshme dhe ana e ndryshueshme është e indeksuar me EURIBOR 6 mujor, për të siguruar ndjeshmëri optimale.

Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C SH.A aplikon menaxhimin aktiv të rrezikut për t'u mbrojtur nga pozicionet e rrezikut të tregut. Rreziku i normës së interesit është i mbrojtur pjesërisht përmes derivativëve financiarë. Për të siguruar stabilitet afatgjatë në fluksin e parasë nga portofolet ekzistuese të kredive, që maturojnë nga viti 2028 deri në vitin 2029, këto pozicione janë të mbrojtura përmes SWAP-eve të Normave të Interesit.

SWAP-et e normave të interesit llogariten si derivatë të librit bankar pa kontabilitet mbrojtës. SWAP-et e normave të interesit maten me vlerën e tregut në çdo datë raportimi dhe çdo ndryshim i cili rezulton nga kjo njihet në fitim dhe humbje të vitit. Pozicionet maten duke përdorur metodën e vlerës së pikës bazë.

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj rreziqeve të normës së interesit. Në përfshira në tabelë janë aktivet dhe detyrimet financiare të Bankës me vlera kontabël, të kategorizuara sipas datës së rëçimit kontraktual ose datës së maturimit, cilado që është më e hershme.

	Sipas kërkesës dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Totali
<b>Pasuritë</b>						
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	254,501	-	-	-	-	254,501
Detyrimet nga bankat	49,199	-	-	-	-	49,199
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	21,469	22,883	222,025	976,455	-	1,242,832
Investimet në letrat me vlerë	73,867	-	108,236	140,283	-	322,386
Pasuritë e tjera	-	-	-	-	2,962	2,962
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>399,036</b>	<b>22,883</b>	<b>330,261</b>	<b>1,116,738</b>	<b>2,962</b>	<b>1,871,880</b>
<b>Detyrimet</b>						
Depozitat nga klientët	92,664	49,440	106,902	44,761	1,258,230	1,551,997
Depozitat nga bankat	134,786	-	148	-	148	135,082
Borxhi i varur	80	-	-	10,000	-	10,080
Detyrimet e tjera	-	-	-	-	42,516	42,516
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>227,530</b>	<b>49,440</b>	<b>107,050</b>	<b>54,761</b>	<b>1,300,894</b>	<b>1,739,675</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2025</b>	<b>171,506</b>	<b>(26,557)</b>	<b>223,211</b>	<b>1,061,977</b>	<b>(1,297,932)</b>	<b>132,205</b>

Depozitat pa interes në shumën prej 1,258,230 mijë euro janë kryesisht llogari rrjedhëse të bizneseve dhe individëve. Ato nuk kanë ndonjë datë kontraktuale të rëçimit ose maturimit, megjithatë normat e interesit do të përgjigjeshin në një kohë të shkurtër në përgjigje të ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

	Sipas kërkesës dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Totali
<b>Pasuritë</b>						
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	183,645	-	-	-	-	183,645
Detyrimet nga bankat	9,491	-	-	-	-	9,491
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	26,413	30,688	200,698	814,644	-	1,072,443
Investimet në letrat me vlerë	-	67,011	93,851	84,722	-	245,584
Pasuritë e tjera	-	-	-	-	5,787	5,787
<b>Totali i asetëve financiare</b>	<b>219,549</b>	<b>97,699</b>	<b>294,549</b>	<b>899,366</b>	<b>5,787</b>	<b>1,516,950</b>
<b>Detyrimet</b>						
Depozitat nga klientët	122,761	740	3,928	43,101	1,158,534	1,329,064
Depozitat nga bankat	9,838	-	1,016	-	1,016	11,870
Borxhi i varur	94	-	-	10,000	-	10,094
Detyrimet e tjera	-	-	-	-	62,463	62,463
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>132,693</b>	<b>740</b>	<b>4,944</b>	<b>53,101</b>	<b>1,222,013</b>	<b>1,413,491</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2024</b>	<b>86,856</b>	<b>96,959</b>	<b>289,605</b>	<b>846,265</b>	<b>(1,216,226)</b>	<b>103,459</b>

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj normave të ndryshueshme të interesit (EURIBOR). Të përfshira në tabelë janë aktivet dhe detyrimet financiare të Bankës me vlera kontabël, të kategorizuara sipas datës së riçimit kontraktual ose datës së maturimit, cilado që është më e hershme.

	Sipas kërkesës dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Totali
<b>Pasuritë</b>					
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	-	-	-	-	-
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	763	375	4,081	32,850	38,069
Investimet në letrat me vlerë	-	-	-	-	-
Pasuritë e tjera	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>763</b>	<b>375</b>	<b>4,081</b>	<b>32,850</b>	<b>38,069</b>
<b>Detyrimet</b>					
Depozitat nga klientët	-	-	-	-	-
Depozitat nga bankat	-	-	-	-	-
Borxhi i varur	-	-	-	-	-
Detyrimet e tjera	-	-	-	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2025</b>	<b>763</b>	<b>375</b>	<b>4,081</b>	<b>32,850</b>	<b>38,069</b>

	Sipas kërkesës dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Totali
<b>Pasuritë</b>					
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	-	-	-	-	-
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	12,552	597	7,576	53,911	74,636
Investimet në letrat me vlerë	-	-	-	-	-
Pasuritë e tjera	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>12,552</b>	<b>597</b>	<b>7,576</b>	<b>53,911</b>	<b>74,636</b>
<b>Detyrimet</b>					
Depozitat nga klientët	-	-	-	-	-
Depozitat nga bankat	-	-	-	-	-
Borxhi i varur	-	-	-	-	-
Detyrimet e tjera	-	-	-	-	-
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2024</b>	<b>12,552</b>	<b>597</b>	<b>7,576</b>	<b>53,911</b>	<b>74,636</b>

**Strategjia e Menaxhimit të Rrezikut:** Banka përdor SWAP-et e normave të interesit (IRS) për të mbrojtur ekspozimin e saj ndaj ndryshimeve në normat e interesit për kreditë e saj me norma të ndryshueshme. Objektivi është të menaxhohet rreziku i normës së interesit duke konvertuar aktivet me normë të ndryshueshme në aktive me normë fikse.

#### Instrumentet mbrojtëse:

ALM e Bankës monitoron vazhdimisht pozicionin e IR dhe mbron pozicionin e IR nga derivativët e IRS në lidhje me oreksin për rrezik, mundësitë e tregut dhe në përputhje me strategjinë e menaxhimit të rrezikut. Portofoli i SWAP-eve IR të marrësve neto është i denominuar në EUR. Do të thotë që SWAP-et e marrësve do të mbizotërojnë në portofol. Megjithatë, mund të ketë gjithashtu një kombinim të SWAP-eve të marrësit dhe paguesit që shihen të kombinuara dhe të përcaktuara së bashku si instrument mbrojtës. (SNK 39.77)

- Banka ka hyrë në SWAP-e normash interesi me një shumë nominale prej 10 milionë eurosh.
- Vlera e drejtë (vlera e drejtë pozitive) e SWAP-eve të normave të interesit në datën e raportimit është 3 mijë euro.
- SWAP-et përfshihen në zërin "instrumente financiare derivative" në pasqyrën e pozicionit financiar dhe përfshihen në shënimin 17.

#### Zërat e mbrojtur:

Zëri i mbrojtur në çdo marrëdhënie përcaktohet si një pjesë e portofolit të aktiveve me normë të ndryshueshme në valutën EUR. Vëllimi kryesor themelor formohet nga kreditë e korporatave me normë të ndryshueshme, kreditë rotulluese të korporatës me probabilitet të lartë rikthimi (financimi i kapitalit qarkullues), hipotekat me normë të ndryshueshme dhe kreditë e NVM-ve, si dhe shtesat e detyrueshme të likuiditetit (buffers) të thesarit me një periudhë afatshkurtër të rishikimit.

Shuma e zërit të mbrojtur brenda çdo brezi kohor përcaktohet si një pjesë e portofolit të kredisë së korporatës e zgjedhur sipas kriterëve të përcaktuara më poshtë. Pjesa është vendosur në mënyrë që vëllimi i zërit të mbrojtur të korrespondojë me vëllimin e instrumentit mbrojtës të lidhur me të njëjtën normë referimi. Kërkesë shtesë është që kreditë e zhvlerësuar të mos përfshihen në portofolin e zërave të mbrojtur.

Kreditë janë caktuar në breza specifike kohore bazuar në datat e tyre të rikthimit kontraktual. Rrjedhimisht, ato ndajnë të njëjtin rrezik: ekspozimi i fluksit monetar ndaj ndryshimeve në kurbën e kthimit 'yield' të SWAP-it, d.m.th. ndryshimet në normat e EURIBOR në lidhje me marrëdhënien. Kreditë do të kenë vetëm 6M EURIBOR, megjithatë në një shumë të kufizuar gjithashtu edhe kreditë dhe aktivet e tjera me afate të ndryshme rikthimi mund të përfshihen në portofol, gjë që do të pasqyrohet siç duhet në llogaritjen e efijencës së marrëdhënies mbrojtëse. Përqindja e kredive të mbrojtura natyrshëm dhe të mbrojtura nga derivativët ndryshon vazhdimisht ndërsa bilanci i bankës evoluon. Si zëri i mbrojtur ashtu edhe instrumenti mbrojtës janë portofolë të gjallë. Në terma të SNRF-ve, situata mund të interpretohet si një rregullim i instrumentit mbrojtës që pasqyron ndryshimin në pozicionin e mbrojtur. Megjithatë, dinamika e mbrojtjes së flukseve monetare pritet të jetë e ulët dhe monitorohet vazhdimisht nga Thesari.

#### Efektiviteti dhe joefektiviteti i mbrojtjes:

- Banka përdor metodën 'euro-offset' për të vlerësuar efektivitetin e mbrojtjes.
- Pjesa efektive e vlerësimit regjistrohet në OCI, ndërsa pjesa joefektive regjistrohet në PL.
- Që nga periudha e raportimit, efektiviteti i mbrojtjes ka qenë brenda niveleve të pranueshme të mbrojtjes pa u njohur asnjë rezultat në PL.

#### Ndikimi në pasqyrat financiare:

- Ndryshimi në vlerën e drejtë të instrumenteve mbrojtëse të njohura në OCI është (5) mijë euro. Asnjë regjistrim nuk është bërë në PL gjatë vitit 2025.

Ndryshimi në vlerën e drejtë të instrumenteve mbrojtëse të njohura në OCI është (5) mijë euro. Asnjë regjistrim nuk është bërë në PL gjatë vitit 2025.

Në përqindje	2025				2024			
	Euro	USD	CHF	GBP	Euro	USD	CHF	GBP
<b>Pasuritë</b>								
<b>Tarifat e shërbimit të llogarisë</b>	<p>Tarifat për menaxhimin e vazhdueshëm të llogarisë i ngarkohen llogarisë së klientit në baza mujore. Banka përcakton normat veçmas për klientët bankar retail dhe korporata në çdo juridiksion në baza vjetore.</p> <p>'Të Ardhurat e Shtyra', siç përfshihen nën 'Detyrimet e Tjera' në pasqyrën e pozicionit financiar, përfaqësojnë detyrimin e Bankës për të transferuar shërbimet tek një klient në lidhje me mirëmbajtjen e produkteve të mbitërheqjes për të cilat Banka ka marrë shumë (apo një shumë është e detyrueshme) nga klienti. Një detyrim për tarifat dhe komisionet e pafituara njihet kur pagesa është bërë ose pagesa duhet të bëhet (cilado që të jetë më e hershme). Tarifat dhe komisionet e pafituara njihen si të ardhura kur (ose tekta) Banka performon.</p>
<b>Tarifat e transferimit të pagesave</b>	<p>Banka ofron shërbime të transferimit të pagesave për klientët e saj retail dhe korporata, duke përfshirë shlyerjen e pagesave kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Banka përcakton normat veçmas për klientët bankar retail dhe korporata të paktën në baza vjetore.</p> <p>Tarifat e bazuara në transaksione për shërbimet e transferimit të pagesave ngarkohen në llogarinë e klientit kur kryhet transaksioni.</p>

## 24. FITIME OSE (-) HUMBJET NGA AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE

	2025	2024
Fitimet ose humbjet nga derivativët e mbrojtjes ekonomike (derivativët BB)	19	347
Fitimet ose humbjet nga aktivet financiare jo-tregtare, në mënyrë të detyrueshme me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	123	444
Diferencat e këmbimit (fitim ose humbje)	84	242
<b>Fitimet ose humbjet totale nga aktivet dhe detyrimet financiare</b>	<b>226</b>	<b>1,033</b>

## 25. TË ARDHURAT E TJERA OPERATIVE

	2025	2024
Të ardhurat e Qendrës së Kompetencës	-	2,928
Biznesi në valutë të huaj (të ardhura nga tregtimi)	2,245	2,527
Fitimi nga shitja e aktiveve(aseteve) të sekuestruara	72	69
Fitimi nga shitja e aktiveve fikse	58	181
Të ardhura të tjera operative	2,989	3,137
Tarifat e shërbimit të tranzitit të parave të gatshme	2	18
<b>Totali i të ardhurave të tjera operative</b>	<b>5,366</b>	<b>8,860</b>

Të ardhurat nga Qendra e Kompetencës përfshijnë të ardhurat nga departamenti i bankës i cili ofron shërbime të TI-së për Raiffeisen Bank International AG me seli qendrore në Vjenë, Austri. Të ardhurat për shërbimet njihen si të ardhura nga banka në periudhën kur është kryer shërbimi. Faturimi bëhet për të gjitha shërbimet e kryera gjatë periudhës raportuese dhe çdo shumë e detyrueshme në fund të vitit përfshihet në llogarinë e të arkëtueshmeve të tjera të shpalosura nën aktivet e tjera si të arkëtueshme nga kompania mëmë. Nuk ka detyrime kontraktuale që janë faturuar dhe të paliferuara në fund të vitit. Duke filluar nga 1 korriku 2024, aktivet që lidhen me Qendrën e Kompetencës u transferuan tek Raiffeisen Tech Kosovo LLC dhe departamenti zyrtarisht u mbyll. Prandaj, nuk ka të ardhura ose bilance përkatëse të Qendrës së Kompetencës në vitin 2025.

## 26. SHPENZIMET E PERSONELIT

	2025	2024
Pagat dhe mëditjet	19,796	19,191
Kontributet pensionale	1,006	907
Shpenzime të tjera sociale vullnetare	1,491	1,867
<b>Shpenzimet totale të personelit</b>	<b>22,293</b>	<b>21,965</b>

Menaxhmenti i Raiffeisen International, duke pasur parasysh performancën e individëve dhe trendet e tregut, përcakton shpërbëimin e drejtorëve dhe drejtuesve kryesorë. Shpenzimet që lidhen me Bordin Menaxhues për vitin 2025 arritën shumën 891 mijë euro (2024: 792 mijë euro).

## 27. AMORTIZIMI DHE ZHVLERËSIMI

	2025	2024
Zhvlerësimi i aktiveve të prekshe	2,936	2,801
Zhvlerësimi për ROU	767	766
<b>Zhvlerësimi total i pronave dhe pajisjeve</b>	<b>3,703</b>	<b>3,567</b>
	2025	2024
<b>Amortizimi i aktiveve jomateriale</b>	<b>4,266</b>	<b>3,218</b>

## 28. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

	2025	2024
Kostoja e TI-së	5,642	5,384
Shpenzime ligjore, këshilluese dhe konsultuese	3,026	3,522
Tarifat e sigurimit të depozitave	3,394	2,058
Shpenzimet e hapësirës së zyrës (qira, mirëmbajtje, të tjera)	1,515	1,315
Shpenzimet e reklamimit, PR-it dhe promovimit	2,088	2,741
Shpenzimet e sigurimit	1,436	1,358
Shpenzimet për kontestet gjyqësore	-	(4)
Shpenzimet e tjera administrative	369	480
Shpenzimet për trajnimin e stafit	230	253
Shpenzimet e komunikimit	185	380
Furnizimet e zyrës	148	253
Shpenzimet e veturave	238	274
Shpenzimet e udhëtimit	272	496
<b>Totali i shpenzimeve të tjera operative</b>	<b>18,543</b>	<b>18,510</b>

### 28.1 Tarifat e auditimit

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025 dhe 2024, tarifat e kontraktuara për shërbimet e auditimit ishin si më poshtë:

	2025	2024
Tarifat e auditimit për raportimin ligjor	49	49
Tarifat e tjera që lidhen me auditimin për qëllime të grupit	28	28
Raporti i rishikimit për qëllime rregullatore	11	10
Tarifat e tjera që lidhen me NAS të lejueshme	10	10
<b>Gjithsej</b>	<b>98</b>	<b>97</b>

## 29. SHPENZIMET E TATIMIT MBI TË ARDHURAT

Norma e tatimit mbi të ardhurat që zbatohet për të ardhurat e Bankës është 10 përqind (31 dhjetor 2024: 10 përqind). Barazimi ndërmjet shpenzimit tatimor të pritur dhe atij faktit është dhënë më poshtë.

	2025	2024
Shpenzimet aktuale tatimore	3,848	5,495
Tatimi i shtyrë	(401)	(347)
<b>Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat për vitin</b>	<b>3,447</b>	<b>5,148</b>
<b>Fitimi para taksimit</b>	<b>34,768</b>	<b>44,313</b>
Shpenzimet tatimore për vitin me normën e zbatueshme ligjore	10% 3,477	10% 4,431
Efkti tatimor i zërave që nuk janë të zbritshëm për qëllime tatimore dhe ndryshimet e tjera rregullatore	1.07% 371	2.40% 1,064
<b>Shpenzimet aktual tatimore (norma efektive e tatimit mbi të ardhurat)</b>	<b>11.07% 3,848</b>	<b>12.40% 5,495</b>

Ndryshimet ndërmjet pasqyrave financiare sipas SNRF-ve dhe rregulloreve ligjore tatimore të Kosovës shkaktojnë disa ndryshime të përkohshme midis vlerës kontabël të disa aktiveve dhe detyrimeve të caktuara për qëllime të raportimit financiar dhe për qëllime të tatimit mbi fitimin. Efekti tatimor i lëvizjes në këto ndryshime të përkohshme regjistrohet me masën 10 përqind. Diferencat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

	2024	Lëvizja 2024	2025
<b>Efekti tatimor i ndryshimeve të përkohshme të zbritshme</b>			
Dispozita të tjera ligjore	-	-	-
Depozita afatgjata – interesi i grumbulluar	-	(324)	(324)
Pronat, pajisje dhe asete të paprekshme	-	(25)	(25)
Shpenzimet e Stafit	(286)	21	(265)
<b>Aktiv i tatimor i shtyrë bruto</b>	<b>(286)</b>	<b>(328)</b>	<b>(614)</b>
<b>Efekti tatimor i ndryshimeve të përkohshme të tatueshme</b>			
Provizioni për ekspozimin kreditor jashtë bilancit	-	-	-
Pronat, pajisjet dhe aktivet jomateriale	73	(73)	-
Të pagueshme të tjera për stafin	-	-	-
<b>Totali i detyrimit tatimor të shtyrë</b>	<b>73</b>	<b>(73)</b>	<b>-</b>
<b>Totali i tatimit (aktivit) / detyrimit të shtyrë neto</b>	<b>(213)</b>	<b>(401)</b>	<b>(614)</b>
	2023	Lëvizja 2024	2024
<b>Efekti tatimor i ndryshimeve të përkohshme të zbritshme</b>			
Pronat, pajisjet dhe aktivet jomateriale	(12)	12	-
Depozitat me afat – interesi i përlogaritur	(48)	(238)	(286)
Provizione të tjera ligjore	(60)	(226)	(286)
<b>Aktiv i tatimor i shtyrë bruto</b>			
<b>Efekti tatimor i ndryshimeve të përkohshme të tatueshme</b>			
Provizioni për ekspozimin kreditor jashtë bilancit	-	-	-
Prona, pajisje dhe asete të paprekshme	193	(120)	73
Të pagueshmet të tjera për stafin	-	-	-
<b>Totali i detyrimit tatimor të shtyrë</b>	<b>193</b>	<b>(120)</b>	<b>73</b>
<b>Totali i detyrimit tatimor të shtyrë neto</b>	<b>133</b>	<b>(346)</b>	<b>(213)</b>

Tatimi që lidhet me zërat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse paraqet shumën e tatimit në lidhje me të ardhurat nga investimet financiare përmes OCI. Tabela e mëposhtme paraqet shumën e tatimit mbi të ardhurat në lidhje me të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për vitin 2025 dhe 2024:

	2025	2024
<b>Tatimi mbi të ardhurat nga investimet financiare përmes OCI-së</b>	<b>223</b>	<b>(58)</b>

## 30. KONTIGJENCAT DHE ZOTIMET

### Procedurat ligjore dhe gjobot e tjera rregullatore

Herë pas here dhe në rrjedhën normale të biznesit, pranohen pretendime kundër Bankës . Më 31 dhjetor 2025, Banka kishte një sërë çështjesh ligjore në pritje të zgjidhjes në gjykatë. Mbi bazën e gjykimit e brendshëm që mbështetet në vendimet e mëparshme gjyqësore dhe vendimet e Menaxhmentit, Banka ka krijuar një provizion total prej 107 mijë eurosh (2024: 107 mijë euro) si përlogaritja më e afërt i daljeve të mundshme të parasë që rrjedhin nga vendimet e mundshme gjyqësore dhe gjobot.

### Zotimet kapitale

Më 31 dhjetor 2025, Banka nuk asnjë zotim kapitale që lidhet me blerjen e pajisjeve dhe softuerëve (31 dhjetor 2024: zero).

### Zotimet lidhur me kredinë

Qëllimi parësor i këtyre instrumenteve është të sigurojnë që fondet të jenë në dispozicion të një klienti sipas nevojës. Garancitë dhe letrat e kredisë në pritje, të cilat përfaqësojnë garanci të pakthyeshme se Banka do të kryejë pagesa nëse një klient nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj palëve të treta, mbartin të njëjtin rrezik kreditor si kreditë. Letrat e kreditit dokumentare dhe komerciale, të cilat janë zotime të shkruara nga Banka në emër të një klienti që autorizon një palë të tretë që të tërheqë draftte nga Banka deri në një shumë të caktuar sipas termave dhe kushteve specifike, janë të kolateralizuara nga dërgesat bazë të mallrave me të cilat ato lidhen ose depozitat në para, dhe për këtë arsye mbartin më pak rrezik sesa një huamarrje e drejtpërdrejtë. Përveç rasteve kur këto zotime nuk shtrihen përtej periudhës që pritet të nevojshme për të kryer lejimin/nënshkrimin e duhur, ato konsiderohen të jenë transaksione "të rregullta".

Zotimet e papaguara që lidhen me kredinë janë si më poshtë:

	2025	2024
Zotimet për të dhënë kredi	62,831	55,074
Garancitë (instrument kreditor)	39,843	40,540
Garancitë (të mbuluara me para)	5,172	5,230
Letër krediti (instrument kreditor)	2,926	3,644
Letër krediti (mbulim me para në dorë)	-	-
Linja e kredisë për financimin tregtar	5,809	7,081
Letër krediti në pritje	1,703	1,925
<b>Totali i zotimeve të lidhura me kredinë</b>	<b>118,284</b>	<b>113,494</b>
Provizioni për zotimet që lidhen me kredinë (Shënimi 18)	(131)	(422)
<b>Zotimet e lidhura me kredinë neto</b>	<b>118,153</b>	<b>113,072</b>

Zotimet për të dhënë kredi përfaqësojnë shumat e kredisë në të cilat është nënshkruar dokumentacioni i kredisë, por paratë nuk janë të disbursuar ende dhe shumat e papërdorura të limiteve të mbiterheqjes në lidhje me llogaritë e klientëve. Në lidhje me rrezikun kreditor për zotimet për dhënie e kredisë, Banka është potencialisht e ekspozuar ndaj humbjeve në një shumë të barabartë me totalin e zotimeve të papërdorura. Sidoqoftë, shumat e mundshme e humbjes është më e vogël se totali i zotimeve të papërdorura pasi që shumica e zotimeve për të dhënë kredi janë me kushtin që klientët të mirëmbajnë standardet specifike të kredisë. Banka monitoron afatin deri në maturim të zotimeve që lidhen me kredinë sepse zotimet afatgjata kanë në përgjithësi një shkallë më të madhe të rrezikut kreditor sesa zotimet afatshkurtra.

Shuma totale kontraktuale e papaguar e zotimeve për të dhënë kredi dhe garanci nuk përfaqëson domosdoshmërisht kërkesat e ardhshme për para të gatshme, pasi që këto instrumente financiare mund të skadojnë ose të përfundojnë pa u financuar.

Zotimet Tatimore: Në vitin 2025, banka mori raportin përfundimtar të inspektimit tatimor nga Administrata Tatimore për vitin fiskal 2016. Një ankesë është parashtruar kundër vendimit të Administratës Tatimore. Procesi është në zhvillim e sipër, por vendimi nuk pritet të ketë një ndikim material për bankën.

**Shkëmbimet (SWAP-et) e normave të Interesit.** Qëllimi kryesor i këtyre instrumenteve është që të zbusë rrezikun e normës së interesit që lidhet me kredidhënie me normë fikse. Më 31 dhjetor 2025, Banka ka tri kontrata SWAP të normave të interesit me një shumë nacionale prej 850 mijë eurove (2024: 850 mijë euro).

## 31. TRANSAKSIONET E PALËVE TË LIDHURA

Për qëllime të këtyre pasqyrave financiare, palët konsiderohen të ndërlidhura nëse njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, siç përcaktohet nga SNK 24 "Shpalosjet e Palëve të Lidhura". Gjatë shqyrtimit të çdo marrëdhënieje të mundshme me palë të lidhura, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies, jo thjesht formës ligjore.

Transaksionet bankare kryhen në rrjedhën normale të biznesit me aksionarë të rëndësishëm, drejtorë, kompani me të cilat Banka ka aksionarë të rëndësishëm të përbashkët dhe palë të tjera të lidhura. Këto transaksione përfshijnë shlyerjet, plasmanet, marrje të depozitave dhe transaksionet në valutë të huaj. Këto transaksione vlerësohen me norma të tregut, ku Banka zhvillon një analizë të TTP-së nga një ofruer i jashtëm i pavarur e cila konfirmon se kushtet e tilla janë vërtetuar. Bilancet e papaguara në fund të vitit dhe zërat e ndërlidhur me të ardhurat dhe shpenzimet përkatëse gjatë vitit me palët e lidhura janë si më poshtë:

	2025			2024		
	Amë	Filialet	Pala tjetër e lidhur	Amë	Filialet	Pala tjetër e lidhur
<b>Pasuritë</b>	<b>648</b>	<b>4,234</b>	<b>131</b>	<b>4,207</b>	<b>4,237</b>	<b>219</b>
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme	-	-	-	-	-	-
Detyrimet nga bankat	-	-	-	393	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	-	-	-	3	-
Derivativët – Kontabiliteti mbrojtës	25	-	-	3	-	-
Kredi të tjera	-	-	-	-	-	-
Aktive të tjera	335	-	-	3,302	-	-
Investimet në filiale	-	4,234	-	-	4,234	-
Prona, pajisjet dhe aktivet jomateriale – VKN	288	-	131	509	-	219
<b>Detyrimet</b>	<b>110,256</b>	<b>617</b>	<b>-</b>	<b>31,363</b>	<b>3,080</b>	<b>-</b>
Llogaritë e klientëve						
Detyrimet ndaj bankave	99,905	617	-	1,357	3,080	-
Borxhi i varur	10,080	-	-	10,094	-	-
Detyrimet e tjera	271	-	-	19,911	-	-

	2025			2024		
	Amë	Filialet	Pala tjetër e lidhur	Amë	Filialet	Pala tjetër e lidhur
Pasqyra e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	(6,274)	926	(2,262)	(1,883)	360	(1,781)
Të ardhurat nga interesi	-	11	-	-	7	-
Shpenzimet e interesit	(1,910)	-	(1)	(181)	-	(2)
Të ardhurat nga dividendi	-	660	-	-	341	-
Tarifat dhe komisionet neto	(1,011)	-	(2,100)	(658)	-	(1,449)
Instrumente financiare të mbajtura me vlerën e drejtë. Rezultati i vlerësimit neto	(59)	-	-	30	-	-
Ndryshimi neto në mbrojtjet e fluksit monetar	(5)	-	-	3,316	-	-
Të ardhurat e tjera operative	802	255	108	(4,738)	12	149
Shpenzimet e tjera operative	(4,091)	-	(269)	143	-	(480)
<b>Jashtë bilancit</b>	<b>143</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>143</b>	<b>2,002</b>	<b>-</b>
Garancitë	143	-	-	-	-	-
Letër krediti	-	-	-	-	-	-
Zotime të tjera	-	-	-	-	2,002	-

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpërblimet e menaxhmentit për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025 dhe 2024:

	2025	2024
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve	252	153

## 32. NGJARJET PASUESE

Banka është në proces të bashkimit ligjor të filialit të saj që është plotësisht në pronësi të saj, Raiffeisen Leasing Kosovo, për të integruar në tërësi operacionet e tyre brenda bankës. Ky bashkim do të konsolidojë të gjitha aktivet dhe detyrimet e Raiffeisen Leasing Kosovo në Bankë, pas së cilës gjë filiali do të pushojë së ekzistuari si një entitet i veçantë.

Banka aktualisht po harmonizon sistemet, procedurat dhe po siguron miratimet e nevojshme rregullatore dhe të kreditorëve. Një draft marrëveshjeje bashkimi është përgatitur, ndërsa marrëveshja përfundimtare pritet të nënshkruhet sapo të përfundohen përgatitjet.

Bashkimi parashihet të përfundojë në tremujorin e tretë të vitit 2026. Ky bashkim synon të përmirësojë operacionet dhe të rrisë efikasitetin, pa ndërprerje të pritshme për klientët apo kreditorët.

Për më tepër, që nga fillimi i konfliktit në Lindjen e Mesme, Banka ka monitoruar zhvillimet relevante ekonomike dhe ato të tregut. Përderisa situata mbetet e pasigurt, menaxhmenti aktualisht nuk pret një ndikim të ndjeshëm të menjëhershëm. Sidoqoftë, nëse konflikti përshkallëzohet ose vazhdon, supozimet dhe vlerësimet ka mundësi që duhet të rishikohen. Rrjedhimisht, këto ngjarje konsiderohen si faktorë të jashtëm dhe klasifikohen si ngjarje jo-rregulluese për periudhën raportuese. Për më tepër hollësi, referojuni Shënimit "Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve".

Nuk ka ngjarje pasuese shtesë pas përfundimit të periudhës raportuese të cilat kërkojnë rregullim ose shpallje në pasqyrat financiare të veçanta.

# RAPORTI I QËNDRUESHMËRISË

## 1. Pajtueshmëria me Standardet e Shpalosjes të Qëndrueshmërisë SNRF

Raporti i qëndrueshmërisë i bankës është përgatitur në përputhje me Standardet e Shpalosjes së Qëndrueshmërisë SNRF, të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Qëndrueshmërisë (ISSB). Përveç kësaj, gjatë përgatitjes së këtij raporti, janë referuar dhe janë marrë në konsideratë temat e shpalosjes në standardet e Bordit të Standardeve të Kontabilitetit të Qëndrueshmërisë (SASB).

### Lidhshmëria me pasqyrat financiare (periudha raportuese, njësia raportuese dhe valuta e prezantimit)

Raporti i qëndrueshmërisë është përgatitur për bankën dhe duhet të lexohet së bashku me pasqyrat financiare të bankës të përgatitura në përputhje me Standardet e Kontabilitetit sipas SNRF. Ai mbulon periudhën 12-mujore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025, e që është në përputhje me periudhën raportuese të pasqyrave financiare përkatëse.

## 2. Ndikimi Mjedisor dhe Përppjekjet e Qëndrueshmërisë (Fusha 1, 2 dhe 3)

### Hyrje

Banka njih rëndësinë kritike të qëndrueshmërisë në formësimin e një të ardhmeje prosperuese për komunitetet tona, klientët tanë dhe planetin. Si një bankë lidere, ne jemi të përkushtuar për integrimin e praktikave të qëndrueshme në çdo aspekt të operacioneve, produkteve dhe shërbimeve tona. Qasja jonë ndaj qëndrueshmërisë është e rrënjësor në besimin se bankat e përgjegjshme jo vetëm që mbështesin kujdesin mjedisor, por gjithashtu nxisin rritjen ekonomike afatgjate dhe mirëqenien sociale.

Banka ka krijuar Grupin Drejtues ESG përgjegjës për mbikëqyrje të rreziqeve dhe mundësive që lidhen me qëndrueshmërinë, duke përfshirë çështjet që lidhen me klimën. Takimet dhe raportimet tek Bordi bëhen çdo tremujor për të siguruar mbikëqyrje gjithëpërfshirëse dhe harmonizim strategjik. Veç kësaj, takime të rregullta mujore mbahen për secilën shtyllë të qëndrueshmërisë për të adresuar çështje dhe iniciativa specifike në kohë të duhur. Grupi Drejtues ESG është përgjegjës për udhëheqjen e strategjisë së qëndrueshmërisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të iniciativave të qëndrueshmërisë dhe për të siguruar harmonizimin me objektivat tona të përgjithshme të biznesit. Grupi Drejtues ESG raporton drejtpërdrejt tek Drejtori Ekzekutiv dhe anëtarët e tjerë të bordit, duke ofruar përditësime të rregullta në lidhje me progresin, sfidat dhe mundësitë që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë.

Si pjesë e angazhimit të bankës ndaj qëndrueshmërisë, më poshtë është paraqitur një pasqyrë e ndikimit mjedisor të bankës për vitin 2024 dhe 2025. Këto shpalosje janë pjesë e përppjekjeve të vazhdueshme të brendshme të bankës për të matur dhe menaxhuar gjurmën tonë të karbonit, duke përfshirë emetimet përkatëse të Fushës 1, Fushës 2 dhe Fushës 3. Ky raport përfshin matjet e kërkuara, objektivat për reduktimin e emetimeve dhe iniciativat që kemi zbatuar.

### 2.1. Emisionet nga Fushëveprimi 1 (Emisioni i drejtpërdrejt nga burimet në pronësi apo të kontrolluara)

Më poshtë janë paraqitur emisionet e CO<sub>2</sub> dhe reduktimi i emisioneve të CO<sub>2</sub> për vitet 2025 dhe 2024:

Viti	Lloji i automjetit	Konsumi i karburantit (L)	Faktori i Emetimit (kg CO <sub>2</sub> /L)	CO <sub>2</sub> total (kg)	CO <sub>2</sub> total (ton)
2024	Benzinë (7L/100km)	20,683.32 L	2.31	47,778.16	47.78
	Naftë (7L/100km)	5,350.87 L	2.68	14,358.34	14.36
	Hibrid (4L/100km)	40,534.04 L	2.31	93,633.38	93.63
	Gjithsej 2024	66,568.23 L		155,769.88	155.77
2025	Benzinë (7L/100km)	1,323.56L	2.31	3,057.42	3.06
	Naftë (7L/100km)	1,126.09L	2.68	3,017.92	3.02
	Hibrid (4L/100km)	37,334.3L	2.31	86,242.2	86.24
	Gjithsej 2025	39,783.95 L		92,317.54	92.32
<input checked="" type="checkbox"/> Reduktimi (%)				-63,452.34 kg	-63.45 ton
<input checked="" type="checkbox"/> Përqindja e Reduktimit				-40.73%	-40.73%

Viti 2025 raportohet duke përdorur metodologjinë e re, e cila do të zbatohet në të gjitha periudhat e ardhshme të raportimit. Sipas kësaj qasje, vetëm emetimet e CO<sub>2</sub> që lidhen me biznesin përfshihen në përputhje me Protokollin e GS-ve, ndërsa

përdorimi privat përjashtohet nga llogaritja. Deri në fund të vitit 2025, Banka përfundoi kalimin e flotës së saj të automjeteve në automjete hibride me 97%. Ky përmirësim strukturor pritet të mbështesë një reduktim të vazhdueshëm të emetimeve të CO<sub>2</sub> në vitet e ardhshme, duke forcuar më tej performancën mjedisore të aktiviteteve të transportit që ndërlihen me biznesin. Metodologjia e re nuk zbatohet për të dhënat e vitit 2024.

#### Llogaritja:

Emetimet e CO<sub>2</sub> për automjetet u llogaritën duke konvertuar kilometrazhin total në konsum të karburantit, në bazë të konsumit mesatar të karburantit specifik të automjetit, dhe duke aplikuar faktorët përkatës të emetimeve.  $KM \times (L/100km) \times \text{Faktori i Emetimeve (kg/L)}$ . Konstantet e karburantit: Benzinë 7 L/100km; Naftë 7 L/100km; Hibrid 4 L/100km. Faktorët e emetimeve: Benzinë 2.31 kg/L; Naftë 2.68 kg/L; Hibrid 2.31 kg/L.

#### Rezultatet kryesore për automjetet:

Më 31 dhjetor 2024, emetimet nga automjetet e bankës arritën totalin prej 155.77 ton CO<sub>2</sub>. Më 31 dhjetor 2025, pas kalimit në automjete më hibride, emetimet ranë në 92.32 ton CO<sub>2</sub>. Reduktimi i emetimeve ishte 40.73%, duke demonstruar kështu përparim të rëndësishëm në qëndrueshmëri.

Vendndodhja	Litra të karburantit	Faktori i emetimeve 2025	CO <sub>2</sub> (kg) 2025	CO <sub>2</sub> (t) 2025
Zyra Qendrore	1000 l	2.68 kg/l	2680 kg CO <sub>2</sub>	2.68
Gjithsej				2.68 ton CO <sub>2</sub>

Vendndodhja	Litra të karburantit	Faktori i emetimeve 2024	CO <sub>2</sub> (kg) 2024	CO <sub>2</sub> (t) 2024
Zyra Qendrore	2460 l	2.68 kg/l	6592 kg CO <sub>2</sub>	6.59
Gjithsej				6.59 ton CO <sub>2</sub>

## 2.2. Emisionet nga Fushëveprimi 2 (Emetimet indirekte nga energjia elektrike e blerë)

Tabela 2. Emisioni i CO<sub>2</sub> me konsumin e energjisë

Burimi i Energjisë	Konsumi i vitit 2024 (kWh)	2024 CO <sub>2</sub> (ton)	Konsumi i vitit 2025 (kWh)	2025 CO <sub>2</sub> (ton)
Gjithsej energjia elektrike e blerë nga Kesco	3,456,957 kWh	1244.50 t	3,401,530 kWh	1224.55 t
Energjia nga burimet e ripërtëritshme e blerë nga Kesco	234,381 kWh	-84.37 t	199,669 kWh	-71.88 t
Gjenerimi i paneleve diellore	33,129 kWh	-11.92 t	31,222 kWh	-11.23 t
Totali i energjisë elektrike nga burime të ndryshme	3,490,086 kWh	1,148.21 t	3,432,752 kWh	1141.44 t

Faktori i emisionit i Fushëveprimit 2: 0.36 kg

## 2.3. Fushëveprimi 3 Emisionet e tjera indirekte:

(Udhëtime ajrore biznesore) Tabela e raportit të emisioneve të CO<sub>2</sub> për vitin 2024 kundrejt vitit 2025 dhe të dhënat e kompensimit:

Kategoria	Totali i Biletave (2024)	KMP (KM për pasagjerë) për vitin 2024	CO <sub>2</sub> neto për vitin 2024 (ton)	2025 KMP (KM për pasagjerë)	Totali i Biletave (2025)	Kompensimi i CO <sub>2</sub> për vitin 2025 (ton)	CO <sub>2</sub> neto 2025 (ton)
Udhëtimi Ajror (KMP)	246	344,400 PKM	1.62	200,200 PKM	143	31.63	-

Faktori i emisionit të Fushëveprimit 3: 0.158 kg CO<sub>2</sub>e/km

#### Iniciativat e Qëndrueshmërisë:

*Kompensimi i karbonit për udhëtimet ajrore të biznesit:*

Të gjitha biletat e avionit të blera në internet përmes Austrian Airlines në vitin 2025 kanë përfshirë opsionin shtesë të pagesës sipas programit të kompensimit të karbonit të Austrian Airlines. Të gjitha 143 biletat në vitin 2025 kanë përfshirë tarifa kompensimi të karbonit → kompensim 100% prej 31.632 t të CO<sub>2</sub> bruto dhe emisione neto zero të udhëtimeve ajrore (0.00 t). Normat e përmirësuar të riciklimit për pajisjet elektronike, letrën dhe materialet e tjera janë dhënë në tabelën e mëposhtme për vitet 2024 dhe 2025:

Materiali	Sasia e vitit 2024	Sasia e vitit 2025
Pajisje Elektronike dhe Metalike (copë)	1,460 copë	1,400 copë
Pajisje Elektronike dhe Metalike (kg)	4,280 kg	2,041 kg
Letër	3,355 kg	2,104 kg
Qelq	56 kg	42 kg

### Energjia e Ripërtëritshme

Energjia e CO<sub>2</sub> nga burimet e ripërtëritshme që planifikohet të prodhohet: Në vitin 2025, Kesco dhe KEK prodhuan 5793130000 kWh nga të cilat 340000000 kWh ishin nga burime të ripërtëritshme ( me erë dhe solare) apo 5.87 % (Burimi i të dhënave: KOSTT-Bilanci vjetor i energjisë). 5.87% të 3,468,377 kWh (të blera nga Kesco) apo 203,593,72 kWh janë nga burimet e ripërtëritshme. CO<sub>2</sub> nga Totali i Energjisë Elektrike nga burime të ndryshme: 1224.55 t - 73.29 t - 11.23 t = 1164.1 t

### Përfshirja e Financave (Fushëveprimi 3)

Banka është e përkushtuar për promovimin e përfshirjes financiare përmes programeve të synuara të kredidhënies. Kjo përfshin ofrimin e kredive mjedisore dhe kredive sociale të cilat e mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien sociale.

### Kreditë Mjedisore

Kreditë mjedisore janë projektuar për të financuar projektet të cilat kanë një ndikim pozitiv në mjedis. Këto kredi mbështesin iniciativat të tilla si:

- Projekte të Energjisë së Ripërtëritshme: Financimi për projekte të energjisë diellore, të erës dhe të energjisë së ripërtëritshme të cilat zvogëlojnë varësinë nga lëndët djegëse fosile.
- Përmirësime të Efiçencës së Energjisë: Kredi për bizneset dhe individët për të ofruar përmirësime të teknologjisë dhe praktika më efikase në energji.
- Menaxhimi i Ujit dhe Ujërave të Zeza: Financimi për projekte të cilat përmirësojnë ruajtjen e ujit, trajtimin e ujërave të zeza dhe praktikatat e menaxhimit të qëndrueshëm të ujit.

Më poshtë janë paraqitur ekspozimet bruto në kreditë mjedisore sipas industrisë për vitin 2025 dhe 2024:

Aktiviteti	2025	%	2024	%
Menaxhimi i Ujit dhe Ujërave të Zeza	10,056	40%	5,758	29%
Energjia e Ripërtëritshme	12,044	48%	9,935	51%
Efiçienca e Energjisë	2,466	10%	3,925	20%
Parandalimi dhe Kontrolli i Ndotjes	727	3%	-	0%
<b>Ekspozimi total i kredive mjedisore</b>	<b>25,293</b>	<b>100%</b>	<b>19,618</b>	<b>100%</b>

### Kreditë Sociale

Banka ofron kredi sociale me synim arritjen e objektivave specifike sociale, të tilla si përmirësimi i qasjes në arsim, kujdes shëndetësor dhe strehim të përballueshëm. Ndikimi i kredive sociale është renditur më poshtë:

- Duke ofruar financim pa kolateral, individët dhe bizneset, veçanërisht gratë, të rinjtë dhe ata në zonat rurale, fuqizohen për të pasur qasje në kredi dhe të risin bizneset e tyre. Kjo nxit pavarësinë ekonomike dhe zvogëlon pabarazinë financiare.
- Mbështetja e bizneseve në zonat rurale dhe në mesin e të rinjve dhe grave ndihmon në krijimin e mundësive të reja të punësimit, duke kontribuar në ekonomitë lokale dhe duke ulur papunësinë.
- Lehtësimi i qasjes në kapital inkurajon frymën sipërmarrëse dhe inovacionin, duke u mundësuar bizneseve që të zgjerohen, të përvetësojnë teknologji të reja dhe të bëhen më konkurruese në treg.
- Duke promovuar biznese që janë ekonomikisht të qëndrueshme dhe të përgjegjshme shoqërore, iniciativa kontribuon në rritjen afatgjatë dhe të qëndrueshme, duke krijuar kështu një ndikim pozitiv në komunitete dhe mjedis.
- Kjo mbështetja ndihmon tejkalimin e sfidave me të cilat përballen ata që u mungon kolaterali tradicional, duke mundësuar një ekosistem financiar më gjithëpërfshirës dhe të barabartë.

Kreditë e reja sociale për vitin 2025 janë 77.8 milionë euro (137.9 milionë euro më 31 dhjetor 2024), me një numër total ekspozimesh prej 1,094 (1,852 më 31 dhjetor 2024). Nga këto portofole, ekspozimi në vonesë ishte 2.3 milionë euro më 31 dhjetor 2025 dhe 4.1 milionë euro më 31 dhjetor 2024.

### Korporata e Faktorëve Mjedisorë, Social dhe Qeverisës në Analizën e Kreditit dhe Menaxhimin e Rrezikut Sistemik

Banka ka integruar konsideratat e rrezikut ESG në operacionet e bankës, financimin, huadhënien dhe vendimet e prokurimit .

### ESG në procesin e nënshkrimit

Procesi i nënshkrimit të korporatës ESG integron informacionin lidhur me ESG nga Biznesi dhe Rreziku për t'iu ofruar vendimmarrësve një vlerësim gjithëpërfshirës të ESG. Informacioni i biznesit i nënshtrohet rishikimit kritik nga funksioni i rrezikut/sigurimit, duke siguruar një perspektivë gjithëpërfshirëse të ESG. Ndërkohë, njohuritë nga Analiza dhe Sigurimi janë strukturuar në udhëzime për nënshkruesit, duke i dhënë përparësi klientëve me rrezik të lartë ESG mbi ata me rrezik më të ulët.

Në mënyrë strukturore, procesi përbëhet nga dy komponentë kryesorë:

- Parametrat e hyrjeve: Të dhënat me burim nga operacionet e biznesit, vlerësimet e riskut dhe kornizat e jashtme.
- Parametrat e daljeve: Vlerësimet e rrezikut të ESG, udhëzimet për sigurimin dhe mbështetja e strukturuar në vendimmarrje.

## Financimi i gjelbër dhe integrimi i ESG në Ndërmarrjet e Vogla

Banka po avancojnë iniciativat e financimit të gjelbër për ndërmarrjet e vogla me mbështetjen e fondeve, megjithëse parametrat UC specifike për produktin ende nuk janë përcaktuar. Kushtet e huadhënies përputhen me kriteret standarde të vlerësimit të riskut të zbatueshme për produktet e tjera të kredisë. Kreditë e pranueshme të gjelbra dhe sociale janë krijuar për të gjeneruar përfitime të prekshme mjedisore dhe sociale, të shqyrtuara sipas Kornizës të përcaktuar për kreditë të gjelbra dhe ato sociale. Kjo kornizë është në përputhje me rregulloret e Taksonomisë së BE-së, Parimet e Obligacioneve të Gjelbra të ICMA-s dhe Parimet e Obligacioneve Sociale të ICMA-s.

Banka po përfshin më tej ESG në Politikat e Portofolit të Kredisë (CPP) përmes:

- Zhvillimit të produkteve financiare të gjelbra
- Përfshirjes së konsideratave klimatike në vlerësimin e kolateralit
- Diferencimit të çmimeve për blerje të qëndrueshme
- Ekspozimit të kontrolluar ndaj industrive jo-të gjelbra

Për shkak të kufizimeve të të dhënave, siç është mungesa e Certifikatave të Performancës së Energjisë (EPC), banka bashkëpunon me fondin e BERZH-it për të ofruar grante dhe stimuj për projekte të gjelbra, duke i klasifikuar këto financime si "kredi të gjelbra". Ndërsa produktet e qëndrueshme plotësisht të integruara janë ende në zhvillim e sipër, banka shfrytëzon financimin e jashtëm për të klasifikuar kreditë të gjelbra në përputhje me standardet rregullatore.

## Zbërthimi i Vlerësimit të ESG

### Vlerësimi Mjedisor

Rezultati i pikëve E rrjedh nga një përzjerje e të të dhënave sasiore dhe cilësore. Pyetjet për faktet e buta mjedisore – gjithsej shtatë - janë të integruara në bazën e të dhënave të vlerësimit të korporatës (CRDB) brenda Modullit cilësor. Këto pyetje janë të pavarura nga përzgjedhja e industrisë dhe kontribuojnë në vlerësimin e përgjithshëm të ESG.

### Vlerësimi Social

Rezultati Social bazohet në 12 pyetje që lidhen me përgjegjësinë sociale të korporatës. Këto pyetje nuk ndikojnë në rezultatin e vlerësimit të kreditit, por kontribuojnë në Rezultatit e përgjithshëm ESG.

### Vlerësimi i Qeverisjes (Për Korporatat e Mëdha)

Vlerësimi i qeverisjes për korporatat e mëdha përfshin gjashtë pyetje shtesë në CRDB. Këto pyetje nuk ndikojnë në vlerësimin e kreditit, por janë thelbësore për vlerësimin e ESG-së. Nëse përgjigjet nuk janë të disponueshme gjatë procesit të vlerësimit, zbatohen vlerat e paracaktuara për të finalizuar vlerësimet e kreditit.

### Faktorët ESG në Vlerësimin e Kolateralit të Pasurive të Paluajtshme

Faktorët ESG janë të inkorporuar në vlerësimet e kolateralit të pasurive të paluajtshme, të cilat aktualisht zbatohen vetëm për strukturat e ndërtesave. Atributet e kolateralit ESG të mandatuara nga RBI përfshijnë:

- Llojin e kolateralit
- Kodin Postar, Emrin e Qytetit, Adresën
- Vitin e Ndërtimit dhe Vitin e Rinovimit
- Sipërfaqen e shfrytëzueshme (m<sup>2</sup>)

Banka vlerëson produktet dhe shërbimet në bazë të vlerësimeve individuale të rrezikut, përfshirë rreziqet e ESG, në mënyrë që të jetë në përputhshmëri me gjendjen financiare dhe detyrimet rregullatore të bankës. Sektorët ose aktivitetet me rrezik më të lartë i nënshtrohen një kujdesi të shtuar për të siguruar një menaxhim të fuqishëm të rrezikut.

## Etika e biznesit

Banka është e përkushtuar që të ruajë standardet më të larta të etikës së biznesit. Ky informacion shpjegues përshkruan qasjen tonë ndaj etikës së biznesit në përputhje me kërkesat e SNRF S1 dhe SNRF S2, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie në operacionet tona. Më 31 dhjetor 2025, ka një humbje monetare prej 0.2 mijë eurosh si rezultat i procedurave ligjore të lidhura me ligje ose rregullore të tjera të lidhura me industrinë financiare. Banka ka krijuar mekanizma të fuqishëm për monitorimin dhe raportimin e sjelljes etike. Këta mekanizma janë të dizajnuar për të siguruar që çdo shqetësim në lidhje me aktivitetet jo etike ose të paligjshme të mund të raportohet në mënyrë konfidenciale (duke e përfshirë anonimitetin e plotë) dhe të adresohet menjëherë dhe në mënyrë efektive.

Banka ka një aplikacion që bazohet në ueb faqen për sinjalizimin e shkeljeve që i përket tërë grupit (WHISPLI), i cili u ofron mundësinë të gjithë punonjësve, kontraktorëve, konsulentëve, ofruesve të shërbimeve, furnizuesve, partnerëve të biznesit, përfshirë ish-punonjësit ose partnerët e biznesit, që të raportojnë shkeljet materiale, konfliktet e mundshme ose shkeljet e pajtueshmërisë, keqbërjet e korporatave ose shkeljet e tjera. Politika, procedura dhe proceset bazohen në parimet e qeverisjes të dispozitave dhe udhëzimeve të mëposhtme ligjore dhe rregullatore:

- LIGJI I KOSOVËS Nr. 06/L –085 PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE
- Kodi i Mirësjelljes i Grupit Raiffeisen Bank International
- Direktiva (BE) 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2019 për mbrojtjen e personave që i raportojnë shkeljet e ligjit të Unionit;
- Neni 71 i Direktivës 2013/36/BE (CRD) dhe Neni 99g i Ligjit Austriak Bankar;
- Kapitulli 13 - EBA/GL/2017/11, Udhëzimet mbi qeverisjen e brendshme sipas Direktivës 2013/36/BE

# Ofrimi i shërbimeve

Adresat dhe kontaktet	114
Detajet e publikimit	119

# Adresat dhe kontaktet

## Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

### Head Office

Robert Doll, no. 101  
10000 Prishtina  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 735  
SWIFT Code: RBKOKKPR  
IBAN Code: XK05  
E-mail: info@raiffeisen-kosovo.com

### REGIONAL BRANCH IN PRISHTINA

Robert Doll, no. 101  
10000 Prishtina  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 735

### Branch in Prishtina

Agim Ramadani Street, no. 227  
10000 Prishtina  
Tel: +383 38 222 222, ext. 344

### Cashless Branch in Prishtina

Vëllezërit Fazliu Street, Kodra e Trimave  
10000 Prishtina  
Tel: +383 38 222 222, ext. 465

### Cashless Branch in Prishtina

Rrahim Beqiri Street, no 29, Bregu i Diellit  
10000 Prishtina  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 420

### Cashless Branch in Prishtina

Bulevardi i Dëshmorëve, Ulpianë  
10000 Prishtina  
Tel: +383 38 222 222, ext. 277

### Cashless Branch in Prishtina

UCK Street, No. 25  
10000 Prishtina  
Tel: +383 38 222 222, ext. 142

### Branch in Fushë Kosova

Nëna Terezë Street, No. 80  
12000 Fushe Kosova  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 470

### Cashless Branch in Obiliq

Hasan Prishtina Street, n.n. 36  
12000 Obiliq  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 467

### Cashless Branch in Drenas

Fehmi dhe Xheve Ladrovci Street, n.n.  
13000 Gillogovc  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 460

### Cashless Branch in Gracanica

Kralja Milutina, n.n.  
Tel: +383(0) 222 222 ext 450

### Cashless Branch in Lipjan

Lidhja e Prizrenit Street, nr. 35  
14000 Lipjan  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 440

### Cashless Branch in Podujeva

Zahir Pajaziti Street, n.n.  
11000 Podujeva  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 430

### Cashless Branch in Skenderaj

Adem Jashari Square, no. 15  
41000 Skenderaj  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 570

### REGIONAL BRANCH IN FERIZAJ

Dëshmorët e Kombit Street, no. 39  
70000 Ferizaj  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 584

### Cashless Branch in Kaçanik

Ismail Raka Street, n.n.  
71000 Kaçanik  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 670

### Cashless Branch in Shtërpce

Main Street, n.n.  
73000 Shtërpce  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 690

### REGIONAL BRANCH IN GJAKOVA

Skenderbeu Street, n.n.  
50000 Gjakovë  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 701

### Cashless Branch in Rahovec

Avdullah Bugari Street, n.n.  
21010 Rahovec  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 732

### Cashless Branch in Malisheva

Gjergj Kastrioti - Skenderbeu Street, n.n.  
24000 Malisheva  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 530

### REGIONAL BRANCH IN GJILAN

Adem Jashari Street, no. 110  
60000 Gjilan  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 750

### Cashless Branch in Kamenica

Sheshi Skenderbeu, n.n.  
62000 Kamenica  
Tel: +383 (0) 38 222 222, ext. 770

### Cashless Branch in Viti

28 Nentori Street, n.n.  
61000 Viti  
Tel: +383 (0) 38 222 222, ext. 780

**REGIONAL BRANCH IN MITROVICA**

Sheshi Shemsi Ahmeti, n.n.  
40000 Mitrovica  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 550

**Cashless Branch in Vushtrri**

Dëshmorët e Kombit Street, n.n.  
42000 Vushtrri  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 560

**Branch in North Mitrovica**

Kralja Petra I Street, n.n.  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 580

**Branch in Brnjak**

Border with Serbia  
Customs Terminal 1 in Brnjak  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 584

**Branch in Jarinje**

Border with Serbia  
Customs Terminal 31 in Jarinje  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 588

**Branch in Leposaviq**

Border with Serbia  
Rr. "JNA", nr. 26, Leposaviq

**REGIONAL BRANCH IN PEJA**

Haxhi Zeka Square, n.n.  
30000 Peja  
Tel: +383 (0) 38 222 222, ext. 607

**Cashless Branch in Decan**

Luan Haradinaj Street, n.n.  
51000 Deçan  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 620

**Cashless Branch in Istog**

Fadil Ferati Street, no. 22  
31000 Istog  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 640

**Cashless Branch in Klina**

Mujë Krasniqi Square, n.n.  
32000 Klina  
Tel: +383 (0) (0)38 222 222, ext. 630

**REGIONAL BRANCH IN PRIZREN**

Nëna Terezë Street, Bazhdarhane, no. 7  
20000 Prizren  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 507

**Cashless Branch in Prizren**

Shqip Spahiu Street, Shadervan  
20000 Prizren  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 520

**Cashless Branch in Dragash**

Sheshi i Dëshmorëve, no. 22  
22000 Dragash  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 535

**Cashless Branch in Suhareka**

Brigada 123 Street, n.n.  
23000 Suhareka  
Tel: +383 (0)38 222 222, ext. 540

## Raiffeisen Bank International AG

### Austria

Am Stadtpark 9  
1030 Vienna  
Tel: +43-1-71 707-0  
SWIFT/BIC: RZBATTWW  
www.rbinternational.com

## CEE banking network

### Albania

Raiffeisen Bank Sh.a.  
Rruga "Tish Daija"  
Kompleksi Kika 2  
1000 Tirana  
Tel: +355-4-23 81 381  
SWIFT/BIC: SGSBALTX  
www.raiffeisen.al

### Bosnia and Herzegovina

Raiffeisen Bank dd Bosna i  
Hercegovina  
Zmaja od Bosne bb  
71000 Sarajevo  
Tel: +387-33-75 50 10  
SWIFT/BIC: RZBABA2S  
www.raiffeisenbank.ba

### Croatia

Raiffeisenbank Austria d.d.  
Magazinska cesta 69  
10000 Zagreb  
Tel: +385-72-626 262  
SWIFT/BIC: RZBHHR2X  
www.rba.hr

### Czech Republic

Raiffeisenbank a.s.  
Hvězdova 1716/2b  
14078 Prague 4  
Tel: +420-412 440 000  
SWIFT/BIC: RZBCCZPP  
www.rb.cz

### Hungary

Raiffeisen Bank Zrt.  
Váci út 116-118  
1133 Budapest  
Tel: +36-80 488 588  
SWIFT/BIC: UBRTHUHB  
www.raiffeisen.hu

### Kosovo

Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.  
Robert Doll St. 99  
10000 Pristina  
Tel: +383-38-222 222  
SWIFT/BIC: RBKOKXPR  
www.raiffeisen-kosovo.com

### Romania

Raiffeisen Bank S.A.  
FCC Building  
Calea Floreasca 246D  
014476 Bucharest  
Tel: +40-21-30 610 00  
SWIFT/BIC: RZBRROBU  
www.raiffeisen.ro

### Russia

AO Raiffeisenbank  
Smolenskaya-Sennaya Sq. 28  
119002 Moscow  
Tel: +7-495-721 99 00  
SWIFT/BIC: RZBMRUMM  
www.raiffeisen.ru

### Serbia

Raiffeisen banka a.d. Beograd  
Djordja Stanojevic 16  
11070 Novi Beograd  
Tel: +381-11-32 021 00  
SWIFT/BIC: RZBSRSBG  
www.raiffeisenbank.rs

### Slovakia

Tatra banka, a.s.  
Hodžovo námestie 3  
81106 Bratislava 1  
Tel: +421-2-59 19-1000  
SWIFT/BIC: TATRKBX  
www.tatrabanka.sk

### Ukraine

Raiffeisen Bank JSC  
Generala Almazova Str., 4A  
01011 Kiev  
Tel: +38-044-490 8888  
SWIFT: AVALUAUK  
www.raiffeisen.ua

## Leasing companies

### Austria

Raiffeisen-Leasing  
Gesellschaft m.b.H.  
Mooslackengasse 12  
1190 Vienna  
Tel: +43-1-716 01-0  
www.raiffeisen-leasing.at

### Albania

Raiffeisen Leasing Sh.a.  
Rruga "Tish Daija"  
Kompleksi Kika 2  
1000 Tirana  
Tel: +355-4-22 749 20  
www.raiffeisen-leasing.al

### Belarus

„Raiffeisen-Leasing“ JLLC  
V. Khoruzhey St. 31 A  
220002 Minsk  
Tel: +375-17-28 9-9394  
www.rl.by

### Bosnia and Herzegovina

Raiffeisen Leasing d.o.o. Sarajevo  
Zmaja od Bosne bb.  
71000 Sarajevo  
Tel: +387-33-254 340  
www.rlbh.ba

### Croatia

Raiffeisen Leasing d.o.o.

Magazinska cesta 69  
10000 Zagreb  
Tel: +385-1-65 9-5000  
www.raiffeisen-leasing.hr  
**Czech Republic**  
Raiffeisen-Leasing s.r.o.  
Hvězdova 1716/2b  
14000 Prague 4  
Tel: +420-2-215 116 11  
www.rl.cz

**Hungary**

Raiffeisen Corporate Lizing Zrt.  
Váci út 116-118  
1133 Budapest  
Tel: +36-1-486 5177  
www.raiffeisenlizing.hu

**Kosovo**

Raiffeisen Leasing Kosovo LLC  
St. UÇK no. 222  
10000 Pristina  
Tel: +383-38-222 222-340  
www.raiffeisenleasing-kosovo.com

**Romania**

Raiffeisen Leasing IFN S.A.  
Calea Floreasca 246 C  
014476 Bucharest  
Tel: +40-21-30 644 44  
www.raiffeisen-leasing.ro

**Russia**

OOO Raiffeisen-Leasing  
Smolenskaya-Sennaya Sq. 28  
119121 Moscow  
Tel: +7-495-72 1-9980  
www.raiffeisen-leasing.ru

**Serbia**

Raiffeisen Leasing d.o.o.  
Djordja Stanojevic 16  
11070 Novi Beograd  
Tel: +381-11-220 7400  
www.raiffeisen-leasing.rs

**Slovakia**

Tatra-Leasing s.r.o.  
Hodžovo námestie 3  
81106 Bratislava  
Tel: +421-2-5919-5919  
www.tatraleasing.sk

**Slovenia**

Raiffeisen Leasing d.o.o.  
Letališka cesta 29a  
1000 Ljubljana  
Tel: +386-8-281-6200  
www.raiffeisen-leasing.si

**Ukraine**

LLC Raiffeisen Leasing  
Pyrohov Str. 7-7b  
Office 503  
01601 Kiev  
Tel: +38-044-590 24 90  
www.raiffeisen-leasing.com.ua

**Branches and representative offices – Europe****Belgium**

RBI Liaison Office Brussels  
Rue de l'Industrie 26-38  
1040 Brussels  
Tel: +32 2 28968-56

**France**

RBI Representative Office Paris  
9 - 11 avenue Franklin D. Roosevelt  
75008 Paris  
Tel: +33 (0) 1 45 61 27 00

**Germany**

RBI Frankfurt Branch  
Wiesenhüttenplatz 26  
60329 Frankfurt  
Tel: +49-69-29 921 924

**Poland**

Raiffeisen Bank International AG  
(Spółka Akcyjna) Oddział w Polsce  
Plac Konesera 8  
03-736 Warsaw  
Tel: +48-22-5785602

**Slovakia**

Raiffeisen Bank International AG Slovak Branch pobočka zahraničnej banky  
Karadžičova 14  
821 08 Bratislava  
Tel: +421 2 57203040  
<https://sk.rbinternational.com>

**Sweden**

RBI Representative Office  
Nordic Countries  
Drottninggatan 89, 14th Floor  
113 60 Stockholm  
Tel: +46 73 091 05 89

**Turkey**

Raiffeisen Investment  
Financial Advisory Services Ltd. Co.  
Bahtiyarlar Sok. No. 8 Etiler  
34337 Istanbul  
Tel: +90 212 287 10 80

**United Kingdom**

RBI London Branch  
Tower 42, Leaf C 9th Floor  
25 Old Broad Street  
London EC2N 1HQ  
Tel: +44-207-933-8000

**Branches and representative offices – Asia****China**

RBI Beijing Branch  
Unit 700 (7th Floor), Building No. 6  
Jianguomenwai Dajie 21  
100020 Beijing  
Tel: +86-10-65 32-3388

**India**

RBI Representative Office Mumbai  
501, Kamla Hub,  
Gulmohar Rd, Juhu  
Mumbai 400049  
Tel: +91-22-26 230 657

**Korea**

RBI Representative Office Korea  
#1809 (Jongno 1 ga,  
Le Meilleur Jongno Town)  
19, Jong-ro, Jongno-gu  
Seoul 03157  
Tel: +82-2-725-7951

**Singapore**

RBI Singapore Branch  
50 Raffles Place  
#31-03 Singapore Land Tower  
Singapore 048623  
Tel: +65-63 05-6000

**Vietnam**

RBI Representative Office  
Ho-Chi-Minh-City  
35 Nguyen Hue Str.,  
Harbour View Tower  
Room 601A, 6th Floor, Dist. 1  
Ho-Chi-Minh-City  
Tel: +842-8-38 214 718,  
+842-8-38 214 719

**Selected subsidiaries****Austria**

**Elevator Ventures Beteiligungs GmbH**  
Mooslackengasse 12  
1190 Vienna  
www.elevator-ventures.com

**Kathrein Privatbank AG**

Wipplingerstraße 25  
1010 Vienna  
Tel: +43-1-53 451-0  
www.kathrein.at

**Raiffeisen Bausparkasse Gesellschaft m.b.H.**

Mooslackengasse 12  
1190 Vienna  
Tel: +43-1-54 646-0  
www.bausparen.at

**Raiffeisen Continuum GmbH**

Am Stadtpark 9  
1030 Vienna  
Tel: +43-1-71 707 8510  
www.raiffeisen-continuum.at

**Raiffeisen Digital Bank AG**

Am Stadtpark 9  
1030 Vienna  
Tel: +43-1-71 707 5560  
www.raiffeisendigital.com

**Raiffeisen Factor Bank AG**

Mooslackengasse 12  
1190 Vienna  
Tel: +43-1-219 74 57  
www.raiffeisen-factorbank.at

**Raiffeisen Kapitalanlage- Gesellschaft m.b.H.**

Mooslackengasse 12  
1190 Vienna  
Tel: +43-1-71 170-0  
www.rcm.at

**Raiffeisen Wohnbaubank Aktiengesellschaft**

Mooslackengasse 12  
1190 Vienna  
mailbox@rwbb.at  
https://raiffeisen-wohnbaubank.at

**Valida Holding AG**

Mooslackengasse 12  
1190 Vienna  
Tel: +43-1-31 648-0  
www.valida.at

**USA**

RB International Markets (USA) LLC  
1177 Avenue of the Americas, 5th Floor  
New York, NY 10036

# Detajet e publikimit

**Publikimi u përgatit nga**

Banka Raiffeisen në Kosovë  
Rruga Robert Doll, nr. 99  
10000, Prishtinë  
Tel.: +383-38-22 222 2  
SWIFT/BIC: RBKOKPR  
Kodi IBAN: XK05  
www.raiffeisen-kosovo.com

**Ekipi punues:**

**Departamenti i Qëndrueshmërisë dhe Komunikimit**  
**Departamenti i Financave**

**Pre-press:**

Shift Agency

Versioni online i raportit vjetor në gjuhën shqipe dhe angleze është publikuar në: [www.raiffeisen-kosovo.com](http://www.raiffeisen-kosovo.com)

Ky raport vjetor është përgatitur dhe të dhënat janë kontrolluar me kujdesin më të madh të mundshëm. Megjithatë, gabimet në rrumbullakim, transmetim, shtypje dhe printim nuk mund të përjashtohen. Ky raport vjetor është përgatitur në gjuhën angleze. Versioni në gjuhën shqipe i raportit vjetor është përkthim i versionit origjinal në anglisht. Versioni në anglisht ka përparësi ndaj versionit në shqip.



**Raiffeisen  
Bank**

